



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 666 Akti

Nr. 774 Vendimi
Tiranë, më 14.6.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Etleda Çiftja	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 10.6.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Petrit Vukaj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoji subjektin e rivlerësimit

Petrit Vukaj, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

- 1.** Z. Petrit Vukaj është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
- 2.** Z. Petrit Vukaj, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Etleda Çiftja dhe Lulzim Hamitaj.
- 3.** Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 21.12.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Lulzim Hamitaj, të gjithë anëtarët të deklarojnë mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe të fillojë hetimi administrativ i thellë dhe i gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.
- 4.** Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, në vijim AKSIK (ish-DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
- 5.** Në datën 13.1.2021, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit, mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit informacion shtesë, sipas pyetësorit standard.
- 6.** Në përgjigje, përmes postës elektronike² dhe dorëzimit në protokoll³, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Komision dokumentet provuese lidhur me procesin e rivlerësimit dhe nuk ka deklaruar kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
- 7.** Trupi gjykues, me vendimin e datës 10.5.2024, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Petrit Vukaj, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47

¹ Email, datë 13.1.2021, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

² Email datë 27.1.2021, “Dërgohen përgjigjet e pyetësorit dhe dokumentacioni shoqërues”.

³ Nr. *** prot., datë 28.1.2021.

e 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

8. Në datën 14.5.2024, përmes postës elektronike⁴, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 e 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjektit të rivlerësimit iu kërkuua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 28.5.2024.

9. Në datën 24.5.2024, përmes postës elektronike⁵, përfaqësuesja me prokurë e subjektit të rivlerësimit, znj. R. Z., kërkoi nga Komisioni shtyrjen e afatit të paraqitjes së provave dhe parashtrimeve në kudër të rezultateve të hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Petrit Vukaj. Bashkëlidhur kërkesës ka dorëzuar dokumentacionin përkatës⁶.

10. Në përgjigje, Komisioni, përmes postës elektronike⁷, njoftoi përfaqësuesen e subjektit të rivlerësimit për shtyrjen e afatit të dorëzimit të prapësimeve brenda orës 12 të datës 4.6.2024.

11. Në datën 4.6.2024, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike⁸, paraqiti shpjegimet me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe dokumentacionin provues.

12. Më tej, Komisioni, me anë të postës elektronike⁹, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 13.12.2023, ora 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

13. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Petrit Vukaj, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

14. Në datën 10.6.2024 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, shoqëruar nga av. R. Z., me nr. licence ***, me prokurë, si dhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

15. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

16. Z. Petrit Vukaj dhe përfaqësuesja e tij ligjore, znj. R. Z., pasi dëgjuan relacionin shprehën qëndrimin e tyre, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj subjektit.

⁴ Email datë 14.5.2024, "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit administrativ kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit".

⁵ Email datë 24.5.2024, "Kërkesë për shtyrje afati për paraqitje parashtrimeve-subjekti i rivlerësimit Petrit Vukaj".

⁶ Kërkesë e datës 24.5.2024; prokurë nr. ***, datë 21.5.2024.

⁷ Email datë 27.5.2024.

⁸ Email datë 4.6.2024.

⁹ Email datë 6.6.2024, "Ftesë për t'u paraqitur në seancën dëgjimore për procesin tuaj të rivlerësimit".

17. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 10.6.2024, subjekti i rivlerësimit Petrit Vukaj kërkoi konfirmimin në detyrë.

18. Seanca dëgjimore e datës 10.6.2024 u ndërpre, për të rifilluar në datën 14.6.2024, me shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Subjekti i rivlerësimit Petrit Vukaj ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

21. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistem objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

22. Referuar vendimit nr. 2/2017¹⁰ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

23. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj, i cili është bërë subjekt deklarues në këtë institucion në vitin 2003 në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të

¹⁰ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

24. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë për periudhën 2003 – 2016 dhe në datën 25.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* 2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se: deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë; subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

25. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit e, në vijim, shpjegimet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

26. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

27. Truall me sip. 300 m² dhe shtëpi banimi 2-katëshe

27.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Truall dhe shtëpi banimi 2 kate, kati i parë 104 m², kati i dytë (papafingo) 102 m² + ambient ndihmës 1 kat 23 m². Truall i marrë nga Komiteti Ekzekutiv Pluralist, datë 19.9.1991. Kati i parë ndërtuar në 1992. Kati i dytë në vitet 2008, 2009 e 2010. Vlera 17.645.526 lekë. Rivlerësuar me referencë ***, datë 29.8.2011. Pjesa takuese: 100%*”. Nuk ka deklaruar shumën e shpenzuar për ndërtimin e kësaj banese dhe as burimin e krijimit. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹¹.

¹¹ Vërtetim nga dokument hipotekor i ZVRPP-së Fier, datë 18.6.2010; shkresë nr. *** prot., datë 11.3.2009, e Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier; hartë treguese e regjistrimit datë 17.6.2010; vërtetim nga dokumenti hipotekor dhe hartë treguese, datë 5.6.2002; formular aplikimi në ZVRPP i datës 7.5.2002; shkresë nr. *** prot., datë 23.2.2009, i Drejtorisë së Urbanistikës pranë Këshillit të Qarkut Fier; formular i lejes së ndërtimit; plan-vendosje e sheshit të ndërtimit; vendim nr. ***, datë 19.9.1991, i Komitetit Ekzekutiv Pluralist ***; pamja kryesore e objektit nëntor 1993; planimetria e katit përdhe nëntor 1993; leje

27.2 Referuar deklaramëve periodike ndër vite, rezulton se subjekti ka bërë këto deklaramë:

i) Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 ka deklaruar: *“Shtëpi private 2 dhoma dhe një kuzhinë. ***, Fier, nr. pasurie ***. Truall i marrë nga shteti në 1991-in si i pastrehë, ndërtuar me të ardhurat e mia”*.

ii) Në DIPP/2008 ka deklaruar: *“Investim në godinën ekzistuese. Vlera 285.000 lekë”*.

iii) Në DIPP/2009 ka deklaruar: *“Depo (objekt ndihmës) e ndërtuar në vitin 1998, e cila është në proces legalizimi së bashku me truallin e banesës ekzistuese. Vlera 25.000 lekë” dhe “Investim në banesë, e cila ka të bëjë me shtesë të ambienteve të banimit me sip. 57.6 m². Kati i dytë (proces legalizimi). Vlera 300.000 lekë”*.

iv) Në DIPP/2010 ka deklaruar: *“Truall + banesë 2kt + ambient ndihmës, përfitur nga procesi i legalizimit. Vërtetimi hipotekor nr. ***, datë 18.6.2010. Sipërfaqe trualli 300 m². Sipërfaqe banese 104 kati i parë, 102 kati i dytë, ambienti ndihmës 23 m². Vlera 429.493 lekë. Një pjesë e kësaj vlere është paguar me bono privatizimi (70%) dhe pjesa tjetër me lekë në dorë sipas konfirmave bankare ...datë 28.4.2010 pranë Credins Bank, me vlerë 280.000 lekë... datë 28.4.2010 Credins Bank me vlerë 120.000 lekë.... konferma bankare... 3.3.2010 me vlerë 25.493 lekë”*. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar: *“Investime në banesë, të cilat kanë të bëjnë me ambientet e brendshme të shtëpisë. Vlera 74.000 lekë”*.

v) Në DIPP/2016 ka deklaruar: *“Shtëpi banimi e deklaruar në vite, nuk janë bërë ndryshime. Lëshuar certifikatë e pasurisë nr. ***, datë 31.1.2017”*.

27.3 Lidhur me fillimin e banimit në këtë banesë, DPGJC-ja¹² informon se subjekti i rivlerësimit ka qenë i regjistruar bashkë me familjen e origjinës në fshatin ***, Njësia Administrative ***, Tropojë dhe, më pas, në datën 28.5.1991, ka ndryshuar vendbanimin duke u vendosur në lagjen “****”, Fier, në përbërje familjare me 2 anëtarë, Petrit Vukaj dhe A. V.

27.4 Kjo adresë është deklaruar nga subjekti në DIPP-të e viteve 2003 – 2013, e më pas si adresë banimi në DIPP/2016 dhe në deklaratën *Vetting*. Në DIPP-të e viteve 2014 – 2015 subjekti i rivlerësimit nuk e ka plotësuar seksionin e adresave, por bashkëshortja e tij ka deklaruar adresën “****”, Fier.

27.5 Lidhur me mobilimin e banesës, në procesverbalin e datës 7.6.2016 të ILDKPKI-së¹³, subjekti ka deklaruar se mobilimi i shtëpisë është modest dhe është kryer që nga vitit 1992 e në vijim, me burim të ardhurat familjare. Më tej, në pyetësorin standard, subjekti ka specifikuar disa blerje të kryera gjatë periudhës 1992 – 2016, në shumën totale 219.000 lekë, e cila u pasqyrua në analizën financiare sipas deklaramëve të subjektit¹⁴.

shfrytëzimi objekti datë 20.2.2009; akt kontrolli i Drejtorisë së Urbanistikës, Këshilli i Qarkut Fier, pa datë; akt kolaudimi datë 3.2.2009; kontratë për kalim pronësie të parcelës ndërtimore nr. ***, datë 29.4.2010; mandat datë 28.4.2010 i Credins Bank, bono privatizimi; formular i pagesës me bono privatizimi datë 28.4.2010; mandat datë 28.4.2010 i Credins Bank, pagesë për parcelë; formular i pagesës në lekë i parcelës ndërtimore datë 28.4.2010; formular i taksës së ndikimit në infrastrukturë datë 3.3.2010; formular i tarifës së shërbimit për legalizim datë 21.1.2010; leje legalizimi nr. ***, datë 26.5, mungon viti; vërtetim nga dokument hipotekor datë 29.8.2011.

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2023.

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2023, e ILDKPKI-së.

¹⁴ Subjekti ka deklaruar: *“Mobilimet e shtëpisë janë modeste dhe të blera ndër vite, pjesë-pjesë nga rroga ime, bashkëshortes time apo shpërblimet ndër vite, që nga viti 1992 dhe më pas, ku dhoma e gjumit është blerë para vitit 2002, me sa më kujtohet, në vlerën 35.000 lekë, frigoriferi është blerë në vitin 1996 (nuk më kujtohet vlera), kam blerë dy televizorë të vegjël, ku unë nuk i kujtoj dot vitet kur janë blerë, por në vlera të vogla, secili nga 16.000 lekë, kuzhina është blerë në vitin 1999, në vlerën rreth 22.000 lekë, e cila është lyer me bojë nga jashtë në vitin 2016, kolltukët janë blerë me sa më kujtohet në vitin 2004, në vlerën 55.000 lekë. Po kështu, në vitin 1999 dhe vitin 2000 kam blerë dhe dy krevate të vegjël për fëmijët, ku me sa më kujtohet*

27.6 Komisioni, në përfundim të rezultateve të hetimit, konstatoi se lidhur me aspektin deklarativ, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën Vetting shumën e shpenzuar nga ana e tij dhe burimin e krijimit të pasurisë truall dhe shtëpi banimi 2 kate, sipas parashikimeve të shtojcës 1 të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit nr. *** prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së.

27.7 Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁵, subjekti shpjegoi se mosdeklarimi ka ardhur si pasojë e keqkuptimit në mënyrën e përpilimit të deklaratës Vetting, ku duke deklaruar origjinën e përfitimit të këtij trualli, vlerën e pasurisë pas rivlerësimit të kryer, si dhe kohën e ndërtimit të saj, ka menduar se e ka ezauruar detyrimin ligjor lidhur me mënyrën e deklarimit të kësaj pasurie në deklaratën Vetting. Ndërkohë që vlerën e investimit të kryer e ka deklaruar rregullisht në çdo deklaram periodik vjetor përkatës.

27.8 Komisioni vlerëson se moskuptimi i ligjit dhe udhëzimit të ILDKPKI-së nuk përjashton subjektin nga përgjegjësia ligjore. Megjithatë, konstatimi i mësipërm nuk është shoqëruar me barrë prove apo me dhënien e shpjegimeve në përfundim të rezultateve të hetimit e, për pasojë, kjo rrethanë është vlerësuar në tërësi me rrethanat e tjera që kanë lidhje me rivlerësimin e pasurisë.

Lidhur me regjistrimin e pasurisë truall dhe shtëpi banimi 2-katëshe në ASHK

27.9 Referuar dokumentacionit të përcjellë nga ASHK-ja¹⁶ rezulton se në formularin për legalizim objekti nr. *** prot., datë 5.10.2006, subjekti ka deklaruar: *“Shtëpi banimi 1 kat, adresë ***, viti i ndërtimit 1992, sipërfaqe e zënë 300 m², sipërfaqe ndërtimi 102, lloji i mbulesës solet B/A, garazh 23,60 m. Bashkëlidhur gjenden fotot e objektit, ku konstatohet se objekti është 1 kat (pa papafingo)”*.

27.10 Në aktin e kualifikimit nr. ***, datë 29.4.2010, të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Qarku Fier, pasqyrohet se objekti informal: *“Ka 300 m² parcelë ndërtimore, sipërfaqe të bazës së objektit (104, 23) 127 m², nr. katesh 1 (një)”*.

27.11 Më pas, bazuar në VKM-në nr. 125, datë 17.2.2010¹⁷, ndërmjet ALUIZNI-t dhe subjektit të rivlerësimit është lidhur kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore nr. ***, datë 29.4.2010, me anë të cilës subjektit të rivlerësimit i ka kaluar pronësia e parcelës me sip. 300 m². Bashkëlidhur kontratës gjendet formulari i pagesës me bono privatizimi i parcelës ndërtimore, i datës 28.4.2010, ku vlera totale e parcelës është llogaritur në 400.000 lekë, nga të cilat 70% e totalit është paguar me bono privatizimi në shumën 280.000 lekë¹⁸, si dhe formulari i pagesës me lekë i datës 28.4.2010, për pjesën e mbetur prej 120.000 lekësh. Bazuar në dokumentacionin e administruar, subjekti ka paguar shumën totale prej 149.493 lekësh pranë Credins Bank¹⁹.

kanë qenë në vlerën 4.500 lekë. Në vitin 2011 kam blerë një bar - bufë, me sa më kujtohet, në vlerën 22.000 lekë, lavatriçe në vitin 2010, rreth vlerës 20.000 lekë, kondicioneri është blerë me sa më kujtohet rreth viteve 2010 – 2011, në vlerën 24.000 lekë”.

¹⁵ Email datë 4.6.2024.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2021.

¹⁷ “Për miratimin e kalimit në pronësi të parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale”.

¹⁸ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti deklaroi se bonot e privatizimit i ka siguruar në pikat e këmbimit valutor në qytetin e Fierit dhe për shkak të kohës së gjatë të kaluar nuk mban mend me saktësi vlerën e blerjes, por me sa i kujtohet dhe me sa ka marrë informacion, vlera e tyre në vitin 2010 varionte nga 6,7% e shumës deri në 8% dhe mendon se shumata e shpenzuar për blerjen e bonove nuk i ka kaluar vlerën e 20.000 lekë.

¹⁹ Konkretisht ka paguar në favor të ALUIZNI-t shumën 25.393 lekë në datën 3.3.2010, shumën 120.000 lekë në datën 28.4.2010 dhe në favor të Degës së Thesarit shumën 4.000 lekë në datën 21.1.2010.

27.12 Në vijim, është miratuar leja e legalizimit nr. ***, datë 26.5.2010, për objektin “godinë banimi 1 kat + objekt ndihmës 1 kat”, në favor të subjektit, me këto të dhëna: *Zona kadastrale ***, nr. pasurisë ***; sipërfaqja e parcelës ndërtimore 300 m²; sipërfaqja e ndërtimit 104 + 23 = 127 m², sipërfaqja totale e ndërtimit për banim 104 m², numri i kateve mbi tokë 1 (një)... objekt ndihmës me sip. 23 m²”.*

27.13 Në dokumentacionin e administruar nga ILDKPKI-ja²⁰ rezulton se Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Qarku Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 1.6.2010, i ka përcjellë ZVRPP-së Fier dosjen e legalizimit të subjektit dhe në kartelën e pasurisë së paluajtshme të legalizuar, të datës 26.5.2010, pasqyrohet se në emër të subjektit është regjistruar “*Pasuria nr. ***, z. k. ***, me adresë ***, lloji i pasurisë truall me sipërfaqe totale 300 m², nga të cilat 300 m² truall dhe 104 + 23 ndërtesë*” dhe në seksionin “Përshkrim i veçantë” pasqyrohen këto të dhëna: “*Banesë 1 kat; kati përdhe 104 m²; objekt ndihmës 23 m²”.*

27.14 Ndërsa në vërtetimin nga dokumenti hipotekor, datë 18.6.2010, i ZVRPP-së Fier²¹, pasqyrohet se në pronësi të subjektit figuron e regjistruar pasuria nr. ***, z. k. ***, me sip. 300 m² në adresën ***, me përshkrimin “*Truall dhe banesë 2 kat. Kati i parë 104 m², kati i dytë 102 m² + ambient ndihmës 1 kat 23 m²”.*

27.15 Gjithashtu, në kartelën e pasurisë së paluajtshme të ZVRPP-së Fier, datë 31.1.2017, konstatohet regjistrimi në pronësi të subjektit i pasurisë nr. ***, z. k. ***, me sip. 300 m² truall dhe 104 m² ndërtesë, ku në seksionin “Përshkrim i veçantë” është bërë shënimi “*Shtëpi banimi me papafingo... sipas lejes së legalizimit nr. ***, datë 26.5.2010, banesa 104 m², ambienti ndihmës 23 m²”.* Më pas pasqyrohet shënimi “*Me ref. *** bëhet rivlerësimi i pasurisë në vlerën 17.645.526 lekë. Kati përdhe 104 m². Kati i parë 102 m². Ambient ndihmës 23 m²”.* Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor i datës 29.8.2011, rivlerësimi i pasurisë është bërë në datën 29.8.2011.

27.16 Sa më sipër, mbetet i paqartë pasqyrimi në dokumentin hipotekor të datës 18.6.2010 dhe në kartelën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme të datës 31.1.2017 të ish-ZVRPP-së regjistrimi “papafingo” dhe i katit të parë (dytë) me sip. 102 m² kur këto pasuri/sipërfaqe ndërtimore nuk parashikohen në lejen e legalizimit.

27.17 Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1²² i kërkoi subjektit të shpjegonte faktin e mospërputhjes së përmbajtjes së lejes së legalizimit me pasqyrimin në dokumentet e ish-ZVRPP-së të regjistrimit “papafingo” dhe të katit të parë (dytë) me sip. 102 m².

27.18 Në përgjigje²³, subjekti shpjegoi se i është drejtuar ASHK-së Fier, duke i kërkuar verifikimin e gjendjes faktike dhe pasi citon përmbajtjen e shkresës nr. *** prot., datë 7.3.2024, të ASHK-së Fier, deklaroi se nga verifikimi që ky institucion u ka bërë fotografimeve ajrore ndër vite ka konstatuar se edhe procesverbali i verifikimit në terren nuk i përgjigjej gjendjes faktike, pasi kati i parë teknik i objektit në vitin 2010 ka qenë i gjithi i përfunduar. Për vërtetimin e deklarimit subjekti i rivlerësimi ka paraqitur dokumentacionin provues²⁴.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 26.9.2017, e ZQRPP-së (dosja ILDKPKI).

²¹ Paraqitur edhe nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

²² Email datë 26.2.2024.

²³ Email datë 11.3.2024.

²⁴ Kërkesën datë 6.3.2024; shkresë nr. *** prot., datë 7.3.2024, e ASHK Fier; pjesë nga fotografimi ajror; dokumentacion i regjistrimit të banesës të marrë nga ASHK Fier.

27.19 ASHK Fier²⁵ me shkresën nr. *** prot., datë 7.3.2024, informon se subjekti ka qenë i pajisur me leje ndërtimi, miratuar me vendimin nr. ***, datë 28.6.1994, të KRRT-së së Këshillit të Qarkut Fier, me akt kolaudimi në datën 3.2.2009, emërtimi i objektit banesë 2 kate, në lagjen “***”, Fier, ku përcaktohet se kanë përfunduar të dyja katet dhe janë gati për shfrytëzim me lejen e shfrytëzimit të datës 20.2.2009 nga Drejtoria e Urbanistikës e Këshilli i Qarkut Fier. Më tej, informon se procedura e legalizimit ka nisur me hartimin e procesverbalit të konstatimit në terren në datën 13.1.2010, në të cilin është përcaktuar se objekti është 2 kate + depo 1 kat. Në bazë të këtij akti konstatimi, vijon sqarimin ASHK, është hartuar genplani i datës 29.4.2010, ku nuk pasqyrohen të dhënat e ardhura nga procesverbali i konstatimit në terren, pasi: *“...genplani është hartuar jo në përputhje me procesverbalin e terrenit, i cili përcakton objektin dy kate, kati përdhe dhe kati i parë teknik të mbuluar plotësisht me çati, i cili duhet të përbënte ndërtim në të gjithë sipërfaqen e tij, fakt që passjell pasaktësi në hartimin e lejes së legalizimit”*.

27.20 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, të administruar edhe nga ILDKPKI-ja²⁶, konstatohet se me vendimin nr. ***, datë 19.9.1991, Komiteti Ekzekutiv Pluralist i *** ka vendosur t’i japë truall për ndërtim shtëpie subjektit Petrit Vukaj. Sipas formularit të lejes së ndërtimit, me vendimin nr. ***, datë 28.6.1994, subjektit i është dhënë leja e ndërtimit për objektin shtëpi banimi, ku parashikohet se objekti financohet nga vetë qytetari.

27.21 Në vijim konstatohet se në aktin e kolaudimit të datës 3.2.2009 pasqyrohet emërtimi i objektit banesë 2-katëshe, ndërsa në aktin e kontrollit të Drejtorisë së Urbanistikës së Këshillit të Qarkut Fier, pa datë, pasqyrohet emërtimi i objektit shtëpi banimi në *** dhe konkludohet se: *“Objekti është i përfunduar, funksionon banesë, zbatuar sheshi i ndërtimit”*. Në lejen e shfrytëzimit të objektit të datës 20.2.2009, pasi pasqyrohen të dhënat e lejes së sheshit dhe lejes së ndërtimit, citohet se: *“Objekti ka filluar funksionimin sipas destinacionit të miratuar në sheshin dhe lejen e ndërtimit”*.

27.22 Sa më lart, konstatohet se në lejen e ndërtimit të vitit 1994, në aktin e kontrollit të Drejtorisë së Urbanistikës dhe në lejen e shfrytëzimit nuk pasqyrohet emërtimi i objektit 2-katësh, sikurse pasqyrohet në aktin e kolaudimit.

27.23 Për sa i përket procesit të legalizimit, rezulton se në kohën kur subjekti është pajisur me leje legalizimi, neni 2²⁷ i ligjit nr. 9482/2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, përcaktonte se ky ligj zbatohet për të gjitha objektet e ndërtuara pa leje, të ngritura para datës së hyrjes në fuqi të tij²⁸. Në kushtet kur subjekti në formularin e vetëdeklarimit të datës datë 5.10.2006 ka deklaruar objektin 1 kat, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Qarku Fier, në aktin e kualifikimit të objektit të datës 29.4.2010 ka bërë kualifikimin e objektit 1 kat e më pas ka miratuar legalizimin për objekt 1 kat.

²⁵ Të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 26.9.2017, e ZQRPP-së (dosja ILDKPKI).

²⁷ Ligji nr. 9482/2006, neni 2 parashikon: *“Ky ligj zbatohet për të gjitha objektet e ndërtuara pa leje, të ngritura para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, pavarësisht nëse ato kanë funksion strehimi, veprimtarie ekonomike apo funksione të tjera social-kulturale, të ngritura dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar e që veprojnë sipas të drejtës tregtare shqiptare”*.

²⁸ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 36, datë 28.4.2006.

27.24 Sa më sipër, duket se regjistrimi i ndërtimit papafingo dhe i katit të parë teknik me sip. 102 m² në kartelën e pasurisë së paluajtshme nr. ***, z. k. ***, Fier, nuk bazohet në lejen e ndërtimit nr. ***, datë 28.6.1994 dhe në lejen e legalizimit nr. ***, datë 26.5.2010.

27.25 Në përfundim, Komisioni arriti në përfundimin se dukej se regjistrimin i katit të dytë të banesës me sip. 102 m² në vitet 2010 dhe 2017 është bërë jo sipas parashikimeve të ligjit nr. 9482/2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

27.26 Lidhur me këtë konstatim të Komisionit, subjekti ka dhënë shpjegime të cilat janë vlerësuar në tërësi së bashku me konstatimin e pasqyruar tek kriteri profesional po për këtë çështje, sikurse trajtohet në këtë vendim.

Lidhur me periudhën e ndërtimit të objektit dhe vlerën e investuar

28. Për përcaktimin e periudhës së ndërtimit dhe vlerën e investuar, Komisioni analizoi deklaratimet periodike të subjektit dhe dokumentacionin ligjor të administruar, si vijon:

Lidhur me ndërtimin e katit përdhe, me sip. 104 m²

28.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë truall dhe shtëpi banimi 2 kat dhe që kati i parë i banesës është ndërtuar në vitin 1992. Nuk ka deklaruar vlerën e investuar, por ka deklaruar vlerën totale të banesës pas rivlerësimit, në shumën 17.645.526 lekë.

28.2 Gjithashtu, edhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti nuk e ka deklaruar vlerën e investuar për ndërtimin e katit përdhe, sipas parashikimeve të formularit të ILDKPKI-së, duke mos plotësuar kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 9049/2003.

28.3 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*, të administruar dhe nga ish-ZQRPP-ja²⁹, rezulton se me vendimin nr. ***, datë 19.9.1991, Komiteti Ekzekutiv Pluralist i *** ka vendosur t’i japë truall për ndërtim shtëpie qytetarit Petrit Gj. V. Sipas formularit të lejes së ndërtimit, me vendimin nr. ***, datë 28.6.1994, subjektit i është dhënë leja e ndërtimit për objektin shtëpi banimi, ku parashikohet se ky objekt financohet nga vetë qytetari.

28.4 Në vijim, me vendimin nr. ***, datë 22.9.1994, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur pranimin e kërkesës së subjektit për vërtetim fakti, duke e njohur bashkëpronar me bashkëshorten e tij A. V. mbi “...shtëpi banimi njëkatëshe të ndodhur në ***... të përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë, aneks, korridor, banjo e verandë”.

28.5 Sa më sipër, konstatohet se deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* se katin e parë të banesës e ka ndërtuar në vitin 1992, nuk përputhet me dokumentacionin e administruar, pasi leja e ndërtimit është e datës 28.6.1994.

28.6 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1³⁰, subjekti shpjegon se pas marrjes së lejes së sheshit të ndërtimit ka filluar grumbullimin e materialeve të ndërtimit dhe në deklarinimin e tij ka pasur

²⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.9.2017 (administruar nga ILDKPKI-ja).

³⁰ Email datë 11.3.2024.

parasysh fillimin e ndërtimit në vitin 1992. Nga këqyrja e imazheve në platformën *Google Earth*³¹ konstatohet se imazhi i parë i disponueshëm për këtë pronë është në muajin korrik 2004.

28.7 Komisioni vëren se në vendimin e datës 22.9.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është vërtetuar fakti i ndërtimit të banesës nga subjekti, çka do të thotë që është e provuar se në muajin shtator 1994, ndërtimi i katit përdhe kishte përfunduar.

28.8 Sa më lart, bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratën *Vetting*, formularin e aplikimit për legalizimi, si dhe në vendimin e datës 22.9.1994 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duket se periudha e ndërtimit të katit përdhe ka qenë 1992 – shtator 1994.

28.9 Për sa i përket shumës së investuar për këtë kat, në përgjigje të pyetësorit nr. 1³², subjekti deklaroi se vlera totale e katit përdhe ka qenë 30.439 lekë dhe bashkëlidhur ka paraqitur raportin e vlerësimit të datës 10.8.2023, në të cilin eksperti vlerësues ka pasqyruar preventivin e punimeve dhe është shprehur se ky preventiv është hartuar sipas manualit të çmimeve për vitet 1985 – 1990, që sipas tij kanë qenë në fuqi deri në vitin 1996.

28.10 Komisioni vëren se, në kushtet kur nuk evidentohen referenca ligjore, metodologji, standarde apo të dhëna zyrtare të njohura për ndërtimet të cilat ekzistonin edhe në kohën e ndërtimit të kësaj pasurie dhe subjekti i rivlerësimit dështon të provojë me dokumentacion ligjor koston e objekteve të ndërtuara në mënyrë informale, kostoja do të përlllogaritet duke iu referuar çmimeve të përcaktuara ndër vite prej Entit Kombëtar të Banesave, si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi³³.

28.11 Komisioni konstaton se nuk disponohen të dhëna zyrtare nga EKB-ja mbi kostot e ndërtimit për vitet 1992 – 1994. Në këto kushte, për të përcaktuar koston në vitet 1992 – 1994, Komisioni iu referua të dhënave për koston e ndërtimit të vitit 1995 nga Enti Kombëtar i Banesave për qytetin e Fierit, e cila rezulton të ketë qenë 13.517 lekë³⁴/m², shumë e cila u indeksua me normën e inflacionit për vitet 1992 – 1994³⁵. Pas kryerjes së përlllogaritjeve, duke zbritur vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 8,83%³⁶ për vitin 1996 (viti më i afërt), rezulton se kostoja totale e ndërtimit për katin përdhe është 594.785 lekë³⁷.

28.12 Për sa i përket të ardhurave gjatë periudhës 1.6.1992 – 31.8.1994, nga dokumentacioni i paraqitur në deklaratën *Vetting*³⁸ konstatohet se nuk disponohet informacion për të ardhurat e kësaj periudhe. Konkretisht, DRSSH Fier ka përcjellë informacion lidhur me ardhurat nga paga duke filluar nga muaji shtator 1994 e në vijim.

³¹ Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti përcolli koordinatat sipas formatit UTM dhe në formatin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), sipas portalit shtetëror ASIG GEOPORTAL, si vijon: UTM Zone ***

Në platformën *Google Earth*, ky objekt rezulton të ketë këto koordinata: ***

³² Email datë 11.3.2024.

³³ Vendimet nr. 15 (JR), datë 17.7.2019, nr. 6 (JR), datë 17.3.2022 etj. të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

³⁴ <https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/Kosto-1995.png>

³⁵ <https://ndiqparate.al/?p=17130>

³⁶ Vendim nr. 06-2022 (JR), datë 17.3.2022, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi 14.8.

³⁷ Sipërfaqe 104 m² x kosto mesatare 1992 – 1994 në shumën 6.273 lekë = 652.392 lekë. Duke i zbritur kësaj shume 8,83% të vlerës, rezulton kostoja prej 594.785 lekësh.

³⁸ (i) Vërtetim nr. *** prot., datë 27.10.2016, i DRSSH Fier, ku citohet se për periudhën 1.6.1992 – 31.8.1994 nuk disponon informacion që të vërtetojë të ardhurat (paraqitur në deklaratën *Vetting*); (ii) akt verifikimi i vjetërsisë në punë përpara vitit 1994, ku citohet se nuk disponohen listëpagesa për të gjithë punonjësit e Hetuesisë Fier për periudhën 1.5.1992 – 13.8.1994 (paraqitur në pyetësorin standard).

28.13 Në këto kushte, për të përcaktuar të dhënat lidhur me të ardhurat për periudhën 1.6.1992³⁹ – 31.8.1994, kohë gjatë së cilës subjekti ka qenë i punësuar pranë Hetuesisë Fier, Komisioni u bazua në pagën përfituar në periudhën pasuese, pra 4.842 lekë/muaj. Për rrjedhojë, pagat për periudhën 1.6.1992 – 31.8.1994 u përllogaritën në shumën totale 130.734 lekë⁴⁰.

28.14 Nga përllogaritjet financiare, për të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për periudhën 1992 – gusht 1998, Komisioni konstatoi se dukej se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën -532.756 lekë për ndërtimin e katit përdhe.

Lidhur me ndërtimin e depos me sip. 23 m²

28.15 Në DIPP/2009, subjekti ka deklaruar depo, objekt ndihmës, ndërtuar në vitin 1998, e cila është në proces legalizimi së bashku me truallin. Vlera: 25.000 lekë.

28.16 Në procesverbalin e datës 7.6.2016, të ILDKPKI-së⁴¹, subjekti ka sqaruar se kur ka ndërtuar shtëpinë ka përfshirë dhe depon, e cila është ndërtuar me blloqe zhavorri, mbuluar me llamarinë dhe vlera e saj arrin deri në 25.000 lekë dhe se kjo depo është ndërtuar në vitin 1998.

28.17 Për sa i përket kostos së ndërtimit, Komisioni vëren se, në kushtet kur nuk evidentohen referenca ligjore, metodologji, standarde apo të dhëna zyrtare të njohura për ndërtimet të cilat ekzistojnë edhe në kohën e ndërtimit të kësaj pasurie dhe subjekti i rivlerësimit dështon të provojë me dokumentacion ligjor koston e objekteve të ndërtuara në mënyrë informale, kostoja do të përllogaritet duke iu referuar çmimeve të përcaktuara ndër vite prej Entit Kombëtar të Banesave, si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi⁴².

28.18 Për rrjedhojë, për përcaktimin e kostos së ndërtimit së depos me sip. 23 m², e cila sipas deklaramentit të subjektit është ndërtuar në vitin 1998, Komisioni iu referua të dhënave zyrtare të publikuara nga EKB-ja⁴³, ku kostoja mesatare e ndërtimit në qytetin e Fierit në vitin 1998 rezulton 21.400 lekë/sipërfaqe ndërtimi.

28.19 Gjithashtu, Komisioni mori në konsideratë se kostoja e një ndërtimi të tipit depo, të cilit i mungojnë shumë elemente strukturore në raport me një objekt të përfunduar të tipit banesë, nga ato për të cilat EKB-ja, në bazë të VKM-ve përkatëse, përcakton çmimet referuese, është pa dyshim e ndryshme dhe duhet të trajtohet si e tillë edhe për qëllime fiskale, diferencë e cila orientohet të jetë në masën 50% të çmimit referues⁴⁴. Duke zbritur vlerat që i korrespondojnë

³⁹ Lidhur me të ardhurat përpara kësaj periudhe, Komisioni iu referua vendimit nr. 15-2021 (JR), datë 18.6.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku Kolegji në funksion të një qëndrimi orientues, sipas parashikimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashtron: “[...] periudha kohore para ndryshimeve demokratike në vend që përkon me vitet 1991 – 1992, nuk mund të jetë si rregull një periudhë e cila mund të llogaritet në funksion të përcaktimit të ndonjë vlere të kursyer, për shkak të një realiteti të jetuar që ka provuar se monedha zyrtare, leku, në këtë periudhë pësoi një inflacion në nivele shumë të larta e të jashtëzakonshëm, produkt i ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend që e bën të pabesueshme dhe të palogjikshme mundësinë potenciale të kursimit nga të ardhurat nga puna në këto periudha. Për pasojë, pasi monedha vendase hyri në një fazë stabiliteti, pas viteve 1992-1993, mundësia për të kursyer mund të konsiderohet si opsion [...]”. Për rrjedhojë, për efekt të analizës financiare, Komisioni mori në konsideratë të ardhurat nga paga e subjektit duke filluar nga viti 1.6.1992 e në vijim”.

⁴⁰ 27 muaj x 4.842 lekë.

⁴¹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2023, e ILDKPKI-së.

⁴² Vendimet nr. 15 (JR), datë 17.7.2019, nr. 6 (JR), datë 17.3.2022 etj. të Kolegjit.

⁴³ Vendim nr. ***, datë 28.4.1999.

⁴⁴ Paragrafi 15.2, vendimi nr. 34/2022 i Kolegjit.

fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 8,83%⁴⁵ për vitin 1998, rezulton se kostoja totale e ndërtimit për depon është 224.369 lekë⁴⁶.

28.20 Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën shtator 1994 – 1998, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për ndërtimin e depos me sip. 23 m².

Lidhur me ndërtimin e katit të parë (dytë), me sip. 102 m²

28.21 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë truall dhe shtëpi banimi 2 kat dhe që kati i dytë i banesës është ndërtuar në vitet 2008, 2009 dhe 2010. Nuk ka deklaruar vlerën e investuar, por ka deklaruar vlerën totale të banesës pas rivlerësimit, në shumën 17.645.526 lekë.

28.22 Në procesverbalin e datës 7.6.2016 të ILDKPKI-së⁴⁷, subjekti ka deklaruar se katin e dytë prej 102 m² e ka ndërtuar në vitet 2008 – 2009 – 2010, në vlerën totale 650.000 lekë, konkretisht 285.000 lekë në vitin 2008, 300.000 lekë në vitin 2009 dhe 74.000 lekë në vitin 2010, sipas deklarimeve të tij në deklaratat periodike vjetore.

28.23 Në përgjigje të pyetësorit standard⁴⁸, subjekti ka deklaruar se që nga momenti i marrjes së detyrës si prokuror në datën 1.5.2003, ka kryer shpenzime për ndërtimin e një ambienti banimi kati 1, mbi katin 0, banesa ekzistuese, në bashkëpronësinë e tij dhe të bashkëshortes për nevoja banimi dhe ndërtimi është kryer pjesë-pjesë përgjatë viteve 2008, 2009 dhe 2010, me vlerë totale 659.000 lekë.

28.24 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1⁴⁹, subjekti deklaroi se vlera totale e katit të parë është 650.000 lekë dhe burim i krijimit kanë qenë të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe kontributi i punës vullnetare të kryer nga të afërmit. Për vërtetimin e deklaramit subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues⁵⁰.

28.25 Nga analizimi i dokumentacionit të administruar konstatohet se: (i) në vitin 1991 subjektit i është dhënë truall për ndërtim shtëpie; (ii) në vitin 1994 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vërtetuar faktin e ndërtimit të objektit shtëpi banimi njëkatëshe, të përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë, aneks, korridor, banjo e verandë⁵¹, pa përcaktuar sipërfaqen; (iii) në dokumentin vërtetim nga dokumenti hipotekor i datës 5.6.2002⁵², sipërfaqja e banesës pasqyrohet 102 m²; (iv) në formularin për legalizim objekti të vitit 2006, subjekti ka deklaruar shtëpi banimi 1 kat, ndërtuar në vitin 1992, truall me sip. 300 m², sipërfaqe ndërtimi 102, mbulesa solet B/A, garazh 2.360 m (23,6 m²)⁵³.

28.26 Referuar dokumentacionit të mësipërm, duket se në periudhën 1994 – 2006 subjekti ka disponuar një banesë 1 kat me sip. 102 m², në fshatin ***, Fier.

28.27 Në vijim, në deklaratat periodike vjetore subjekti ka deklaruar: (i) në DIPP/2008, investim në godinën ekzistuese në shumën 285.000 lekë; (ii) në DIPP/2009, investim në banesë,

⁴⁵ Vendim nr. 06-2022 (JR), datë 17.3.2022, i Kolegjit, paragrafi 14.8.

⁴⁶ Sipërfaqe 23 m² x 21.400 x 50% = 246.100 lekë. Duke i zbritur kësaj shume 8,83% të vlerës, rezulton kostoja prej 224.369 lekësh.

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2023, e ILDKPKI-së.

⁴⁸ Email datë 27.1.2021.

⁴⁹ Email datë 11.3.2024.

⁵⁰ Raport vlerësimi të shtesës mbi katin përdhe, datë 18.1.2021; raport vlerësimi të pasurisë truall dhe banesë 2 kate, datë 10.8.2023.

⁵¹ Vendim nr. ***, datë 22.9.1994, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁵² Të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017; të administruar dhe nga ZQRPP-ja (dosja ILDKPKI).

⁵³ Formulari për legalizim i datës 5.10.2006 + fotot shoqëruese.

që ka të bëjë me shtesën me sip. 57,6 m², kati i dytë me vlerë 300.000 lekë; (iii) në DIPP/2010 ka deklaruar në total katin e dytë me sip. 102 m² dhe investime në banesë të cilat kanë të bëjnë me ambientet e brendshme të shtëpisë, në shumën 74.000 lekë.

28.28 Në dosjen e legalizimit të objektit të administruar nga ASHK-ja⁵⁴ gjenden planimetritë e datës 13.1.2010 të specialistëve të konstatimit në terren, si dhe konstatohet planimetria e katit përdhe, katit të parë (+ çati në skicat e dorës), planimetria e depos dhe procesverbali i konstatimit i datës 13.1.2010, i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Fier, për objektin banesë 1 kat, të deklaruar nga subjekti, ku pasqyrohen këto të dhëna: “...sipërfaqja e bazës së objektit 104 m²; sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit 161.6 m²; numri i kateve mbi tokë 2... mur rrethues 31.4 m², garazh 22.4 m²” dhe se objekti është i ndarë në kate: “kati përdhe 104, i parë 57,6”.

28.29 Sa më lart, referuar deklaramëve dhe dokumentacionit të administruar, arrihet në përfundimin se deri në datën 13.1.2010 subjekti ka ndërtuar sipërfaqen prej 57,6 m² nga 102 m² në total.

28.30 Në këto kushte, Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1⁵⁵ i kërkoi subjektit të deklaronte se kur e ka ndërtuar sipërfaqen 44,4 m² (diferenca midis 102 m² dhe 57,6 m²) dhe sa ka qenë vlera e investuar.

28.31 Në përgjigje⁵⁶ subjekti deklaroi se: “Në DPV-në e vitit 2008, që përkojnë me investimin e bërë në katin e dytë të banesës... shtesa në katin e dytë ka qenë 57,6 m². Më pas, në vitin 2009, kanë vazhduar punimet duke përfunduar e gjithë shtesa sipas lejes së ndërtimit dhe në total 102 m². Për ndërtimin e kësaj shtese, e cila është me konstrukcion metalik, ka kontribuar kunati im (vëllai i gruas), i cili në profesion është saldator... Ai ka ndërtuar totalisht ...katin e dytë të banesës...”. Në vijim, sqaron se evidentimi i procesverbalit të datës 13.1.2010 i ASHK-së nuk është i saktë dhe nuk i përgjigjet gjendjes faktike të atij viti, sikurse sipas tij ka sqaruar ASHK Fier, e cila është shprehur se: “...genplani është hartuar jo në përputhje me procesverbalin e terrenit, i cili përcakton objektin dy kate, kati përdhe dhe kati i parë teknik të mbuluar plotësisht me çati i cili duhet të përbënte ndërtim në të gjithë sipërfaqen e tij, fakt që passjell pasaktësi në hartimin e lejes së legalizimit”. Për vërtetimin e deklaramit subjekti ka paraqitur deklaramen noteriale nr. ***, datë 6.3.2024, të shtetasit F. Xh., që konfirmon deklaramin e subjektit për ndërtimin e katit të dytë.

28.32 Nga analizimi i dokumentacionit të administruar dhe deklaramëve të subjekti Komisioni konstatoi se dukej se:

28.32.1 Për sa i përket deklaramit të subjektit se gjatë vitit 2009 ka vijuar me ndërtimin e shtesës sipas lejes së ndërtimit, Komisioni vëren se sipas ligjit nr. 7693/1993⁵⁷, “Për urbanistikën”, i ndryshuar, që ka qenë në fuqi në kohën kur është dhënë leja e ndërtimit nr. ***, datë 28.6.1994, leja e ndërtimit jepej për një periudhë 6-mujore, për pasojë shtesa e katit të dytë e pretenduar nga subjekti si e ndërtuar në vitin 2009 nuk bazohet në lejen e ndërtimit.

⁵⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 12.2.2021, e ASHK-së.

⁵⁵ Email datë 26.2.2024.

⁵⁶ Email datë 11.3.2024.

⁵⁷ Neni 33 parashikon: “Leja e ndërtimit është e vlefshme për 6 muaj. Kur objekti që i jepet leje kërkon një kohë zbatimi më të gjatë se 6 muaj, leja e ndërtimit jepet për aq kohë sa kërkon ndërtimi i objektit”.

28.32.2 Lidhur me shpjegimin e subjektit dhe arsyetimin e ASHK-së Fier se procesverbali i konstatimit në terren i datës 13.1.2010 i ish-Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Fier, që ka konstatuar katin e parë me sip. 57.6 m², nuk është i saktë, Komisioni konstaton se ky dokument, në kuptim të nenit 253⁵⁸ të Kodit të Procedurës Civile, është një akt zyrtar dhe përbën provë të plotë për faktet e konstatuara dhe lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar. Akti i kolaudimit i datës 3.2.2009, në të cilin pasqyrohet se objekti është dykatësh, nuk provon falsitetin e procesverbalit të konstatimit të ish-Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Fier, për sa kohë që: (i) sipas parashikimeve të ligjit nr. 8402/1998⁵⁹, emërimi i kolaudatorit është bërë nga zhvilluesi; (ii) në aktin e kontrollit të Drejtorisë së Urbanistikës të Qarkut Fier dhe në lejen e shfrytëzimit të datës 20.2.2009 nuk pasqyrohet dhënia e lejeve për banesë dykatëshe.

28.33 Sa më sipër, rezulton se deklarimi i subjektit në pyetëtorin nr. 1 se në vitin 2009 ka përfunduar katin e dytë me sip. 102 m², nuk mbështetet në dokumentacionin justifikues. Për pasojë, Komisioni mori në konsideratë se subjekti në vitin 2009 ka ndërtuar sipërfaqen prej 57,6 m² dhe në vitin 2010 sipërfaqen prej 44,4 m².

28.34 Lidhur me shumën e investuar për ndërtimin e shtesës së katit të dytë, subjekti në përgjigje të pyetësorit standard⁶⁰ dhe të pyetësorit nr. 1⁶¹ ka deklaruar se vlera e katit të parë (kati i dytë) është 650.000 lekë dhe ka paraqitur raportin e vlerësimit të datës 18.1.2021 për shtesën mbi katin përdhe me sip. 102 m², të hartuar nga një vlerësues i licencuar, në të cilin pasqyrohet se kostoja e investimit është në vlerën 654.984 lekë.

28.35 Nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtij raporti konstatohet se eksperti vlerësues në përlllogaritjen e vlerës së ndërtimit shprehet se *“Vlerësimi është bërë në përputhje me standardet evropiane të aprovuara të vlerësimit”*, por nuk pasqyron ndonjë referencë konkrete.

28.36 Në kushtet kur nuk evidentohen referenca ligjore, metodologji, standarde apo të dhëna zyrtare të njohura për ndërtimet të cilat ekzistonin edhe në kohën e ndërtimit të kësaj pasurie dhe subjekti i rivlerësimit dështon të provojë me dokumentacion ligjor koston e objekteve të ndërtuara në mënyrë informale, kostoja do të përlllogaritet duke iu referuar çmimeve të përcaktuara ndër vite prej Entit Kombëtar të Banesave, si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi⁶².

28.37 Në vijim, Komisioni konstaton se, referuar koston mesatare të ndërtimit në qytetin e Fierit në vitet 2008 dhe 2009, kur subjekti ka ndërtuar shtesën me sip. 57,6 m², vlera për këtë sipërfaqe ndërtimore përlllogaritet në 1.596.096 lekë (57,6 x 27.710 lekë/m²)⁶³, e cila duke u pjesëtuar përlllogaritet në vlerën 798.048 lekë për secilin vit. Ndërsa për vitin 2010⁶⁴ kostoja e ndërtimit

⁵⁸ Kodi i Procedurës Civile parashikon: *“Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”*.

⁵⁹ Neni 12 parashikon: *“Emërimi i kolaudatorit apo i grupit të kolaudimit është detyrë e zhvilluesit, i cili duhet që këtë t’ia komunikojë personit, institucionit që do të merret me kolaudimin dhe autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit të rretheve apo bashkive, brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit. Zhvilluesi do të përcaktojë afatet e zgjatjes së procesit të kolaudimit”*.

⁶⁰ Email datë 29.1.2021.

⁶¹ Email datë 11.3.2024.

⁶² Vendimet nr. 15 (JR), datë 17.7.2019, nr. 6 (JR), datë 17.3.2022 etj. të Kolegjit.

⁶³ Në vitet 2008 – 2009 kostoja mesatare e ndërtimit rregullohej sipas udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008, të Këshillit të Ministrave.

⁶⁴ Udhëzimi nr. 3, datë 3.2.2010, i Këshillit të Ministrave.

për sipërfaqen ndërtimore prej 44,4 m² llogaritet në vlerën 1.257.452 lekë (44,4 x 28.321 lekë/m²).

28.38 Në vijim, referuar arsyetimit lidhur me periudhën e ndërtimit, Komisioni kreu përlllogaritjet për shumën e kostos së ndërtimit për vitet 2008 – 2009 – 2010, duke zbritur vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 8,55%, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit⁶⁵, nga ku rezultoi një kosto totale prej 2.609.570 lekësh.

28.39 Më tej, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme për ndërtimin e banesës.

28.40 Në kushtet që në vitin 2009 subjekti ka blerë një pasur të luajtshme (automjeti i trajtuar në pikën nr. 2 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht), Komisioni e kreu analizën financiare të vitit 2009 të ndarë në dy pjesë, referuar burimeve financiare të përdorura për secilin rast (për blerjen e automjetit me targë *** kanë shërbyer si burim të ardhurat nga shitja e automjetit me targë ***), nga ku rezultoi se në vitin 2010 subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -713.857 lekë për ndërtimin e katit të parë, për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve⁶⁶.

28.41 Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare: (i) në shumën -532.756 lekë për ndërtimin e katit përdhe dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë periudhës 1992 – 1994; (ii) në shumën -713.857 lekë për ndërtimin e katit të parë, për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010 (në total -1.246.613 lekë).

28.42 Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁶⁷, subjekti i rivlerësimit paraqiti pretendimet e tij, si në vijim:

28.42.1 Lidhur me mungesën e burimeve financiare për ndërtimin e katit të parë (për të cilin subjekti pretendon një shumë investimi prej 30.439 lekësh përkundrejt shumës 594.758 lekë të përlllogaritur nga Komisioni), subjekti shpjegon se Komisioni i ka dhënë fuqi prapavepruese një udhëzimi të Këshillit të Ministrave të miratuar në vitin 1995, ndërkohë që vlerëson se nuk ndodhet në këto kushte, për shkak se ky udhëzim nuk përcaktonte dhënien e fuqisë prapavepruese të aktit. Më pas shpjegon se çmimet e referencës së EKB-së nuk duhen marrë parasysh, pasi në ndërtimin e banesave në atë periudhë (vitet 1991 – 1992) nuk merreshin apo punësoheshin punëtorë krahu, sepse ndërtimet informale për banesa janë kryer gjithnjë me ndihmën e familjarëve, sikundër edhe në rastin e tij ndërtimi është kryer me kontribute vullnetare dhe sipas materialeve të ndërtimeve që përdorëshin në atë kohë për ndërtimin e një banese për strehim. Për të provuar këtë fakt citon deklaratën noteriale të datës 6.3.2024 të lëshuar nga shtetasit F. Xh. dhe P. Xh. (të paraqitur në pyetësin nr. 1), të cilët konfirmojnë faktin se kanë dhënë kontributin e tyre vullnetar për ndërtimin e kësaj banese, si dhe ka paraqitur

⁶⁵ Vendim nr. 06-2022 (JR), datë 17.3.2022, i Kolegjit, paragrafi 16.6.

⁶⁶ Balanca negative për blerjen e automjetit në vitin 2009 është trajtuar në pikën nr. 2 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

⁶⁷ Email datë 4.6.2024.

deklaratën noteriale të datës 27.5.2024 të lëshuar nga shtetasit A. Ll., L. P. dhe A. N. (të afërm të bashkëshortes), të cilët deklarojnë kontributin e tyre në ndërtimin e banesës.

28.42.2 Në vijim, subjekti ka paraqitur një raport rivlerësimi të datës 28.5.2024, të përgatitur nga ekspertë të licencuar, të cilët kanë sqaruar se në periudhën 1992 – 1994 nuk ka pasur publikime zyrtare të azhurnimit të manualit të çmimeve dhe i vetmi manual i aplikueshëm është ai i viteve 1986 – 1990, për përllogaritjen e kostos së ndërtimit për katin e parë.

28.42.3 Lidhur me analizën financiare, subjekti kërkon nga Komisioni që: (i) të llogarisë shpenzimet jetike në masën 30% të të ardhurave, mbështetur në vendimin nr. 15/2021 të Kolegjit, ku standardet tona të jetesës kanë qenë ato të një familjeje bujqësore, nga ku pjesa më e madhe e të ardhurave buronin nga punimi i tokës dhe vjelja e tyre; (ii) të saktësojë të ardhurat e bashkëshortes për periudhën 1.4.1991 – 1.6.1993, duke pasqyruar shumën 108.992 lekë, bazuar në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me nr. ***, datë 16.2.2024, sipas të cilit rezulton se: *“...A. V. (Xh.) ka qenë në marrëdhënie pune si agronome pranë ish-Ndërmarrjes Bujqësore “****” Fier, për periudhën 1.4.1991 deri më datë 1.6.1993. Sipas shkresës nr. *** prot., datë 6.9.2023, të personit të tretë, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier, rezulton se paga referuese për këtë periudhë për punonjësit me arsim të lartë në ish-Ndërmarrjet Bujqësore, profesioni agronome, ka qenë 4.192 lekë”*; (iii) të përllogarisë të ardhurat nga punësimi i subjektit pranë ndërmarrjes “****” Fier, sektori ***, për periudhën 6.6.1991 – 30.6.1992, sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 28.10.2016, për vjetërsinë në punë për efekt pensioni dhe në kushtet kur listëpagesat nuk disponohen, përllogaritja të bëhet sipas pagave referuese para vitit 1994, mbi të cilat bazohet ISSH-ja për llogaritjen e pensioneve, duke paraqitur të ardhura në shumën 36.829 lekë⁶⁸; (iv) të pasqyrojë të ardhurat e tij si hetues nga data 1.7.1992, në shumën totale 184.000 lekë; (v) të pasqyrojë të ardhurat që burojnë nga AMTP-ja, sipas vlerësimit agroteknik të Sektorit të Ekstensionit Bujqësor Fier. Lidhur me këto kërkesa, subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues⁶⁹.

28.42.4 Në përfundim, subjekti paraqiti analizën financiare për periudhën qershor 1991 – gusht 1994, ku paraqiten të ardhurat totale në shumën 303.344 lekë, shpenzimet e jetesës në shumën 91.003 lekë dhe shpenzimi për investim në katin në përdhe në shumën 30.439 lekë, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën 181.902 lekë.

28.42.5 Lidhur me mungesën e burimeve financiare për ndërtimin e katit të dytë (për të cilin subjekti pretendon një shumë investimi prej 650.000 lekësh përkundrejt shumës 2.609.570 lekë të përllogaritur nga Komisioni), subjekti shpjegon se edhe në këtë rast të dhënat e Entit Kombëtar të Banesave nuk mund të arrijnë një vlerësim të drejtë të kostos së ndërtimit, pasi ndërtimi i këtij kati nuk ka pasur vlerën e përllogaritur nga Komisioni, i cili ka përdorur si bazë llogaritjeje çmimet e EKB-së. Subjekti shpjegon se Komisioni bazohet tek kostot e EKB-së, të cilat janë çmime referuese dhe, si të tilla, ato kanë një vlerë udhëzuese; ato përdoren për vlerësimin e një investimi kur nuk ka asnjë dokument tjetër të kohës që ta provojë këtë vlerë dhe gjithashtu nuk ka një vlerësim konkret të llojit të punimeve të kryera.

⁶⁸ Ku për punëtor bujqësie rezulton 2.833 lekë/muaj (13 muaj x 2.833 lekë/muaj = 36.829 lekë).

⁶⁹ Vendim nr. *** datë 16.2.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier; vërtetimet nr. *** dhe nr. *** datë 2.8.2023, të Prokurorisë së Përgjithshme; vlerësim agronomik për kulturat bujqësore nr. *** prot., datë 1.9.2023, i Sektorit të Ekstensionit Bujqësor Fier; vërtetim nr. *** prot., datë 26.7.2023, i zyrës së Tatim Taksave të Njësisë Administrative Qendër; AMTP nr. ***; shkresë nr. *** prot., datë 17.8.2023, e DRISSH Fier; shkresën nr. *** prot., datë 6.9.2023, e DRISSH Fier; shkresë nr. *** prot., datë 12.9.2023, e Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Lushnjë.

28.42.6 Gjithashtu, subjekti deklaroi se Komisioni e ka përlllogaritur koston e ndërtimit sikur ndërtimi është bërë nga fillimi. Sikurse evidentohet nga fotot e dorëzuara gjatë hetimit administrativ dhe në vlerësimin e kryer nga ekspertët, vijon subjekti, punimet e ndërtimit për këtë kat janë kryer mbi një ndërtesë ekzistuese, pra nuk ka pasur nevojë të bëhen themele nga e para dhe punime fillestare, të cilat përbëjnë 44,1% të punës sipas zërave të preventivit. Gjithashtu, shprehet se edhe në rastin e marrjes për bazë të çmimeve të EKB-së, Komisioni duhet të kishte përlllogaritur një vlerë shpenzimesh të paktën 44,1% më pak nga çka është përlllogaritur.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

28.43 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratat në seancë dëgjimore – arsyeton si vijon:

28.43.1 Për sa i përket pretendimit të subjektit për përlllogaritjen e shumës së investuar në katin e parë në masën 30.439 lekë, përkundrejt shumës prej 594.758 lekësh të përlllogaritur nga trupi gjykues, çmon se ky pretendim duhet të vlerësohet në raport me tërësinë e fakteve të dala për këtë çështje specifike si në vijim trajtohet.

28.43.2 Lidhur me pretendimin e subjektit për përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës në masën 30% të të ardhurave, bazuar në vendimin nr. 15/2021 të Kolegjit, trupi gjykues i qëndron përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës për periudhën 1992 – 1999, bazuar në vendimin nr. 15/2021 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sikurse është parashtruar në aneksin nr. 2, me emërtim “Metodika e përdorur për analizën financiare”, që i është përcjellë subjektit së bashku me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht. Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur në masën 30% të të ardhurave vetëm për vitet gjatë të cilave janë përfituar të ardhura më të larta se 800 USD/vit, në përputhje me jurisprudencën e lartpërmendur. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit vlerësohet i pabazuar dhe shuma e shpenzimeve të jetesës mbetet e pandryshuar.

28.43.3 Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirje në analizë financiare të të ardhurave të bashkëshortes për periudhën 1.4.1991 – 1.6.1993 dhe për përlllogaritjen e të ardhurave nga punësimi i subjektit pranë ndërmarrjes “****” Fier, Sektori ***, trupi gjykues, në analizë të të dhënave të përfituara nga aktet e administruara, konstaton se subjekti është bazuar mbi pagat referuese për efekt të llogaritjes së pensionit dhe jo mbi pagat e përfituara efektivisht.

28.43.4 Në këtë çështje, për të ardhurat përpara viteve 1991 – 1992, Komisioni i është referuar vendimit nr. 15-2021 (JR), datë 18.6.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku Kolegji në funksion të një qëndrimi orientues, sipas parashikimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashtron: “[...] *periudha kohore para ndryshimeve demokratike në vend që përkon me vitet 1991 - 1992, nuk mund të jetë si rregull një periudhë e cila mund të llogaritet në funksion të përcaktimit të ndonjë vlere të kursyer, për shkak të një realiteti të jetuar që ka provuar se monedha zyrtare, leku, në këtë periudhë pësoi një inflacion në nivele shumë të larta e të jashtëzakonshëm, produkt i ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend, që e bën të pabesueshme dhe të palogjikshme mundësinë potenciale të kursimit nga të ardhurat nga puna*

në këto periudha. Për pasojë, pasi monedha vendase hyri në një fazë stabiliteti, pas viteve 1992 – 1993, mundësia për të kursyer mund të konsiderohet si opsjon [...]”. Për rrjedhojë, Komisioni e konsideron të pabazuar pretendimin e subjektit.

28.43.5 Lidhur me pretendimin e subjektit për përlogaritjen e të ardhurave të tij në shumën totale prej 184.000 lekësh për këtë periudhë, trupi gjykues i qëndron shumës së përlogaritur gjatë rezultateve të hetimit në masën 150.102 lekë⁷⁰, pasi si referencë për periudhën për të cilën mungojnë të dhëna është përdorur informacioni i administruar nga hetimi⁷¹.

28.43.6 Lidhur me pretendimin e subjektit për përfshirjen e të ardhurave që burojnë nga AMTP-ja, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë, pasi nuk rezulton që subjekti t’i këtë deklaruar këto të ardhura ndër vite dhe në deklaratën *Vetting*, dhe se në analizë të dokumentacionit të depozituar nga subjekti përfitohen të dhëna për mundësinë e përfitimit të këtyre të ardhurave, porse nuk arrihet të provohet përfitimi real/efektiv i disponibilitetit të tyre.

28.43.7 Trupi gjykues, pas analizimit të pretendimeve të subjektit, në raport më gjendjen faktike të kësaj çështjeje, vlerëson se efekti financiar për ndërtimin e katit të parë deri në shtator të vitit 1994 duhet të çmohet në proporcion me disa fakte të qenësishme, të tilla si:

i) Bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratën *Vetting*, formularin e aplikimit për legalizim⁷², si dhe vendimin e datës 22.9.1994 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton e provuar se periudha e ndërtimit të katit përdhe ka qenë 1992 – shtator 1994.

ii) Të dhënat e përfituara sipas këtij dokumentacioni të sipërcituar, parë në këndvështrimin e përcaktimit të periudhës së ndërtimit për këtë kat, i gjen në harmoni me deklaratimet e subjektit në procesverbalin e datës 7.6.2016 të ILDKPKI-së, ku ai ka deklaruar se mobilimi i shtëpisë është modest dhe është kryer që nga viti 1992 e në vijim, me burim të ardhurat familjare, apo edhe në pyetësorin standard, ku subjekti ka specifikuar disa blerje të kryera gjatë periudhës 1992 – 2016, në shumën totale 219.000 lekë.

iii) Sipas formularit të lejes së ndërtimit, me vendimin nr. ***, datë 28.6.1994, subjektit i është dhënë leja e ndërtimit për objektin shtëpi banimi, ku parashikohet se objekti financohet nga vetë qytetari.

iv) Nuk disponohen të dhëna zyrtare për periudhën 1992 – 1994 nga EKB-ja mbi kostot e ndërtimit.

v) Nuk disponohen të dhëna mbi të ardhurat nga pagat e subjektit përpara periudhës shtator 1994.

vi) Rezulton se subjekti ka bërë përpjekje për të parashtruar një mënyrë përlogaritjesh, duke paraqitur aktin e ekspertimit me referencë në materialin “Përmbledhje e manualit të preventivit për vitet 1986 – 1990”.

⁷⁰ Totali të ardhurave për periudhën 1.6.1992 – 31.8.1994 (130.734 lekë) dhe për periudhën 1.9.1994 – 31.12.1994 (19.368 lekë, bazuar në vërtetimi nr. *** prot., datë 27.10.2016, të DRSSH-së Fier).

⁷¹ (i) Vërtetim nr. *** prot., datë 27.10.2016, i DRSSH-së Fier, ku citohet se për periudhën 1.6.1992 – 31.8.1994 nuk disponon informacion që të vërtetojë të ardhurat (paraqitur në deklaratën *Vetting*); (ii) akt-verifikimi i vjetërsisë në punë përpara vitit 1994, ku citohet se nuk disponohen listëpagesa për të gjithë punonjësit e Hetuesisë Fier për periudhën 1.5.1992 – 13.8.1994 (paraqitur në pyetësorin standard).

⁷² Sipas verifikimit të praktikës, rezulton se nga subjekti i rivlerësimit objekti është deklaruar “shtëpi banimi 1 kat”, adresë ***, viti i ndërtimit 1992, sipërfaqe e zënë 300 m², sipërfaqe ndërtimi 102, lloji i mbulesës solet B/A, garazh 23,60 m².

28.43.8 Këto fakte, në proporcionalitet me rrethanën konstatuese se në këtë periudhë subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrë, si dhe masën e balancës negative në shumën 532.756 lekë, e cila për arsyet e parashtruara më sipër nuk duket të jetë reale, çmohen nga trupi gjykues si të pamjaftueshme për t'i ngritur ato në nivelin e një shkakui penalizues për subjektin për efekt të këtij procesi.

28.43.9 Për sa i përket pretendimit të subjektit për përlllogaritjen e shumës së investuar në katin e parë në masën 650.000 lekë, përkundrejt shumës 2.609.570 lekë të përlllogaritur nga Komisioni, ku si rezultat është konkluduar në balancë negative në shumën 713.857 lekë, trupi gjykues vëren se edhe pse duket se qëndron pretendimi i subjektit se nuk kemi të bëjmë me një ndërtim nga themelet, dhe për pasojë edhe kostoja e ndërtimit nuk mund të jetë objektivistike reale, përsëri kjo pamjaftueshmëri nuk mbetet plotësisht e provuar, por çmohet në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesit të rivlerësimit për këtë subjekt.

29. Automjet tip “Daimler Chrysler”, me vlerë 3.600 euro dhe 348.430 lekë

29.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar: “*Automjet tipi “Daimler Chrysler”, ***, viti i prodhimit 2001, me targa ***. Blerë në vitin 2009. Vlera 3.600 euro + 348.430 lekë, shumë e përfutur nga shitja e Benzit me targë ***. Zotëroj 100%*”. Për vërtetimin e deklaratimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁷³.

29.2 Referuar dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR-ja⁷⁴ rezulton se me aktin e shitblerjes datë 28.4.2009 subjekti ka blerë në Gjermani automjetin tip “Daimler Chrysler”, të vitit 2001, kundrejt çmimit 3.600 euro. Ky automjet është zhdoganuar në datën 7.5.2009, me deklaratë doganore nr. *** dhe subjekti ka paguar detyrime doganore në vlerën 348.430 lekë⁷⁵. Në fillim ky automjet është regjistruar në datën 16.7.2009 me targë *** e më pas është regjistruar me targë ***⁷⁶.

29.3 Në përgjigje të pyetësorit standard⁷⁷, subjekti ka deklaruar: “*Në datën 28.4.2009 kam blerë automjetin me targë *** në Gjermani përkundrejt vlerës 3.600 euro. Kjo është përballuar nga shitja e mjetit të parë, me targë *** në vlerën 1.000.000 lekë. Në të gjitha rastet mënyra e pagesës ka qenë cash në dorë*”.

29.4 Në vijim, Komisioni analizoi blerjen dhe shitjen e automjetit me targë ***, të ardhurat nga shitja e të cilit kanë shërbyer për blerjen e automjetit me targë ***, të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

29.5 Lidhur me blerjen e automjetit me targë ***, konstatohet se në DIPP/2005 subjekti ka deklaruar: “*Automjet tip “Mercedes-Benz” me targë ***. Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., vlera 250.000 lekë*”. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit

⁷³ Certifikatë pronësie për automjetin me targë *** akt shitblerjeje datë 28.4.2009; deklaratë doganore + mandat pagesë Raiffeisen Bank të datës 7.5.2009; kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 15.8.2005; kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** datë 4.4.2009.

⁷⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 16.10.2023.

⁷⁵ Referuar mandatit bankar të datës 7.5.2009.

⁷⁶ Ky automjet është shitur në vitin 2019 nga subjekti në shumën 500.000 lekë.

⁷⁷ Email datë 27.1.2021.

nr. 9049/2003, por në përgjigje të pyetësorit standard ka deklaruar se shpenzimet për blerjen e tij janë mbuluar nga paga e tij dhe e bashkëshortes⁷⁸.

29.6 Referuar dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR-ja⁷⁹, të paraqitur edhe nga subjekti në deklaratën *Vetting*, rezulton se me kontratën nr. ***, datë 15.8.2005, subjekti ka blerë nga shtetasi S. S. automjetin tip “Mercedes-Benz 200” me targë ***, vit prodhimi 1992, me çmim 250.000 lekë. Në datën 9.6.2006, subjekti ka paraqitur në DRSHTRR kërkesën për ndryshimin në regjistrin e mjeteve rrugore e më pas automjeti është bërë me targë ***.

29.7 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të origjinës së automjetit të mësipërm konstatohet se sipas kontratës së shitjes së mjetit të datës 30.11.2004, shtetasi S. S. e ka blerë automjetin në Gjermani në vlerën 250 euro.

29.8 Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare në datën 15.8.2005 për pasuritë, të ardhurat, shpenzimet dhe detyrimet e subjektit të rivlerësimit dhe personat e lidhur, paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela nr. 1 – Analiza financiare datë 15.8.2005, blerja e automjetit me targë ***

Përshkrimi	Shuma
Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë *** (***) , vit prodhimi 1992	250,000
Shtim likuiditete bankë	51,906
Total pasuri	301,906
Të ardhura nga pagat e subjektit	512,235
Të ardhura nga pagat e bashkëshortes	103,362
Total të ardhura	615,597
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	273,893
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	40,438
Total shpenzime	314,331
Balanca e fondeve (të ardhura – pasuri – shpenzime)	-640

29.9 Sa më lart, në kushtet kur konstatohet një balancë negative mospërfillëse, duket se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit në shumën 250.000 lekë, në vitin 2005.

29.10 Lidhur me shitjen e automjetit me targë *** në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 4.4.2009, pasqyrohet se subjekti ia ka shitur automjetin e mësipërm kundrejt çmimit 1.000.000 lekë shtetasit A. Z.. Gjithashtu, rezulton se ky i fundit e ka shitur automjetin në dhjetor të vitit 2015⁸⁰ me çmimin 100.000 lekë.

29.11 Komisioni vëren se subjekti e ka blerë automjetin me targë *** në shumën 250.000 lekë, në datën 15.8.2005, dhe e ka shitur në shumën 1.000.000 lekë, pas rreth 4 viteve, në datën 4.4.2009.

29.12 Në procesverbalin e datës 7.6.2016 të ILDKPKI-së⁸¹, lidhur me konstatimin se automjeti i blerë në vlerën 250.000 lekë pas 4 viteve përdorimi është shitur 4-fish, subjekti ka deklaruar

⁷⁸ Në përgjigje të pyetësorit standard, me email-in datë 27.1.2021, subjekti ka deklaruar: “Me kontratën nr. *** regj. nr. *** kol., datë 15.8.2005, kam blerë automjetin me targë ***, ndryshuar me targën në ***. Në këtë rast, mënyra e pagesës ka qenë cash në dorë dhe është pasqyruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2005. Shpenzimet janë mbuluar nga paga ime dhe e bashkëshortes”.

⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.10.2023.

⁸⁰ Me kontratën nr. ***, datë 1.12.2015.

⁸¹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2023, e ILDKPKI-së.

se arsyeja e shitjes së këtij mjeti me këtë vlerë ka qenë mirëmbajtja e tij dhe rritja e vlerës së zhdoganimit.

29.13 Referuar deklarimeve periodike vjetore rezulton që subjekti nuk ka deklaruar shpenzime apo investime të kryera për rritjen e vlerës së automjetit. Gjithashtu, konstatohet se subjekti nuk ka paraqitur në ILDKPKI dokumentacion që provon investimin e tij në automjet.

29.14 Komisioni, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit⁸², vëren se, pavarësisht se palët janë të lira të përcaktojnë çmimet e shitjes dhe pavarësisht se nuk ka çmime reference për shitblerje automjetesh, vlera e shitjes së automjetit të mësipërm është jashtë logjikës sipas së cilës një mjet që përdoret, amortizohet. Për më tepër, ky arsyetim bazohet edhe në dokumentacionin e administruar, nga ku rezulton se me kalimin e viteve të përdorimit automjeti është shitur nga shtetasi A. Z. në një vlerë shumë më të vogël sesa vlera e blerjes.

29.15 Sa më lart, në kushtet kur: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratimet periodike vjetore shpenzime apo investime të kryera për rritjen e vlerës së automjetit; (ii) nuk ka paraqitur dokumentacionin që vërteton investimet e tij në automjet – Komisioni nuk e mori në konsideratë në analizën financiare si burim të ligjshëm shumën 1.000.000 lekë.

29.16 Gjithashtu, në kushtet kur Komisioni nuk mund të identifikojë çmimin real të shitjes së automjetit me targë *** në vitin 2009, pasqyroi në analizën financiare shumën 250.000 lekë, që përkon me çmimin e blerjes së automjetit në vitin 2005 nga subjekti.

29.17 Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasit S. S. e A. Z. dhe nga informacioni i administruar nuk rezultoi që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit⁸³.

29.18 Në vijim, referuar burimit të deklaruar, Komisioni kreu analizën financiare për automjetin me targë ***.

Tabela nr. 2 – Analiza financiare për blerjen e automjetit me targë ***

Përshkrimi	Shuma
Të ardhura nga shitja e automjetit me targë *** (datë 4.4.2009)	250,000
Blerje e automjetit me targë *** (datë 28.4.2009 dhe 7.5.2009)	-809,230
Diferenca	-559,230

29.19 Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) Subjekti ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues lidhur me shpenzimet apo investimet e kryera për rritjen e vlerës së automjetit me targë ***. Për pasojë, çmimi i pasqyruar në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 4.4.2009, në shumën 1.000.000 lekë, nuk është marrë në konsideratë në analizën e burimit të ligjshëm për blerjen e automjetit tjetër me targë ***; (ii) Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -559.230 lekë për blerjen e automjetit me targë ***, në vitin 2009.

⁸² Vendim nr. 34 (JR), datë 2.12.2019, i Kolegjit (E. P.), paragrafi 65.3.

⁸³ Shkresë nr. *** prot., datë 10.10.2023, e Prokurorisë së Rrethit Fier.

29.20 Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁸⁴, subjekti shpjegon se automjeti me targë *** është blerë nga ana tije me një çmim okazion, në vlerën 250.000 lekë, për shkak se pala shitëse donte ta shiste në një kohë të shpejtë dhe nuk donte të investonte mbi të për arsye se nuk ishte në gjendje të mirë në momentin e ardhjes në Shqipëri, pasi kishte probleme motorike, cilësia e kondicionerit ishte e dobët, si dhe kishte nevojë për riparime të tjera. Për vërtetimin e deklaramit subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.2.2024, të shtetasit S. S., që konfirmon deklaramin e tij. Më tej, shpjegon se automjetin e ka dërguar pranë një servisi në qytetin e Fierit, ku ka blerë një motor të ri dhe e ka instaluar, ka vendosur impiantin e kondicionerit, si dhe ka kryer rregullime të klimatizatorit. Për vërtetimin e deklaramit subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 25.5.2024, të administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., i cili konfirmon deklaramin e tij.

29.21 Lidhur me paraqitjen e dokumentacionit për investimet e kryera, subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur detyrim ligjor të deklarojë investimet e kryera dhe nuk ka mbajtur dokumentacion, pasi ka menduar se nuk do t’i nevojitet ndonjëherë.

29.22 Lidhur me vlerën prej 1.000.000 lekësh të shitur në vitin 2009, subjekti ka parashtruar se ky çmim është dakordësuar me palën blerëse dhe kontrata noteriale ka fuqi të plotë provuese sipas parashikimeve të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

29.23 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaramet periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaramet në seancë dëgjimore – arsyeton si vijon:

29.24 Trupi gjykues në këtë çështje vlerëson se nga të dhënat e dala përgjatë hetimit vlera e shitjes së këtij automjeti është jashtë logjikës financiare, sipas së cilës një mjet që përdoret, amortizohet, dhe për pasojë nuk mund të shitet më shtrenjtë. Deklaramet noteriale të shtetasit S. S. nr. ***, datë 24.2.2024, dhe nr. ***, datë 25.5.2024, merren me rezervë nga trupi gjykues, pasi janë paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit dhe nuk kanë efekt provues në këtë proces⁸⁵, si dhe nuk janë në harmoni me provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

29.25 Trupi gjykues, në rrethanat faktike të kësaj çështjeje, në kushtet që subjekti në funksion të barrës së provës nuk arriti të provojë shpenzimet e kryera të pretenduara si investime të kryera për rritjen e vlerës së automjetit, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit⁸⁶, vlerëson se për efekt të analizës financiare të konsiderojë shumën 250.000 lekë, që përkon me çmimin e blerjes së automjetit në vitin 2005, duke konkluduar se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -559.230 lekë për blerjen e automjetit me targë *** në vitin 2009.

29.26 Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, çmuarje e cila është

⁸⁴ Email datë 4.6.2024.

⁸⁵ Shihni vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 6/2018 (JR), nr. 11/2019 (JR), nr. 34/2019 (JR) dhe nr. 11/2023.

⁸⁶ Vendim nr. 23, datë 23.9.2019, i Kolegjit.

vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesin e rivlerësimit për këtë subjekt.

30. Depozitë bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank, në shumën 900.000 lekë

30.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Depozitë bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank. Vlera: 900.000 lekë. Zotërimi 50 - 50% me bashkëshorten*”. Nuk deklaroi burimin e krijimit, sipas parashikimit të shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit nr. *** prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁸⁷.

30.2 Në DIPP/2014, subjekti ka deklaruar: “*Kursimet familjare të krijuara nga të ardhurat e familjes, ku përfshihen të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes në vite, të cilat gjenden pranë Intesa Sanpaolo Bank, 500.000 kursimet e viteve të mëparshme, të cilat janë tërhequr nga Credins Bank...; 400.000 kursimet e realizuara për vitin 2014... Totali 900.000 lekë*”.

30.3 Nga shqyrtimi i informacionit të përcjellë nga Intesa Sanpaolo Bank⁸⁸ vërehet se në datën 26.12.2014, në llogarinë bankare të subjektit janë depozituar 900.000 lekë, me përshkrimin “*Petrit Vukaj kursime familjare*” dhe në të njëjtën datë është krijuar një depozitë në të njëjtën shumë.

30.4 Credins Bank⁸⁹ konfirmon se në datën 19.12.2013 bashkëshortja e subjektit ka depozituar një shumë prej 500.000 lekësh, e cila ka si burim me përshkrimin “*Depozitë e re A. V.*” dhe, më tej, pas maturimit të kësaj depozite dhe të interesave përkatës, në datën 22.12.2014, bashkëshortja e subjektit ka tërhequr shumën 515.300 lekë.

30.5 Nga analizimi i deklarimeve të subjektit në DIPP-të vjetore konstatohet se shuma prej 900.000 lekësh është krijuar gjatë periudhës 2011 – 2014, si në vijim:

Tabela nr. 3 – Origjina e krijimit të shumës 900.000 lekë

Viti	Deklaruar në DIPP	Shtesë	Pakësim	Gjendje progresive e gjendjes <i>cash</i>
2011	<i>Kursimet familjare të krijuara nga të ardhurat e familjes ku përfshihen të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes, të cilat gjenden të depozituara në shtëpi. Shuma 150.000 lekë.</i>	150,000		150,000
2012	<i>Kursimet familjare të krijuara nga të ardhurat e familjes ku përfshihen të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes, të cilat gjenden të depozituara në shtëpi. Shuma 150.000 lekë.</i>	150,000		300,000
2013	<i>Kursime familjare të krijuara nga të ardhurat e familjes ku përfshihen të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes në vite të cilat gjenden pranë Credins Bank, 50.000 lekë për vitin 2011; 150.000 lekë për vitin 2012; 200.000 lekë për vitin 2013. Totali 500.000 lekë</i> ”.	200,000		500,000
	<i>Depozituar në Credins Bank, datë 19.12.2013</i>		-500,000	0

⁸⁷ Kontratë depozite datë 26.12.2014 me Intesa Sanpaolo Bank; gjendje llogarie në Intesa Sanpaolo Bank; vërtetim nr. *** prot., datë 20.1.2017, i Raiffeisen Bank.

⁸⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 23.2.2021.

⁸⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2021.

2014	<i>Kursimet familjare të krijuara nga të ardhurat e familjes ku përfshihen të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes në vite, të cilat gjenden pranë Intesa Sanpaolo Bank, 500.000 kursimet e viteve të mëparshme, të cilat janë tërhequr nga Credins Bank; 400.000 kursimet e realizuara për vitin 2014... Totali 900.000 lekë.</i>	400,000		400,000
	<i>Tërhequr nga Credins Bank, datë 22.12.2014</i>	500,000		900,000
	<i>Depozituar në Intesa Sanpaolo Bank, datë 26.12.2014</i>		-900,000	0

30.6 Pra, lidhur me origjinën e krijimit të depozitës prej 900.000 lekësh, konstatohet se kursimet *cash* gjatë viteve 2011 – 2013, në shumën 500.000 lekë, janë depozituar në vitin 2013 në Credins Bank. Në vitin 2014, kjo shumë prej 500.000 lekësh është tërhequr nga Credins Bank dhe së bashku me kursimet prej 400.000 lekësh të vitit 2015 janë depozituar në Intesa Sanpaolo Bank, duke krijuar kështu depozitën bankare prej 900.000 lekësh të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

30.7 Sa më lart, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat, shpenzimet dhe detyrimet e subjektit dhe personave të lidhur për vitet 2011 – 2014, për të verifikuar burimet e ligjshme për krijimin e likuiditeteve *cash* ndër vite, analizë e cila paraqitet në tabelën vijuese.

Tabela nr. 4 – Analiza financiare për vitet 2011 – 2014

Përshkrim	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014
Shtim likuiditete <i>cash</i>	150,000	150,000	200,000	400,000
Pakësim likuiditete <i>cash</i>	-	-	-500,000	-400,000
Shtim/pakësim likuiditete në bankë	102,955	- 19,211	427,820	389,753
Total ndryshimi i likuiditeteve	252,955	130,789	127,820	389,753
Të ardhura nga pagat subjekti	1,021,163	1,027,878	982,714	1,272,590
Të ardhura nga pagat bashkëshortja	434,784	458,721	464,582	503,407
Të ardhura nga interesat bankarë				15,300
Total të ardhura	1,455,947	1,486,599	1,447,296	1,791,297
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	546,480	564,096	564,096	879,992
Shpenzime për arredim	22,000	24,000	0	0
Shpenzime për rivlerësimin	110,593	0	0	0
Shpenzime për shkollimin e fëmijëve	97,000	54,000	60,000	67,500
Shpenzime për qëndrimin e vajzës	45,000	45,000	45,000	45,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	29,043	302,832	26,135	119,382
Total shpenzime	850,116	989,928	695,231	1,111,874

30.8 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e depozitës në shumën 900.000 lekë pranë Intesa Sanpaolo Bank.

31. Konstatime të tjera – kursime likuiditete *cash* prej 200.000 lekësh, të deklaruar në vitin 2015

31.1 Në DIPP/2015, subjekti ka deklaruar: “*Kursime familjare të krijuara nga të ardhurat e familjes, ku përfshihen të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes. Shuma 200.000 lekë cash*”.

31.2 Më tej, në DIPP/2016, nuk ka deklaruar ndryshime (shtesa/pakësime) të likuiditeteve *cash*. Gjithashtu, në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar pasuri në likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar.

31.3 Me anë të pyetësorit nr. 1⁹⁰, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë nëse shuma prej 200.000 lekësh është përdorur prej tij dhe, nëse po, në cilin vit kalendarik, si dhe të japë shpjegime lidhur me mosdeklarimin e pakësimit të kësaj shume.

31.4 Në përgjigje⁹¹, subjekti deklaroi se: “*Kjo vlerë është përdorur përgjatë vitit 2016 ...për shkak të nevojave financiare të atij viti. Kjo është arsyeja përse nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting*, pasi në momentin e deklarimit, unë nuk e kam pasur gjendje në banesë. Lidhur me mosdeklarimin e pakësimit të vlerës prej 200.000 lekësh në deklaratën vjetore periodike të vitit 2016, deklaroj se kjo është thjesht një harresë ...dhe lapsus që lidhet me mënyrën e deklarimit, por nuk ka pasur asnjë qëllim konkret për mosdeklarimin e saj*”.

31.5 Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2015, për të verifikuar burimet e ligjshme për krijimin e kursimeve në shumën 200.000 lekë, ku konstatohet se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kursimeve *cash* në vitin 2015, në shumën 200.000 lekë.

Tabela nr. 5 – Analiza financiare për vitin 2015

Përshkrim	Shuma
Shtim likuiditete <i>cash</i>	200,000
Pakësim likuiditete <i>cash</i>	-
Shtim/pakësim likuiditete në bankë	34,465
Total ndryshimi i likuiditeteve	234,465
Të ardhura nga pagat subjekti	1,211,995
Të ardhura nga pagat bashkëshortja	508,634
Të ardhura nga interesat bankarë	14,614
Total të ardhura	1,735,243
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	897,104
Shpenzime për shkollimin e fëmijëve	77,500
Shpenzime për qëndrimin e vajzës në Tiranë gjatë universitetit	45,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	323,822
Total shpenzime	1,343,426
Balanca e fondeve (të ardhura – ndryshim likuiditete – shpenzime)	157,353

31.6 Sa më lart, në kushtet që: (i) kursimet e krijuara në vitin 2015 justifikohen me burime të ligjshme; (ii) në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar pasuri në likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar, pra nuk dispononte *cash* në datën 25.1.2017; (iii) subjekti nuk ka përfutur të ardhura nga paga gjatë vitit 2016 (për shkak të pezullimit në muajin dhjetor 2015), çka e bën të arsyeshëm shpenzimin e kursimeve të vitit të mëparshëm – Komisioni e pasqyroj në analizën financiare pakësimin e shumës 200.000 lekë, edhe pse nuk është deklaruar në DIPP-në përkatëse.

31.7 Më tej, Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2016, vit gjatë të cilit – sipas deklarimit të subjektit në pyetësorin nr. 1 – është shpenzuar shuma 200.000 lekë.

⁹⁰ Email datë 26.2.2024.

⁹¹ Email datë 11.3.2024.

Tabela nr. 6 – Analiza financiare për vitin 2016

Përshkrimi	Shuma
Pakësim likuiditete <i>cash</i>	-200,000
Shtim/pakësim likuiditete në bankë	50,399
Total ndryshimi i likuiditeteve	-149,601
Të ardhura nga pagat subjekti	0
Të ardhura nga pagat bashkëshortja	503,437
Të ardhura nga pagat e vajzës	253,702
Të ardhura nga interesat bankarë	13,641
Total të ardhura	770,780
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	940,368
Shpenzime për shkollimin e fëmijëve	50,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	64,930
Total shpenzime	1,055,298
Balanca e fondeve (të ardhura – ndryshim likuiditete – shpenzime)	-134,916

31.8 Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: duket se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -134.916 lekë në vitin 2016 për kryerjen e shpenzimeve.

31.9 Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁹², subjekti shpjegon se në DIPP/2015, të cilën e ka plotësuar në mars të vitit 2016, kur ka deklaruar gjendjen *cash* në banesë, ka shënuar vlerën 200.000 lekë, kur ndërkohë kjo vlerë duhej të ishte 340.000 lekë dhe jo 200.000 lekë. Plotësimi i deklaratës në rastin konkret, vijon subjekti, është një pasaktësi dhe ka ndodhur për shkak se disponimi i tij në banesë kur ka plotësuar deklaratën në muajin mars 2016 duhet të ketë qenë 200.000 lekë, ndaj i është referuar në pakujdesi asaj vlere.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

31.10 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton si vijon:

31.11 Lidhur me pretendimin e subjektit se është një pakujdesi e tij në deklarimin e gjendjes *cash* për vitin 2015, trupi gjykues çmon se ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë, për sa kohë saktësia e plotësia e deklarimit për këtë likuiditet matet vetëm përmes deklaratimeve të sakta⁹³ dhe nuk mund të prezumojë për të kundërtën, duke rikonstatuar se mungesa e

⁹² Email datë 4.6.2024.

⁹³ Shihni vendimet nr. 7/2019 (JR) dhe nr. 11/2019 (JR) të Kolegjtit.

burimeve të ligjshme në shumën 134.916 lekë mbetet e pandryshuar, e cila është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesin e rivlerësimit për këtë subjekt.

PASURITË E BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

32. Tokë bujqësore me sip. 3.534 m², në pronësi të bashkëshortes

32.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Tokë bujqësore me sip. 3.534 m², pronë e bashkëshortes, marrë nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, nr. regjistri i aktit *** i marrjes në pronësi. Certifikatë për vërtetim pronësie nr. **, datë 12.4.2007. Zotëron 100% bashkëshortja*”. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues.

32.2 Subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në DIPP/2006, ku ka deklaruar: “*Tokë bujqësore e përfituar me aktin nr. **, sip. 3.534 m², pronë e bashkëshortes A. V.. Regjistruar pas. **, vol. **, f. ***”.

32.3 Në procesverbalin e datës 7.6.2016 të ILDKPKI-së⁹⁴, subjekti ka deklaruar se toka bujqësore është përfituar me ligjin nr. 7501, ku përfituese është bashkëshortja dhe vajza e tij, pasi ai ka qenë në marrëdhënie pune dhe nuk përfitonte nga ky ligj. Gjithashtu ka deklaruar se nuk e ka deklaruar në DIPP/2003 për shkak harrese, por e ka deklaruar në vitin 2006. Për pasojë, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP/2003 pasurinë tokë bujqësore sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.

32.4 Referuar dokumentacionit të administruar nga ZQRPP-ja⁹⁵, rezulton se shtetasja A. R. V. është pajisur me AMTP-në nr. **, pa datë, fshati ** Fier, për pasurinë tokë arë nr. **, me sip. 3.532 m². Gjithashtu konstatohet kartela e pasurisë së paluajtshme në të cilën pasqyrohet se në pronësi të shtetasës A. R. V. figuron pasuria e llojit arë, me nr. pasurie **, z. k. **, vol. **, f. **, me sip. 3.532 m².

32.5 Këshillit i Qarkut Fier⁹⁶ ka përcjellë kopje të formularit 6, ku pasqyrohet emri i shtetasës A. V., si dhe dhënia e parcelës nr. **.

32.6 DPGJC-ja⁹⁷ informon se në datën 28.5.1991 shtetasi Petrit Vukaj rezulton të ketë ndryshuar vendbanimin duke u vendosur në lagjen “***”, Fier, në përbërje familjare me dy anëtarë Petrit Vukaj e A. V., si dhe konfirmon gjendjen familjare të datës 1.8.1991, e cila përbëhet nga Petrit Vukaj dhe A. V.

32.7 Sa më sipër, konstatohet se bashkëshortja e subjektit është pajisur me tokë bujqësore sipas parashikimeve të ligjit nr. 7501/1991 dhe akteve nënligjore në zbatim⁹⁸.

⁹⁴ Shkresë nr. ** prot., datë 28.9.2023, e ILDKPKI-së.

⁹⁵ Shkresë nr. ** prot., datë 11.9.2017 (dosja e ILDKPKI-së).

⁹⁶ Shkresë nr. ** prot., datë 6.10.2023.

⁹⁷ Shkresat nr. ** prot., datë 24.10.2023 dhe nr. ** prot., datë 5.10.2023.

⁹⁸ Sipas pikës 2 të VKM-së nr. 452, datë 17.10.1992, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, të ndryshuar, toka e ndërmarrjeve bujqësore ose njësisë të tyre që do të shpërndahen e që kanë qenë pronë e ish-kooperativave bujqësore i jepej në pronësi familjeve të ndërmarrjeve bujqësore. Në ndarjen e tokës do të zbatohen kriteret e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes, së tokës bujqësore”, me ndryshimet. Referuar VKM-së nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, toka bujqësore është ndarë për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes familjare në datën 1.8.1991.

32.8 Në përfundim, Komisioni vlerëson se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin justifikues.

KONSTATIME TË TJERA

33. Hua nga shtetasi O. M.

33.1 Në pyetësonin standard⁹⁹, subjekti ka deklaruar: *“Kam marrë hua nga shtetasi O. M. në vitin 2007, nëpërmjet Alpha Bank, shumën 10.000 euro. Po kështu, edhe për vitin 2008 nëpërmjet Alpha Bank shtetasi O. M. më ka huazuar, përsëri për një afat të shkurtër, edhe një shumë tjetër prej 10.000 euro. Në të dyja rastet shumat... janë kthyer tek shtetasi në fjalë pas rreth një muaji nëpërmjet bankës... Këto shuma janë marrë hua si garanci në bankë për pajisjen me vizë italiane në Konsullatën Italiane në Vlorë për mua dhe familjen time për të shkuar tek vëllai në Itali, pasi vetë unë nuk kisha mundësi ekonomike të plotësoja këtë garanci”*. Për vërtetimin e deklarimit të tij subjekti ka paraqitur: (i) kontratë huaje nr. ***, datë 11.4.2007; (ii) deklaratë personale të datës 8.1.2021 të shtetasit O. M.; (iii) lëvizjet e llogarisë bankare të subjektit pranë Alpha Bank për periudhën 1.1.2007 – 20.1.2017.

33.2 Lidhur me deklarimin e subjektit në deklaratat periodike vjetore, Komisioni konstaton se në DIPP-të 2007 dhe 2008 ai nuk ka kryer deklarime lidhur me këto transaksione, ndërkohë që në DIPP/2010 ka deklaruar: *“Marrë hua për efekt vize jashtë shtetit për familjen nga biznesmen O. M. pranë Alpha Bank datë 1.7.2010, shumë e cila është kthyer. Nr. i konfirmës ***, datë 1.7.2010”*.

33.3 Nga analizimi i llogarisë bankare të subjektit pranë Alpha Bank (sot OTP)¹⁰⁰ u konstatuan këto transaksione: (i) në datën 28.3.2007, në llogarinë e subjektit janë depozituar *cash* 10.000 euro, me përshkrimin “Derdhje në llogari” dhe në datën 26.4.2007 janë tërhequr *cash* 9.990 euro, me përshkrimin “Sa tërhequr nga Petrit Vukaj me pas. ***”; (ii) në datën 11.7.2008 janë transferuar 10.000 euro në llogarinë e subjektit, me përshkrimin “Sa kaluar nga O. M. tek Petrit Vukaj (dhënie borxh)” dhe në datën 20.8.2008 kjo shumë i është kthyer shtetasit O. M. me anë të një transfertë bankare me përshkrimin “Sa kaluar nga Petrit Vukaj në favor të O. M. (kthim borxhi)”; (iii) në datën 1.7.2010, në llogarinë e subjektit janë depozituar *cash* 10.000 euro, me përshkrimin “Sa arkëtuar në llogari për efekt vize” dhe në të njëjtën datë janë tërhequr *cash* 10.00 euro, me përshkrimin “Tërheqje nga Petrit Vukaj”.

33.4 Komisioni vëren se transaksionet e kryera për vitet 2007 dhe 2008 janë konfirmuar edhe nga shtetasi O. M., konkretisht me anë të: (i) kontratës së huas nr. ***, datë 11.4.2007¹⁰¹, në të cilën pasqyrohet se ky shtetas në datën 28.3.2007 i ka dhënë hua subjektit shumën 10.000 euro me kushtin që t’ia kthejë në datën 31.12.2007; (ii) deklaratës personale nr. *** rep., datë 8.1.2021, në të cilën shtetasi O. M. ka deklaruar se me shtetasin Petrit Vukaj ka njohje shoqërore dhe se i ka dhënë hua për afat të shkurtër shumën 10.000 euro, për shkak se ky i fundit i ka thënë se kërkohej si garanci për të marrë vizë italiane në Konsullatën e Vlorës. Të gjitha veprimet për transferimin e kësaj shume e, më pas kthimin e saj, janë bërë në vitin 2007 nëpërmjet Alpha Bank dhe se në vitin 2008 i ka huazuar përsëri për një afat të shkurtër shumën 10.000 euro, nëpërmjet Alpha Bank, për t’u pajisur me vizë italiane në Konsullatën e Vlorës, shumë e cila është kthyer pas rreth një muaji po nëpërmjet kësaj banke, vijohet në këtë

⁹⁹ Email datë 27.1.2021.

¹⁰⁰ (i) Lëvizjet e llogarive të paraqitura nga subjekti në pyetësonin standard; (ii) shkresë nr. ***, datë 6.10.2023.

¹⁰¹ Paraqitur nga subjekti, si dhe administruar edhe nga notere E. B. S. me shkresën e datës 19.2.2024.

deklaratë; (iii) vërtetimit të shoqërisë “****” sh.p.k., datë 7.3.2024, ku shtetasi O. M., në cilësinë e bashkëpronarit të kësaj shoqërie, ka deklaruar se i ka kaluar nga llogaria në Alpha Bank shtetasit Petrit Vukaj shumën 10.000 euro, datë 29.3.2007 dhe 10.000 euro, datë 14.7.2008, i cili do t’i përdorte si garanci për pajisje me viza, shuma të cilat janë kthyer në një kohë të shkurtër, në datat 25.4.2007 dhe 18.8.2008, po nëpërmjet kësaj banke. Burimi është aktiviteti tregtar, vijohet në këtë deklaratë.

33.5 Në kushtet kur shtetasi O. M. ka konfirmuar marrëdhënien e huas në vitet 2007 dhe 2008 dhe nuk është shprehur për marrëdhënien e huas në vitin 2010, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁰² i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacionin ligjor justifikues për të konfirmuar marrëdhënien e huas në vitin 2010, të paraqesë kopje të pasaportës ku pasqyrohen vizat e marra nga Konsullata Italiane në Vlorë në vitet 2007, 2008 dhe 2010, si dhe dokumentacionin ligjor të të ardhurave të shtetasit O. M., që kanë shërbyer si burim për huat e dhëna.

33.6 Në përgjigje¹⁰³, subjekti deklaroi se shuma e të hollave është marrë për efekt të pajisjes me vizë për jashtë shtetit dhe i është kthyer përsëri huadhënësit brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore¹⁰⁴.

33.7 Lidhur me dokumentacionin ku pasqyrohen vizat e marra, subjekti deklaroi se disponon fotokopje të vizave të marra vetëm për vitin 2010, të tijën dhe të bashkëshortes, pasi dokumenti pasaportë është asgjësuar për shkak të skadencës në vitin 2020 dhe të faktit se sot disponon një pasaportë të re për veten dhe familjarët e tij. Gjithashtu, konstatohet se subjekti i është drejtuar Konsullatës Italiane në Vlorë për t’i vënë në dispozicion informacionin lidhur me pajisjen e tij dhe të familjarëve të tij me viza në vitet 2007, 2008 dhe 2010. Në përgjigje¹⁰⁵, Konsullata e Përgjithshme e Italisë në Vlorë konfirmon se për shtetasit: Petrit Vukaj janë lëshuar 4 viza; A. V. janë lëshuar 3 viza; R. V. janë lëshuar 4 viza; dhe L. V. janë lëshuar 3 viza.

33.8 Komisioni vëren se në fotokopjen e pasaportës pasqyrohet se subjekti dhe bashkëshortja e tij janë pajisur me vizë të vendeve Shengen për periudhën 23.7.2010 – 23.7.2012.

33.9 Për sa i përket dokumentacionit provues të të ardhurave të shtetasit O. M., subjekti shpjegoi se ky shtetas është ortak me 50% të kuotave, i shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT *** dhe paraqiti: (i) ekstraktin e regjistrimit tregtar të kësaj shoqërie; (ii) shkresën e datës 7.3.2024 të DRT Fier, ku konfirmohen të dhënat mbi fitimin e shoqërisë për periudhën 2006 – 2010, (iii) fotokopje të pasqyrave financiare për vitet 2007 dhe 2008.

33.10 Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur konstatohet se shoqëria “****” sh.p.k. është themeluar në datën 8.10.2001 dhe shtetasi O. M. figuron ortak me 50% të kuotave që nga kjo datë e në vijim.

33.11 Lidhur me burimin e ligjshëm, Komisioni vëren se bilanci tregon pozicionin financiar (aktivet, pasivet dhe kapitalin) të një njësie ekonomike raportuese në një datë të caktuar, në rastin konkret në datat 31.12.2006, 31.12.2007 dhe 31.12.2008, çka e bën të pamundur

¹⁰² Email datë 26.2.2024.

¹⁰³ Email datë 11.3.2024.

¹⁰⁴ Gjithashtu, subjekti deklaroi që ka paraqitur faturat përkatëse bankare ku vërtetohet depozitimi i shumës 10.000 euro, si dhe tërheqja po atë ditë e kësaj shume, duke ia kthyer huadhënësit, të cilat në fakt nuk janë bashkëlidhur, por në çdo rast, lëvizjet e llogarive bankare të subjektit janë administruar nga Komisioni.

¹⁰⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 22.3.2024 (protokolluar në Komision me nr. ***, datë 19.4.2024).

identifikimin në këtë pasqyrë të transaksioneve në fjalë, për sa kohë që huat janë marrë dhe kthyer brenda të njëjtit vit ushtrimor.

33.12 Megjithatë, Komisioni vëren se kjo shoqëri ka pasur qarkullim (shitje) në vlera të tilla - konkretisht 243 milionë lekë në vitin 2007 dhe 190 milionë lekë në vitin 2008 – të cilat teorikisht e bëjnë të mundur dhënien hua në shumën 10.000 euro.

33.13 Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasin O. M. dhe nga informacioni i administruar nuk rezulton që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit¹⁰⁶.

33.14 Sa më lart, Komisioni nuk konstaton problematika lidhur me huat e marra në vitet 2007 dhe 2008, pasi: (i) këto transaksione konfirmohen me dokumentacion të kohës kur kanë ndodhur konkretisht për vitin 2007 me anë të deklaratës noteriale datë 11.4.2007 dhe për vitin 2008 me anë të transfertave bankare midis llogarisë së subjektit dhe llogarisë së huadhënësit, me përshkrim të qartë të arsyes së kryerjes së veprimit (si dhe me deklaratat noteriale të mëvonshme të lëshuara nga ky shtetas); (ii) shumat e marra hua nuk kanë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie; (iii) aktiviteti tregtar i ushtruar nga shoqëria – ku huadhënësi zotëron 50% të kuotave – ka pasur qarkullim në shifra të tilla që e bëjnë të mundur dhënien hua të shumës 10.000 euro.

33.15 Ndërsa lidhur me huan në vitin 2010, Komisioni vëren se kjo hua është deklaruar në DIPP/2010 dhe se subjekti ka paraqitur kopje të pasaportës ku identifikohet marrja e vizës Shengen në datën 23.7.2010, por nuk është konfirmuar nga ana e shtetasit O. M.¹⁰⁷, edhe pse subjekti i është kërkuar me anë të pyetësorit nr. 1.

33.16 Në këto kushte, Komisioni kreu analizën financiare pa e marrë në konsideratë huan e deklaruar nga subjekti dhe, për rrjedhojë, analiza e kryer për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për periudhën 1.1.2010¹⁰⁸ – 1.7.2010, me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme financiare për depozitimin e shumës 10.000 euro.

33.17 Në këtë analizë nuk u konsideruan shpenzimet e kryera për investimin në banesë gjatë këtij viti, në kushtet që nuk është e mundur që të identifikohet data e kryerjes së këtyre shpenzimeve dhe që tërheqja e shumës 10.000 euro është kryer në të njëjtën datë.

Tabela nr. 7 – Analiza financiare datë 1.7.2010 (depozitimi i shumës 10.000 euro)

Përshkrimi	Shuma
Depozitimi i shumës 10.000 euro në Alpha Bank, më 1.7.2010 ¹⁰⁹	1,365,400
Shtim/pakësim likuiditete bankë ¹¹⁰	49,261
Total pasuri	1,414,661
Hua nga shtetasi O. M.	0
Total detyrime	0
Të ardhura nga pagat subjekti ¹¹¹	478,246

¹⁰⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 10.10.2023, e Prokurorisë së Rrethit Fier.

¹⁰⁷ Në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

¹⁰⁸ Subjekti nuk ka deklaruar kursime në formën e likuiditeteve cash për vitet e mëparshme.

¹⁰⁹ Vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit në datën 1.7.2010.

¹¹⁰ Diferenca midis gjendjes së llogarive bankare të subjektit dhe bashkëshortes në datën 1.7.2010 me atë të datës 31.12.2009.

¹¹¹ Pagat e kredituara në llogarinë bankare të subjektit pranë Raiffeisen Bank gjatë periudhës 1.1.2010 – 1.7.2010.

Të ardhura nga pagat bashkëshortja ¹¹²	199,805
Total të ardhura	678,051
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT ¹¹³	273,240
Shpenzime për legalizimin ¹¹⁴	149,493
Shpenzime për blerjen e bonove të privatizimit ¹¹⁵	20,000
Shpenzime për shkollimin e fëmijëve ¹¹⁶	27,778
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS ¹¹⁷	34,703
Total shpenzime	505,213
Balanca e fondeve (të ardhura + detyrime – pasuri – shpenzime)	-1,241,823

33.18 Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me konstatimin se: dukej se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -1.241.823 lekë për depozitimin e shumës 10.000 euro në datën 1.7.2010, pasi mungon dokumentacioni ligjor për konfirmimin e marrëdhënies së huas nga shtetasi O. M. në vitin 2010, si dhe subjekti nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor për burimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer si burim për huan e deklaruar.

33.19 Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹¹⁸, subjekti shpjegon se shtetasi O. M., sikurse në vitet 2007 – 2008, i ka dhënë hua në datën 1.7.2010 shumën 10.000 euro, me qëllim garanci bankare për efekt të marrjes së vizës, e cila është kthyer në të njëjtën ditë po këtij shtetasi, fakt që konfirmohet jo vetëm nga DPV/2010, por edhe nga dokumentet e tjera provuese të cituara nga ana e tij dhe të administruara nga Komisioni. Më pas shpjegon se marrëdhënia e vitit 2010 është harruar të përmendet në deklaratën personale nr. *** rep., datë 8.1.2021, të këtij shtetasi, marrëdhënie që është deklaruar në deklaratën noteriale të datës 21.5.2024, e cila është në harmoni me dokumentet e administruara nga Komisioni. Për të provuar deklarinimin e tij subjekti ka dorëzuar deklaratën noteriale nr. ***, datë 21.5.2024, të shtetasit O. M., i cili ka deklaruar dhënien hua të shumës 10.000 euro subjekti në datën 1.7.2010, me qëllim që ky i fundit të pajisej me vizë nga Konsullata Italiane në Vlorë dhe këtë shumë subjekti ia ka kthyer brenda ditës.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

33.20 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarinimet në seancë dëgjimore – arsyeton si vijon:

¹¹² Pagat e kredituara në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit pranë Credins Bank gjatë periudhës 1.1.2010 – 1.7.2010.

¹¹³ Përlllogarit për 6 muaj.

¹¹⁴ Subjekti ka paguar në favor të ALUIZNI-t shumën 25.393 lekë në datën 3.3.2010, shumën 120.000 lekë në datën 28.4.2010 dhe në favor të Degës së Thesarit shumën 4.000 lekë në datën 21.1.2010.

¹¹⁵ Sipas deklarinimit të subjektit në pyetësorin nr. 1.

¹¹⁶ Shpenzime shkollimi vajza, periudha janar – qershor 2010, shkolla “****”.

¹¹⁷ Shpenzime për udhëtime gjatë periudhës 1.1.2010 – 1.7.2010.

¹¹⁸ Email datë 4.6.2024.

33.20.1 Referuar dokumentacionit të administruar nga hetimi konstatohet se: (i) sipas shkresës datë 7.3.2024 të DRT Fier¹¹⁹, konfirmohet fakti se për vitin 2010 fitimi neto i shoqërisë “****” sh.p.k. ka qenë në shumën 6.059.843 lekë; (ii) referuar pasqyrave financiare të vitit 2011, ku pasqyrohet edhe informacioni për vitin paraardhës 2010¹²⁰, konstatohet se për vitin 2010 qarkullimi (shitjet) ka qenë në shumën 92.127.259 lekë (pa përfshirë TVSH) – fakte këto që krijojnë bindjen se huadhënësi, shtetasi O. M., ortak me 50% të kuotave në këtë shoqëri, ka pasur mundësi për dhënien hua në shumën 10.000 euro subjektit të rivlerësimit në vitin 2010 për një periudhë kohore njëditore.

33.20.2 Me deklaratën noteriale datë 21.5.2024, konfirmohet kjo marrëdhënie me këtë shtetas, duke përbushur kështu kriteret ligjore që kërkon neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të pasurive”*.

33.20.3 Për sa më sipër vlerësuar, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se deklarimi i huadhënësit për këtë marrëdhënie gjendet në harmoni me deklaratimet e subjektit në DIPP/2010, në të cilën ai e ka deklaruar këtë hua. Gjithashtu, nga hetimi u provua qëllimi i marrjes së kësaj huaje¹²¹, pasi sipas dokumentit kopje të pasaportës identifikohet marrja e vizës Shengen në datën 23.7.2010¹²², sikurse rezultoi se veprimet bankare të datës 1.7.2010 në llogarinë e subjektit, ku është depozituar shuma 10.000 cash euro, janë të shoqëruara edhe me përshkrimin “sa arkëtuar në llogari për efekt vize” dhe në të njëjtën datë janë tërhequr cash 10.000 euro, me përshkrimin “Tërheqje nga Petrit Vukaj”.

33.20.4 Trupi gjykues arrin në konkluzion se personi tjetër i lidhur, z. O. M., ka disponuar burime financiare të ligjshme për shumën e dhënë hua subjektit të rivlerësimit dhe ka konfirmuar këtë marrëdhënie, duke përbushur kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, nga analiza financiare për depozitim të shumës 10.000 euro, në datën 1.7.2010, subjekti rezulton me mjaftueshmëri financiare.

34. Regjistrimi si person fizik i shtetasit Petrit Vukaj në QKB

34.1 QKB-ja¹²³ informon se shtetasi Petrit Vukaj figuron i regjistruar si person fizik me vendimin nr. ***, datë 17.1.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për të cilin nuk mund të identifikohet pajisja me NUIS, si dhe nuk mund të garantojë nëse kemi të bëjmë me të njëjtin shtetas për të cilin ka kërkuar informacion nga Komisioni (bashkëlidhur ka paraqitur dokumentacionin përkatës).

34.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë konstatohet kërkesa, pa datë, e shtetasit Petrit Vukaj drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, i cili ka deklaruar se është me banim në qytetin e Lezhës dhe kërkon të ushtrojë aktivitet privat pa ortakëri dhe kërkon të regjistrohet si person fizik privat me objekt “Matje me zhytje (draft suvejor) të anijeve cisternë”. Me vendimin nr. ***, datë 17.1.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur regjistrimin e kërkuar.

¹¹⁹ Paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1.

¹²⁰ Shkarkuar nga dokumentacioni i ndodhur në faqen zyrtare të QKB-së.

¹²¹ Shumat e marra hua nuk kanë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie.

¹²² Referojuni gjithashtu edhe shkresës kthim përgjigje e datës 22.3.2024 të Konsullatës së Italisë në Vlorë, të cilët konfirmojnë faktin se për familjen Vukaj janë lëshuar vizat përkatëse për në vendet Shengen për periudhën 23.7.2010 – 23.7.2010.

¹²³ Shkresë nr. *** prot., datë 11.2.2021.

34.3 Nga dokumentacioni i mësipërm nuk mund të bëhet identifikimi nëse personi i regjistruar përkon me gjeneralitetet e subjektit.

34.4 Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1¹²⁴ i kërkoi subjektit të deklaronte nëse ka ushtruar aktivitet privat. Në përgjigje¹²⁵, subjekti deklaroi se nuk ka ushtruar ndonjë aktivitet privat në jetën e tij apo të ketë qenë ortak në një kompani. Gjithashtu, deklaroi se nuk ka qenë ndonjëherë me banim në qytetin e Lezhës dhe me siguri bëhet fjalë për një shtetas tjetër që ka të njëjtin emër me të, por nuk përkon me të dhënat e identitetit të tij.

34.5 Nga verifikimi i regjistrimit të gjendjes civile figurojnë dy shtetas me emrin Petrit Vukaj, me Gjendje Civile Lezhë, gjeneralitetet e të cilëve nuk përputhen me ato të subjektit.

34.6 Sa më sipër, Komisioni vlerëson se nuk ka të dhëna që subjekti ka ushtruar aktivitet privat gjatë kohës që ushtronte funksionin e prokurorit.

35. Banesë në përdorim në Tiranë

35.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile: “*Njësia Bashkiake Nr. ***, rruga “****”, ndërtesë nr. ***, hyrja ***, Tiranë*”. Kjo adresë është deklaruar edhe në DIPP/2016.

35.2 Në përgjigje të pyetësorit standard¹²⁶, subjekti ka deklaruar: “*Duke pasur parasysh nevojat që dolën me punësimin e bashkëshortes sime në Tiranë, si mësuese në shkollën “****”, në datën 14.11.2016 kam marrë në përdorim pa kundërshtim një banesë në rrugën “****” ose “****”, shtëpi dykatëshe tek ****”, Tiranë, ku unë kam pasur në përdorim katin 0 (kati përdhe), me mobilimin modest ekzistues të bërë nga xhaxhai im. Kjo banesë është në pronësi të xhaxhait tim F. V., i cili ka qenë në proces legalizimi. Për këtë, unë, vajza ime dhe xhaxhai im kemi lidhur kontratën e huapërdorjes nr. *** rep., datë 14.11.2016, tek noter B. V.. Afati i kësaj kontrate ka qenë 1-vjeçar dhe është ripërtërirë me mirëkuptim”. Gjithashtu ka deklaruar se: “*Shtëpinë e xhaxhait e ka përdorur kryesisht vetëm gruaja dhe djali dhe në pak muaj vajza ime, pasi ajo është martuar në bazë të aktit të martesës nr. ***, datë 27.12.2017*”. Për vërtetimin e deklaramit ka paraqitur dokumentacionin provues¹²⁷.*

35.3 Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, të administruar edhe nga noteri B. V.¹²⁸, rezulton se ndërmjet shtetasit F. V., subjektit dhe vajzës së subjektit/R. V. është lidhur kontrata e huapërdorjes nr. ***, datë 14.11.2016, në të cilën parashikohet se shtetasi F. V., sipas lejes së legalizimit nr. *** prot., datë 15.11.2006, Tiranë, është pronar i një shtëpie banimi 2-katëshe, të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, dhe nga kjo pronë i lëshon në përdorim shtetasve Petrit Vukaj dhe R. V. dy dhoma e një kuzhinë dhe ambiente të tjera ndihmëse, në katin e parë, me sip. 50 m², për ta përdorur për nevojat e tyre për një afat 1-vjeçar, duke filluar nga data 14.11.2016 deri më 13.11.2017.

35.4 ZGJC-ja e Njesisë Administrative Nr. ***¹²⁹ ka përcjellë pranë Komisionit dokumentacionin e paraqitur për ndryshimin e adresës së banimit¹³⁰ dhe rezulton se subjekti me kërkesën e datës 14.11.2016 ka kërkuar nga ZGJC-ja e Njesisë Administrative Nr. ***, Tiranë,

¹²⁴ Email datë 26.2.20224.

¹²⁵ Email datë 11.3.2024.

¹²⁶ Email datë 27.1.2021.

¹²⁷ Kontratë huapërdorje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.11.2016.

¹²⁸ Shkresa e datës 21.9.2023.

¹²⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 3.11.2023.

¹³⁰ Sipas informacionit të përcjellë nga DPGJC-ja deri në këtë moment figuronin të regjistruar në lagjen “****”, Fier.

të bëjë pasaportizimin pasi jeton me qira në këtë zonë, duke i bashkëlidhur kërkesës edhe kontratën e huapërdorjes nr. ***, datë 14.11.2016, të lidhur prej tij dhe bashkëshortja e tij me shtetasin F. V.¹³¹.

35.5 Më tej, në datën 25.8.2020, familja Vukaj¹³² ka ndryshuar vendbanimin duke u vendosur në Bashkinë Fier, rajoni nr. ***, me adresë vendbanimi lagjja “****”, rruga “****”, ndërtesa nr. ***, hyrja ***¹³³.

35.6 Komisioni vëren se sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 15.11.2016, të Njësisë Administrative Nr. ***, rezulton se adresa e banimit e pasqyruar në kontratën e huapërdorjes nr. ***, datë 14.11.2016, përkon me adresën “Rruga “****”, kodi i njësisë ***, qendra e votimit ***, kodi i banesës ***, sip. 50 m²”.

35.7 Nga informacioni i administruar nga UKT-ja¹³⁴ dhe FSHU-ja¹³⁵ nuk rezulton që subjekti të jetë abonent dhe të ketë lidhur kontratë furnizimi me ujë dhe energji elektrike në Tiranë.

35.8 FSHU-ja¹³⁶ konfirmon se me gjeneralitetet F. V. identifikohet një abonent me instancë Tiranë, ku sipas printimit nga sistemi i faturimit identifikohet në adresën “****”. Bashkëlidhur FSHU-ja ka përcjellë listën e faturimeve dhe pagesave për këtë kontratë.

35.9 ASHK Tirana Veri¹³⁷ informon se sipas verifikimeve në databazën digjitale të vetëdeklarimeve shtetasi F. K. V. rezulton vetëdeklarues për legalizim objekti pa leje me nr. *** prot., datë 15.11.2006, “Shtëpi banimi 2 kat”, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, por nga verifikimi i arkivit fizik ndodhet në mungesë. Gjithashtu sqaron se në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për procesin e legalizimit, praktika në mungesë mund të rikrijohet sërish, duke i kërkuar dokumentacionin vetëdeklaruesit. Bashkëlidhur ka paraqitur ekstraktin e nxjerrë nga sistemi i vetëdeklarimeve, ku ndërmjet të tjerave konstatohen të dhënat e vetëdeklaruesit, sipërfaqja e truallit të zënë 200 m², sipërfaqja e gjurmës së ndërtimit 113 m², fakti që ka përfunduar dhe numri i kateve mbi tokë 1.

35.10 Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasin F. V. dhe nga informacioni i administruar nuk rezulton që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit¹³⁸.

35.11 Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me përdorimin e banesës së shtetasit F. V. nga subjekti në vitin 2016, që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit.

36. Banesë në pronësi/përdorim të babait të subjektit në Tiranë

¹³¹ Fillimisht, DPGJC-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 24.10.2023, informoi se në datën 14.11.2006, familja Vukaj (Petrit Vukaj, A. V., R. V. dhe L. V.) ka ndryshuar vendbanimin duke u vendosur në Njësinë Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, me adresë vendbanimi lagjja “****”, ndërtesa nr. ***, hyrja ***, Tiranë. Sipas rikonfirmimit nga ZGJC-ja e Njësisë Administrative Nr. ***, Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 26.12.2023, duket se informacioni i dërguar nga DPGJC-ja se familja Vukaj në vitin 2006 ka ndryshuar vendbanimin duke u vendosur në Tiranë nuk është i saktë, për sa i përket vitit të ndryshimit pasi konstatohet se data dhe muaji i kërkesës është i njëjtë, por ndryshon viti nga 2006 në 2016.

¹³² Subjekti, bashkëshortja, djali.

¹³³ Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2023, nga DPGJC-ja.

¹³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2021.

¹³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021; shkresa nr. *** prot., datë 10.10.2023.

¹³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 4.3.2024.

¹³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2024.

¹³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 10.10.2023, e Prokurorisë së Rrethit Fier.

36.1 Në përgjigje të pyetësorit standard¹³⁹, subjekti ka deklaruar: “Në Tiranë kam me banim vëllezërit dhe babain tim”.

36.2 DPGJC-ja¹⁴⁰ informon se në datën 11.8.1994 shtetasi Gj. V. ka ndryshuar vendbanimin nga Njësia Administrative ***, Bashkia Tropojë, në Njësine Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, “****”.

36.3 UKT-ja¹⁴¹ informon se në emër të shtetasit Gj. K. V. rezulton kontrata nr. ***, për objektin me adresë rruga “****”, Tiranë, me status aktiv, në kategorinë e konsumatorëve familjarë, si dhe ka vënë në dispozicion dokumentin e identifikimit. Nga shqyrtimi i kartës së identitetit rezulton se përputhet me të dhënat e deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting* të babait të tij Gj. K. V..

36.4 Komisioni ka kërkuar nga ASHK Kodër Kamëz dokumentacionin e regjistrimit të pronësisë në emër të shtetasit Gj. V.. Në përgjigje, ASHK Kodër Kamëz¹⁴² informon se nga verifikimet në sistemin multifunksional nuk rezulton të ketë pasuri të paluajtshme të regjistruara.

36.5 Më tej, Komisioni kërkoi nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së informacion nëse shtetasi Gj. V. ka paraqitur kërkesë për legalizim objekti, si dhe dokumentacionin e dosjes së legalizimit. Në përgjigje¹⁴³, ky institucion sqaron se shtetasi Gj. K. V. nuk figuron aplikues për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimeve.

36.6 Në vijim, Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së i është drejtuar drejtorive vendore të ASHK-së për dhënien e informacionit të kërkuar nga Komisioni dhe nuk rezulton që shtetasi Gj.V. të ketë të regjistruar pasuri të paluajtshme në pronësi të tij.

36.7 Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1, i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacionin e pronësisë së banesës ku banon babai i tij. Në përgjigje¹⁴⁴, subjekti ka deklaruar se babai i tij jeton në adresën rruga “Përparimi”, Njësia Nr. ***, Blloku ***, ***, Tiranë, si dhe ka vënë në dispozicion kopje të certifikatës së pronësisë (me *email*) në emër të vëllait të tij.

36.8 Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti rezulton se në emër të shtetasit N. Gj. V. figuron e regjistruar pasuria nr. ***, z. k. ***, e llojit “truall”, me sip. 500 m², nga të cilat 115,9 m² ndërtesë, me pjesë 1/2, me adresë “****”, Tiranë.

36.9 ASHK Kamëz Vorë¹⁴⁵ informon se në emër të shtetasit Gj. V. nuk rezulton të ketë pasuri të paluajtshme të regjistruar pranë kësaj zyre.

36.10 Gjithashtu, edhe FSHU-ja¹⁴⁶ informon se me gjeneralitetet Gj. V. nuk identifikohet abonent me kontratë furnizimi me energji elektrike.

36.11 Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me banesën ku banon babai i subjektit, që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit.

¹³⁹ *Email* datë 27.1.2021.

¹⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2023.

¹⁴¹ Shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2021.

¹⁴² Shkresë nr. *** prot., 28.9.2023.

¹⁴³ Shkresë nr. *** prot., datë 7.11.2023.

¹⁴⁴ *Email* datë 11.3.2024.

¹⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2023.

¹⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

37. Automjete në përdorim

37.1 Në përgjigje të pyetësorit standard¹⁴⁷, subjekti ka deklaruar: (i) në vitin 2014 ka përdorur për ***, Greqi, për të shkuar me familjen tek kunati G. Xh., automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, pronë e shtetasit S. M.; (ii) në vitin 2014 ka përdorur mjetin e shtetasit E. K., me targë *** në Kosovë, ku shpenzimet e rrugës janë hequr nga E.; (iii) në datat 4.12.2014 dhe 18.12.2014 ka bërë rrugën vajtje-ardhje për të çuar në K. babain e E., shtetasin M. K., ku shpenzimet e rrugës janë hequr nga E.; (iv) në vitin 2013 ka përdorur automjetin e shtetasit K. K. me targë ***, pasi ka dërguar në Greqi dajën e tij, shtetasin S. P.. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues¹⁴⁸.

37.2 Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, rezulton se sipas kontratës për përdorim mjeti të datës 30.4.2014, shtetasi S. M. i ka dhënë në përdorim subjektit automjetin tip “Mercedes-Benz”, viti prodhimi 2000, me targë ***, për një periudhë 1-vjeçare, me qëllim që ta përdorë për nevoja vetjake, si dhe për përdorim jashtë shtetit. Këtë marrëdhënie shtetasi S. M. e ka konfirmuar edhe me deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.1.2021.

37.3 Në vijim, me deklaratën noteriale nr. ***, datë 9.1.2021, shtetasi Th. P. ka deklaruar se *me shtetasin Petrit Vukaj ka njohje familjare që prej vitit 1992 dhe se sa herë që ka shkuar në Greqi e ka marrë me vete në mjetin e tij tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, sa herë që ai ka dashur të shkojë tek kunati i tij, i cili gjithashtu ndodhej në Greqi.*

37.4 Gjithashtu, rezulton se në deklaratën e përbashkët noteriale nr. ***, datë 15.1.2021, të shtetasve K. dhe E. K., shtetasi K. K. ka deklaruar se *kanë njohje me shtetasin Petrit Vukaj dhe në vitin 2013 Petriti ka dërguar në Greqi dajën e tij S. P. me mjetin e tij me targë ***. Ndërsa shtetasi E. K. ka deklaruar se në vitin 2014 Petriti ka dërguar në Kosovë babain e tij M. K. me mjetin e tij me targë *** dhe se ata kanë bërë rrugën vajtje-ardhje në datat 4.12.2024 dhe 18.12.2014 dhe se shpenzimet e rrugës i ka hequr ai personalisht.*

37.5 Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasit S. M., Th. P., K., E. dhe M. K. dhe nga informacioni i administruar nuk rezulton të jetë në kushtet e konfliktit të interesit me këta shtetas¹⁴⁹.

37.6 Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me përdorimin e automjeteve të shtetasve të mësipërm nga subjekti që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit.

38. Në lidhje me disa kontrata furnizime energjie me emrin e subjektit/bashkëshortes

38.1 FSHU-ja¹⁵⁰ informon se me gjeneralitetet Petrit Vukaj identifikohen 3 abonentë me kontratë furnizimi nr. ***, nr. ***, në instancën Shkodër, nr. *** në instancën Fier dhe me gjeneralitetet A. R. V. identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. ***, në instancën Elbasan.

38.2 Në procesverbalin e datës 7.6.2016 të ILDKPKI-së¹⁵¹ lidhur me konstatimin se në emrin Petrit Vukaj figuron një abonent në Fier, një në Lezhë dhe tri në Shkodër, subjekti ka deklaruar se ka pasuri të paluajtshme vetëm adresën e deklaruar “***”, Fier dhe në asnjë nga adresat e

¹⁴⁷ Email datë 27.1.2021.

¹⁴⁸ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 8.1.2021, e shtetasit S. M.; kontratë përdorimi mjeti e datës 30.4.2014; deklaratë noteriale nr. ***, datë 9.1.2021, e shtetasit Th. P.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.1.2021, e shtetasve K. K. dhe E. K..

¹⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 10.10.2023, e Prokurorisë së Rrethit Fier.

¹⁵⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2021.

¹⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2023, e ILDKPKI-së.

tjera dhe me OSHEE-në disponon vetëm kontratën për shtëpinë e deklaruar dhe ka paraqitur kontratën nr. ***, datë 30.6.2016. Gjithashtu, në dokumentacionin e përcjellë nga ILDKPKI-ja konstatohet kopja e librezës e energjisë elektrike për kontratën nr. ***, zona Fier, në emër të subjektit.

38.3 Pas kërkesës për sqarim të Komisionit, FSHU-ja¹⁵² informon se: (i) kontrata nr. ***, me kod klienti ***, i përket abonentit Petrit Vukaj, është hapur në datën 29.6.2006 dhe sipas verifikimeve në terren u konstatua se është e pamundur të identifikohet abonenti; (ii) kontrata nr. *** me kod klienti *** i përket abonentit Petrit Vukaj, është hapur në datën 24.10.2003 dhe sipas verifikimeve në terren u konstatua se është e pamundur të identifikohet abonenti; (iii) kontrata nr. ***, me kod klienti ***, i përket abonentit Petrit Vukaj, është hapur në datën 14.3.1998 dhe sipas verifikimit në terren u konstatua se kontrata me të dhënat e mësipërme i përket abonentit A. C., me ID ***.

38.4 Për sa i përket kontratës nr. ***, me kod klienti ***, FSHU-ja informon se është hapur në datën 10.9.2007 dhe pas verifikimeve në terren u konstatua se i përket abonentit H. M., me ID ***.

38.5 Nga verifikimi i procesverbalit të datës 3.10.2023 të OSSH-së, Drejtoria Rajonale Fier, konstatohet shënimi i grupit të verifikimit me këtë përmbajtje: *“Nga verifikimi i kryer në terren te abonenti Petrit Gj. V., me kartë ID nr. ***, me atësi Gj.... nuk ka lidhje me personin tjetër”*.

38.6 Sa më sipër, duket se informacioni në shkresën e FSHU-së lidhur me kontratën nr. *** nuk është i saktë për sa i përket lidhjes së shtetasit A. C. me këtë kontratë, pasi numri i ID-së i vendosur pas emrit A. C. përkon me ID-në e subjektit.

38.7 Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit.

39. Analiza financiare

39.1 Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën qershor 1992 – 2016 për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur dhe i përcolli subjektit aneksin nr. 1, me emërtimin “Analiza financiare e detajuar” dhe aneksin nr. 2, me emërtimin “Metodika e analizës financiare”. Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit në lidhje me konstatimin se: Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -3.234.353 lekë në momentin e krijimit të pasurive, e detajuar si në vijim: i) Periudha 1992 – 1994 – Mungesë të burimeve të ligjshme financiar në shumën -532.756 lekë për ndërtimin e katit përdhe dhe kryerjen e shpenzimeve; ii) Viti 2006 – Mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -51.771 lekë për kryerjen e shpenzimeve në vitin 2006; iii) Viti 2009 – Mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -559.230 lekë për blerjen e automjetit me targë *** në periudhën prill – maj 2009; iv) Viti 2010 – Mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -713.857 lekë për ndërtimin e katit të parë, për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2010 dhe mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -1.241.823 lekë për depozitimin e shumës 10.000 euro në datën 1.7.2010; v) Viti 2016

¹⁵² Shkresë nr. *** prot., datë 10.10.2023.

– Subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -134.916 lekë në vitin 2016 për kryerjen e shpenzimeve.

39.2 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon se Komisioni duhet të korrigojë shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit për të gjitha udhëtimet të cilat i ka deklaruar në pyetësonin standard, pasi janë mbuluar nga persona të tretë, duke u akomoduar dhe qëndruar në banesat e tyre pa paguar për strehim dhe ushqim. Në vijim, në shpjegimet e tij subjekti ka pasqyruar tabelat financiare për vitet 2003 – 2016 dhe sipas tij rezulton se të gjitha vitet dalin me teprica kreditore dhe në asnjë vit nuk rezulton me balancë negative.

39.3 Në përfundim, subjekti ka parashtruar se ai ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës; ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive; nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në posedim ose në përdorim; pasuria në pronësinë e tij e krijuar gjatë periudhës së rivlerësimit në raport me të ardhurat është disa herë më e vogël, ndërkohë që Kushtetuta në nenin D të saj parashikon si masë disiplinore shkarkimi kur subjekti ka një pasuri më tepër se dyfishi i të ardhurave të ligjshme.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

39.4 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton si vijon:

39.5 Për sa i përket pretendimit të subjektit lidhur me shpenzimet e udhëtimit, Komisioni arsyeton se përllogaritja e tyre është kryer referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹⁵³, siç është sqaruar në aneksin nr. 2, me emërtim “Metodika e përdorur për analizën financiare”, që i është përcjellë subjektit së bashku me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit vlerësohet i pabazuar dhe shuma e shpenzimeve të udhëtimit mbetet e pandryshuar.

39.6 Pas analizimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimit të trupit gjykues për çdo çështje specifike si më sipër arsyetuar, nga ripërllogaritjet e kryera përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor rezultati financiar për periudhën shtator 1994 – 2016 paraqitet si në tabelën e mëposhtme.

¹⁵³ Vendim nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit.

Analiza financiare shtator 1994 - 2016 pas vlerësimeve të trupit gjykues

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	De tyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime	Balanca negative në fund të vitit	Balanca negative në momentin e krijimit
shtator 1994-dhjetor 2003	224,369	-	-	3,965,943	-	2,192,952	1,548,622		
2004	-	-	-	1,041,893	-	430,456	611,437	0	
2005	250,000	-	66,458	1,016,893	-	519,104	181,331	0	
2006	-	-	347,475	1,039,126	-	743,422	51,771	-51,771	-51,771
2007	-	-	172,503	1,132,089	-	841,055	118,532	0	
2008	729,815	-	345,082	1,110,428	-	715,642	10,053	0	
2009	1,539,045	-	245,459	1,502,712	-	661,060	451,935	-451,935	-559,230
2010	1,149,940	-	3,902	1,350,140	-	910,154	713,857	-713,857	-713,857
2011	-	150,000	102,955	1,455,947	-	850,116	352,876	0	
2012	-	150,000	19,211	1,486,599	-	989,928	365,882	0	
2013	-	300,000	427,820	1,447,296	-	695,231	624,244	0	
2014	-	-	389,753	1,791,297	-	1,111,874	289,670	0	
2015	-	200,000	34,465	1,735,243	-	1,343,426	157,353	0	
2016	-	200,000	50,399	770,780	-	1,055,298	134,916	-134,916	-134,916
TOTAL	3,893,169	-	985,978	20,846,383	-	13,059,717	2,907,519	-1,352,479	-1,459,774

39.7 Në përfundim, referuar analizës financiare të rishikuar, rezulton se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare në shumën 1.459.774 lekë, konkretisht: (i) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -51.771 lekë për kryerjen e shpenzimeve në vitin 2006; (ii) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -559.230 lekë për blerjen e automjetit me targë ***, në periudhën prill – maj 2009; (iii) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -713.857 lekë për ndërtimin e katit të parë, për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, në vitin 2010; (iv) mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën -134.916 lekë, në vitin 2016, për kryerjen e shpenzimeve.

Vlerësimi tërësor i kriterit të pasurisë

40. Në përfundim, bazuar në konkluzionet më lart, për të gjitha pasuritë e deklaruarat të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, trupi gjykues vlerësoi se mungesa e burimeve të ligjshme që lidhet me blerjen e pasurive në momentin e krijimit të tyre, si dhe me kryerjen e shpenzimeve në vitet 2006, 2009, 2010 dhe 2016, e cila rezultoi në vlerën (-) 1.459.774 lekë, e shpërndarë ndër vite, nuk është e mjaftueshme për të cenuar nivelin e besueshmërisë në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit në kuptim të përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion i trupit gjykues, nisur dhe nga rrethanat e pasqyruara në pikën 28.43.9, vlerësohet nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit¹⁵⁴.

KONTROLLI I FIGURËS

41. Ish-Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (sot Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e

¹⁵⁴ Referuar vendimit nr. 4 (JR), datë 16.2.2023, të Kolegjit.

organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shënimin “Sekret”.

41.1 Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2023, kërkoi nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) deklasifikimin e raportit mbi kontrollin e figurës të z. Petrit Vukaj, si dhe përditësimin e raportit me informacionet shtesë.

41.2 AKSIK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 20.11.2023, ka përcjellë raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Petrit Vukaj, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 17.11.2023, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

41.3 Sipas raportit, subjekti i rivlerësimit Petrit Vukaj: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

41.4 Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj.

Hetimi i Komisionit

41.5 Subjekti në përgjigje të pyetësorit standard¹⁵⁵ ka deklaruar se në vitin 2014 ka përdorur për të shkuar në ***, Greqi, tek kunati i tij G. Xh., automjetin tip “Mercedes-Benz” me targë ***, pronë e shtetasit S. M. dhe për vërtetimin e deklarimit të tij ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 8.1.2021, të shtetasit S. M. dhe kontratën e përdorimit të mjetit nr. ***, datë 30.4.2014.

41.6 Komisioni u njoh nëpërmjet mediave elektronike¹⁵⁶ se në datën 15.4.2021 shtetasi S. M., 55 vjeç, banues në Fier, është arrestuar nga shërbimet e policisë me qëllim ekstradimi drejt Italisë, pasi ishte dënuar me 7 vite e 6 muaj burg nga autoritetet gjyqësore të Xh. në Itali për veprat penale “Grup kriminal”, “Shfrytëzim prostitucioni” dhe “Plagosje”.

41.7 Referuar dokumentacionit të administruar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier¹⁵⁷ dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier¹⁵⁸ konstatohet se gjeneralitetet e shtetasit të arrestuar përkonin me gjeneralitetet e shtetasit S. M., të cilit subjekti i ka marrë në përdorim automjetin me targë *** në vitin 2014.

41.8 Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka paraqitur në gjykatë kërkesën për vleftësimin e masës së arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” ndaj shtetasit S. M. (alias S. J., lindur më 19.11.1965, B. R. lindur më 23.12.1965, B. R. lindur më 23.12.1966), pasi në datën 20.3.2021

¹⁵⁵ Email datë 27.1.2021.

¹⁵⁶ https://tvklan.al/dergonte-femra-shqiptare-ne-itali-arrestohet-***
https://telegrafi.com/arrestohet-ne***shhte-shpallur-ne-kerkim-nderkombetar/

¹⁵⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 17.4.2024.

¹⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 25.4.2024.

Prokuroria e Përgjithshme e Italisë ka lëshuar urdhër arresti ndërkombëtar, bazuar në urdhrin e ekzekutimit nr. ***, datë 3.8.2009, të Gjykatës së ***, Itali.

41.9 Konstatohet se shtetasi në fjalë është dënuar nga autoritetet gjyqësore në ***, Itali, me 7 vjet e 6 muaj burgim, për veprat penale “Grup kriminal”, “Shfrytëzim prostitucioni” dhe “Plagosje”, të parashikuara nga Kodi Penal i Italisë. Ky shtetas dyshohet se nga data 1.1.1994 deri më 31.12.2020, në bashkëpunim me persona të tjerë ka rekrutuar dhe dërguar ilegalisht në Itali femra shqiptare, të cilat më pas, nëpërmjet rrahjes dhe dhunës, i ka shfrytëzuar për prostitucion.

41.10 Në seancën gjyqësore të datës 17.4.2021, prokurori i seancës (H. A.) ka kërkuar nga gjykata që shtetasit S. M. t’i caktohet masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” për shkak të gjendjes shëndetësore dhe për shkak se për njërin nga të pandehurit në të njëjtin gjykim (vendim) në Itali (M. M.) Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 13.2.2020¹⁵⁹, ka vendosur refuzimin e njohjes së vendimit penal të datës 5.2.2001 të Gjykatës së Apelit të ***, Itali, pasi ekzekutimi i vendimit është parashkruar. Ndërsa në diskutimin përfundimtar prokurori i çështjes (V. Sh.) ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, me afat 40 ditë.

41.11 Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. ***, datë 17.4.2021, ka miratuar arrestimin e shtetasit S. M., si dhe ka caktuar si masë sigurimi “Arrest në burg”, me afat 40 ditë, me arsyetimin që brenda këtij afati duhet të vijë në Ministrinë e Drejtësisë kërkesa e ekstradimit dhe dokumentet që i bashkëlidhen asaj.

41.12 Në vijim, Ministria e Drejtësisë nëpërmjet postës elektronike të datës 27.4.2021 i ka përcjellë organit të akuzës informacionin e datës 23.4.2021 të Ministrisë së Drejtësisë të Italisë se urdhër arrestit bazuar në urdhrin e ekzekutimit nr. ***, datë 3.8.2009, të Gjykatës së ***, në Itali, të dhënë në ngarkim të shtetasit S. J. është anuluar për parashkrim të dënimeve dhe autoritetet italiane i kanë kërkuar Zyrës së Interpolit anulimin e kërkimit ndërkombëtar për këtë shtetas. Në këto kushte, prokuroria ka paraqitur kërkesën në gjykatë për revokimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. ***, datë 28.4.2021.

41.13 Ligji nr. 84/2016, në nenin 3, pika 15¹⁶⁰ parashikon se person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192/2009, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë.

41.14 Ligji nr. 10192/2009, në pikën 1 të nenit 3¹⁶¹ ka përcaktuar se dispozitat e tij zbatohen për pasuritë e personave që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të

¹⁵⁹ Vendim nr. ***, datë 19.5.2020, pjesë e dosjes së Prokurorisë së Rrethit Fier.

¹⁶⁰ Ligji nr. 84/2016, neni 3 parashikon: “15. Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet”.

¹⁶¹ Ligji nr. 10192/2009, neni 3 parashikon: “1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për: “a) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal...”.

tërthortë, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për: *“a) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal...”*.

41.15 Në rastin konkret rezulton se shtetasi S. M. në vitin 2001 është dënuar në Itali për veprat penale “Grup kriminal”, “Shfrytëzim prostitucioni” dhe “Plagosje”. Në kushtet kur vepra penale “Grup kriminal” sipas legjislacionit italian përkon me veprën penale “Grup i strukturuar kriminal”, që parashikohet në nenin 333/a, kreu XI i Kodit Penal Shqiptar, bazuar në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi S. M. konsiderohet “person i përfshirë në krimin e organizuar”.

41.16 Referuar deklaratës për kontrollin e figurës, të dorëzuar sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti nuk e ka deklaruar marrëdhënien me shtetasin S. M..

41.17 Sa më lart, nga hetimi administrativ rezulton se: (i) subjekti në vitin 2014 ka përdorur për të shkuar me familjen në ***, Greqi, automjetin tip “Mercedes-Benz” me targë ***, pronë e shtetasit S. M.; (ii) shtetasi S. M. figuron i dënuar në vitin 2001 në Itali për veprat penale “Grup kriminal”, “Shfrytëzim prostitucioni” dhe “Plagosje”; (iii) shtetasi S. M. konsiderohet “person i përfshirë në krimin e organizuar”, në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, pasi është dënuar për një nga veprat penale që parashikohen nga kreu XI i Kodit Penal Shqiptar; (iv) subjekti në pjesën 5 të shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, “Të dhëna për sigurinë”, pyetjes në shkronjën “e”, *A keni pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar?*, i është përgjigjur “jo”, ndërkohë që nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka pranuar favorin e përdorimit të automjetit, pasuri e z. M., i cili është person i përfshirë në krimin e organizuar dhe do të duhet ta kishte deklaruar. Ky detyrim parashikohet në deklaratën për kontrollin e figurës, të dorëzuar sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016.

41.18 Në përfundim rezultoi se: (i) kontakti i subjektit të rivlerësimit me shtetasin S. M., nëpërmjet përdorimit të automjetit të tij në vitin 2014 si dhe, më tej, në vitin 2021, kohë kur z. M. ka lëshuar një deklaratë noteriale për të vërtetuar dhënien në përdorim të automjetit, është kontakt i papërshtatshëm faktik me një person të përfshirë në krimin e organizuar. Pra, në kuptim të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, z. M. është kontakt i papërshtatshëm në kuptim të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, pasi ky shtetas konsiderohet “person i përfshirë në krimin e organizuar”; (ii) subjekti nuk ka deklaruar kontaktin me shtetasin S. M. në formularin e deklarimit të figurës sipas parashikimeve të shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur ky shtetas sipas parashikimeve të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 konsiderohet “person i përfshirë në krimin e organizuar”, pasi është dënuar për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192/2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

41.19 Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) Duket se kontakti i subjektit të rivlerësimit me shtetasin S. M. nëpërmjet përdorimit të automjetit në vitin 2014 dhe, më tej, lëshimi i deklaratës noteriale në vitin 2021, është kontakt i papërshtatshëm faktik i subjektit me “person të përfshirë në krimin e organizuar”, sipas parashikimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pranimin e favorit të përdorimit të pasurisë/automjet nga shtetasi S. M.

në formularin e deklaramit të figurës sipas parashikimeve të shtojcës 3, pjesa 5, shkronja “e” e ligjit nr. 84/2016, pasi kësaj pyetjeje i është përgjigjur “jo”, në kushtet kur ky shtetas sipas parashikimeve të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 konsiderohet “person i përfshirë në krimin e organizuar”, pasi është dënuar për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192/2009, i ndryshuar.

41.20 Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁶², subjekti deklaroi se ekzistencën e procedimit penal ndaj shtetasit S. M. në shtetin italian e ka mësuar për herë të parë pasi u njoh me rezultatet e hetimit në datën 14.5.2024.

41.21 Më tej, shpjegon se këtë shtetas për herë të parë e ka rastisur në vitin 2014, pasi ishte njohje e mikut të tij, shtetasit O. M.. Këta dy shtetas, vijon subjekti, posedonin dy pika karburanti në qytetin e Fierit dhe mes tyre i lidhte e njëjta kategori biznesi. Në vijim, sqaron se në atë periudhë do të udhëtonte familjarisht drejt shtetit grek për të shkuar te kunati, por automjeti i tij nuk ishte i përshtatshëm për udhëtime të gjata dhe i ka kërkuar shtetasit O. M. automjetin e tij për vetëm 3 ditë. Duke qenë se ky shtetas nuk mund t’ia vinte në dispozicion për arsye personale, i ka siguruar automjetin e mikut të tij S. M..

41.22 Më pas shpjegon se nuk e njohte këtë person dhe nuk ka njohje të drejtpërdrejtë, përveçse në vitet 2014 dhe 2021, kur për efekt të procesit të rivlerësimit i ka kërkuar të lëshojë një deklaratë noteriale për të konfirmuar dhënien e automjetit për përdorim për vetëm 4 ditë. Për vërtetimin e deklaramit shpjegon se ka paraqitur deklaratën noteriale të shtetasit O. M., të lëshuar në datën 27.5.2024, i cili konfirmon faktin se *me këtë shtetas nuk njihet më parë dhe nuk ka pasur asnjë marrëdhënie shoqërore.*

41.23 Gjithashtu, subjekti shpjegon se referuar dokumentacionit të lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, të administruar nga Komisioni, rezultoi e provuar se ndaj këtij shtetasi ka nisur procedimi penal për ekstradimin e tij për llogari të një vendimi gjyqësor italian të vitit 2002, vetëm në vitin 2021, ndërkohë që plotësimi i deklaramit *Vetting* nga ana e tij është dorëzuar në janar të vitit 2017, pra 4 vite më përpara nga momenti i regjistrimit të procedimit, fakt të cilin nuk kishte si ta dinte. Në vitin 2014, sqaron subjekti, kur ka udhëtuar me automjetin e këtij shtetasi, ky shtetas nuk ka pasur asnjë procedim penal të regjistruar dhe nuk kishte si të dinte se kishte një procedim penal.

41.24 Në përfundim, deklaroi se Komisioni duhet ta trajtojë kontaktin për përdorimin e automjetit për një afat shumë të shkurtër kohor të shtetasit S. M. si një kontakt rastësor.

41.25 Për vërtetimin e deklaramitve subjekti ka paraqitur si provë deklaratën noteriale të shtetasit, me nr. ***, datë 27.5.2024, të shtetasit O. M., i cili konfirmon deklaramitet e mësipërme të subjektit.

41.26 Në seancën gjyqësore të datës 10.6.2024 subjekti, përveç shpjegimeve të mësipërme, deklaroi se nuk ka pasur dijeni për arrestimin e shtetasit S. M. në prill të vitit 2021, pasi në periudhën 16.3.2021 – 30.3.2021 ka qenë i sëmurë me COVID dhe ka qenë i vetizoluar. Për vërtetimin e deklaramit subjekti ka paraqitur në seancë kopje të vërtetimit nr. *** regjistri, datë 16.3.2021, të Qendrës Shëndetësore nr. ***, Fier.

¹⁶² Email datë 4.6.2024.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

41.27 Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën për kontrollin e figurës; (ii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iii) shpjegimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton si vijon:

41.28 Rezultoi se në kohën e marrëdhënies së subjektit me shtetasin S. M. lidhur me përdorimin e automjetit në vitin 2014, në një afat të shkurtër kohor, nga hetimi i autoriteteve ligjzbatuese shqiptare e të huaja nuk u provua ekzistenca e ndonjë informacioni për të dhëna për përfshirje të këtij shtetasi në krimin e organizuar. Në këtë drejtim rezultoi e provuar se deri në kohën e pasjes së kontaktit për marrjen e automjetit në përdorim dhe plotësimit të deklaratës së kontrollit të figurës për shtetasin S. M., nuk rezultonte asnjë e dhënë për procedime/dënime apo njohje të ndonjë vendimi penal të huaj, për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

41.29 Trupi gjykues në këtë çështje objekt vlerësimi evidenton faktin se të njëjtat rrethana si më sipër arsyetuar rezultuan edhe në kohën e lëshimit të deklaratës noteriale të shtetasit S. M., në datën 8.1.2021.

41.30 Në rrethanat konstatuese të kësaj çështjeje, në vlerësimin e këtij kontakti si të papërshtatshëm me këtë shtetas, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e dala nga hetimi i çështjes, shpjegimet dhe provat e depozituara në prapësime, si dhe në të dhënat e administruara nga autoritetet përgjegjëse për kontrollin e figurës, trupi gjykues çmon se nuk disponohen elemente të mjaftueshme provueshmërie për të përmbushur rrethanat e parashikuara në pikën 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, rrethana këto që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, në përputhje me standardet e kontrollit të figurës, sipas po këtij neni. Në këtë drejtim, trupi gjykues çmon se referuar standardeve të kontrollit të figurës, materializuar në dispozitat ligjore si më sipër referuar, në kushtet që ky kontakt ka qenë 7 vite më parë, si dhe dënimi i këtij shtetasi nuk rezultoi i njohur, publikuar apo dokumentuar, bëhet e cënueshme proporcionalisht shkalla e seriozitetit të kontaktit të papërshtatshëm dhe etiketimi i prezumimit të dijenisë prej subjektit, pasi në këtë rast nuk arrihet të provohet me prova të plota dhe objektive që subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni për ekzistencën e dënimit për këtë shtetas, në të kundërt nuk mund të flitet për fajësinë në formën e dashjes direkte, që nënkupton dijeninë se personi me të cilin ka pasur kontakt të papërshtatshëm është i dënuar për krim të organizuar dhe, pavarësisht kësaj, ai vazhdon të ketë kontakte.

41.31 Trupi gjykues, në këtë çështje, për sa konstatoi më sipër, çmon se subjekti ka përmbushur detyrimin ligjor për plotësimin e shtojcës nr. 2 “Deklarata për kontrollin e figurës”, si pjesë e ligjit nr. 84/2016, me vërtetësi e saktësi pasi përgjatë procesit të rivlerësimit për këtë subjekt ka rezultuar e provuar se:

41.32 Në momentin e plotësimit të deklaratës së kontrollit të figurës sipas ligjit nr. 84/2016, specifikisht nenit 35 të tij dhe dorëzimit të saj në datën 25.1.2017 pranë DSIK/AKSIK, ky shtetas nuk ka pasur asnjë procedim penal në ngarkim të tij në shtetin shqiptar, sikurse nuk rezultoi ndonjë informacion në çfarëdo lloj mënyre, përfshirë edhe aksesin në media, duke përjashtuar në këtë mënyrë subjektin nga përgjegjësia e tij për të deklaruar një fakt të paditur.

Çështja penale e njohur ne shtetin shqiptar në maj të vitit 2021, nuk mund t'i adresohet subjektit se ai domosdoshmërisht kishte dijeni, për sa kohë ajo hetohej në të njëjtën prokurori ku ushtronte funksionin, jo vetëm se kërkesa për ekstradim është vënë në lëvizje shumë vite pas dorëzimit të deklaratës së kontrollit të figurës, porse ky tregues në perceptimin e publikut për sistemin e drejtësisë në tërësi do të përbënte premisë për shkelje të konfidencialitet të informacionit të prokurorit/subjekt tjetër që vlerësonte kërkesën për ekstradim, apo të ndonjë ndikimi të tij tek rasti. Gjithsesi, përpos sa më sipër, si parim i përgjithshëm vlen të theksohet se përgjegjësia e një subjekti duhet të burojë nga një rrethanë specifike apo fakt konkret penalizuese, që detyrimisht lidhet me dijeninë e subjektit, apo me mungesën e kujdesit të duhur prej tij për të shmangur kontaktet e papërshtatshme (të njohura) dhe kurrësi nuk mund të ketë penalizim bazuar thjesht në hipotizimin se ndoshta subjekti, në rrugë të tërthorta dhe formalisht jo të aksesueshme, mund të ketë marrë dijeni mbi ekzistencën e një procedimi/dënimi ndaj dikujt. Për më tepër, në rastin konkret, sikurse është përshkruar më sipër, bëhet fjalë për një procedim të shumë viteve pas dorëzimit të deklaratës *Vetting nga subjekti*. Nga ana tjetër nga hetimi i kryer mbeti e paprovuar njohja e kësaj çështje nga subjekti apo ndikimi i tij në të, dhe për pasojë, nuk konstatohen problematika që lidhen me figurën e subjektit.

41.32 Në rrethanat e kësaj çështjeje rezultoi e provuar se çdo e dhënë/informacion lidhur me ekzistencën e procedimit penal për ekstradimin e këtij shtetasi për llogari të një vendimi gjyqësor italian të vitit 2001 u bë prezent vetëm në vitin 2021, pra rreth 7 vite pas kontaktit të subjektit për përdorimin e automjetit dhe se ky kontakt gjithashtu rezultoi i provuar i realizuar rreth 13 vite prej kohës kur ai ishte dënuar në shtetin italian.

41.33 Këto rrethana duket se shkojnë në favor të subjektit, duke përjashtuar çdo mundësi objektive të pasjes dijeni nga ana e tij për procedime apo dënime të mundshme ndaj këtij shtetasi, rrethanë kjo, që e shoqëruar edhe me mungesën e ndonjë hetimi nga subjekti për këtë shtetas, përjashton favorizimin e tij në dhënien e automjetit në përdorim.

41.34 Trupi gjykues në këtë drejtim ka analizuar edhe besueshmërinë e deklarimeve të subjektit, ku përgjatë hetimit evidentohen deklaratimet si vijon:

i) Në deklaratën noteriale të datës 8.1.2021, shtetasi S. M. ndër të tjera, ka deklaruar se ka njohje me subjektin e në vitin 2014 ai do të shkonte në Greqi për 3 net bashkë me familjen, porse automjeti i tij kishte një problem elektrik e kështu ata kanë shkëmbyer mjetet për këtë udhëtim treditör.

ii) Në prapësime subjekti ka parashtruar rrethanat e njohjes me këtë shtetas, duke deklaruar se njohja me të ka qenë jo e drejtpërdrejtë, por përmes shtetasit O. M., për të cilin Komisioni ka konstatuar se ky shtetas në procesin e rivlerësimit ka cilësinë e huadhënësit për subjektin dhe ka konfirmuar deklaratimet e subjektit si në rastin e huadhënies, rezultuar me burime të ligjshme, ashtu edhe për këtë marrëdhënie, me qëllim përdorimin e automjetit.

iii) Shtetasi O. M. me deklaratën noteriale të lëshuar prej tij në datën 27.5.2024 ka deklaruar se subjekti i rivlerësimit me shtetasin S. M. nuk njihej më parë dhe nuk ka pasur asnjë marrëdhënie shoqërore.

iv) Në prapësime subjekti parashtron se: *“...nuk ka pasur dijeni në asnjë moment për të dhënat apo rekordet kriminale të këtij shtetasi, të kryera dekada/vite më parë. Nëse minimalisht do kisha pasur një dijeni të tillë, jo vetëm që do e kisha deklaruar një fakt të tillë në të dhënat*

konfidenciale, por në mënyrë kategorike nuk do kisha pranuar të përdorja automjetin në emër të tij”.

41.35 Në analizë të deklarimeve të subjektit dhe shtetasve S. M. dhe O. M., në raport me tërësinë e fakteve të dala gjatë hetimit, trupi gjykues çmon se në këtë rast “*Njohja nën rrethanat e paraqitura apo të pretenduara nga subjekti si njohje jo e drejtpërdrejtë*”, nuk mund t’i vishet subjektit si një veprim i hamendësuar apo të merret apriori për ta kualifikuar atë si një marrëdhënie shoqërore me një njohje të hershme të vazhdueshme, apo vetëm për marrjen e automjetit në përdorim. Nga ana tjetër, edhe kontrata e nënshkruar mes palëve për përdorimin e automjetit në vitin 2014 ka ardhur si detyrim ligjor, të cilin subjekti e ka përmbushur, për të lëvizur me një automjet që nuk e kishte në pronësinë e tij, e ka deklaruar në pyetësozin standard për efekt të këtij procesi, konfirmuar përmes deklaramit të tij nga shtetasi O. M. po për efekt të këtij procesi, ku subjekti ndodhet në të njëjtën rrethana që fakti i dënimit të këtij shtetasi nuk ishte i njohur, pra i dokumentuar nga autoritetet përkatëse, apo i publikuar nga media për procedime apo dënime të këtij shtetasi.

41.36 Pavarësisht kohës së shtrirjes së kontratës me afat njëvjeçar, për të cilën subjekti e pretendon si një “akt standard”, trupi gjykues në mungesë të të dhënave të këtij dyshimi apo të mungesës së evidentimit të kontakteve të tjera vazhduese konstaton se përsëri kjo periudhë nuk plotësohet me konfirmimin e hetimeve/dënimeve të këtij shtetasi, ku dijenia mbetet një rrethanë e panjohur dhe objektivisht e pamundur për t’u diktuar nga trupi gjykues në adresë të subjektit.

41.37 Nën këtë arsyetim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se nuk u provuan kushte apo rrethana, të cilat në kuptim të kreut V të ligjit nr. 84/2016, apo specifikisht të nenit 38 të po këtij ligji, e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës dhe nuk mund të arrijë në një konkluzion tjetër përveçse ai ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion është çmuar edhe në raport me të dhënat negative të konfirmuara nga organet ligjzbatuese që lidhen me verifikimin e kontrollit të figurës apo me mungesën e të dhënave të tjera përgjatë hetimit lidhur me figurën e subjektit.

41.38 Gjithashtu, trupi gjykues çmon se për sa kohë provat dhe rrethanat e kësaj çështjeje nuk ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, nuk evidentohen elemente të tillë të arsyeshëm, të konsiderueshëm apo të perceptueshëm, për t’i kualifikuar si cenim të besimit të publikut, sipas pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

B. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

42. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, parashikuar në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

42.1 Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka hartuar raportin e vlerësimit profesional për këte subjekt.

42.2 Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

42.3 Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, së bashku me tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin, të paraqitura nga subjekti; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga 23 prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, sektorit të protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

42.4 Nga shqyrtimi i të dhënave në dosjen personale konstatohet se subjekti i rivlerësimit Petrit Vukaj në periudhën 1 qershor 1992 – 1995 ka punuar në detyrën e hetuesit në Hetuesinë Fier, e më pas nga viti 1995 deri në datën 1.5.2003 ka punuar në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore. Nga data 1.5.2003 e në vijim ka qenë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

42.5 Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Në tri aktet procedurale ligjore të paraqitura prej tij dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit.

b) Arsytimi ligjor

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i 5 dosjeve penale të shortuara, konstatohet se subjekti nga pikëpamja gjuhësore ka respektuar rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsytimit të aktit të përgatitur prej tij dhe përpiqet të përdorë të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Në përmbajtjen e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje, i kushtohet rëndësi pasqyrimit të përmbajtjes së provave, duke paraqitur në mënyrë të hollësishme përmbajtjen e tyre, si dhe tregimit të rrethanave të faktit. Në të gjitha aktet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe dosjet e shortuara janë analizuar në mënyrë të hollësishme ose të përmbledhur elementet e veprës penale objekt hetimi.

Hetimi i Komisionit

42.5.1 Pavarësisht raportit të dërguar nga KLP-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me 3 dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me 5 dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv.

42.5.2 Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal rezulton se në datën 15.11.2015 shërbimet e Policisë Rrugore kanë arrestuar në flagrancë shtetasin J. Xh., pasi ishte duke drejtuar motorin tip “Lancin” pa targë, me fuqi motorike ***, pa leje drejtimi. Është kryer këqyrja e motomjetit dhe ka rezultuar se kishte fushë kilometrike 160 km/h dhe fuqi motorike ***. Sipas informacionit të administruar nga DRSHTRR Fier, ka rezultuar se i dyshuari është i pajisur me leje për drejtim automjeti, kategoria B. Në këto kushte, Komisariati i Policisë ka përcjellë

materialet hetimore pranë Prokurorisë së Rrethit Fier. Subjekti me urdhrin e datës 16.11.2015 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasit J. Xh.. Në vijim, me kërkesën e datës 17.11.2015 ka kërkuar nga gjykata vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Më pas ka marrë vendimin e datës 24.11.2015 për dërgimin në gjyq të çështjes penale dhe ka paraqitur kërkesën në gjykatë për gjykimin e të pandehurit J. Xh. për kryerjen e veprës penale, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

42.5.3 Me vendimin e drejtuesit të Prokurorisë të datës 4.12.2015, subjekti është zëvendësuar me një prokuror tjetër, dhe ky i fundit ka bërë përfaqësimin në gjykim. Në diskutimin përfundimtar të datës 8.6.2016, prokuroja e çështjes ka kërkuar pushimin e çështjes penale me arsyetimin se gjatë gjykimit është kryer akti i ekspertimit autoteknik dhe ka rezultuar se motomjeti që drejtohej nga i pandehuri kërkon leje drejtimi të kategorisë B, të cilën i pandehuri e disponon dhe, sipas Kodit Rrugor të ndryshuar (me ligjin nr. 175/2014), fakti nuk parashikohet si vepër penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 8.6.2016, ka vendosur pushimin e çështjes penale dhe heqjen e masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” të shtetasit J. Xh.. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 21.6.2016.

42.5.4 Pas analizimit të tyre lidhur me këtë dosje, që i përket procedimit penal nr. *** të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, regjistruar në datën 16.11.2015 për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: (i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit autoteknik të motomjetit të sekuestruar për të përcaktuar karakteristikat e tij lidhur me fuqinë motorike; (ii) Subjekti ka marrë në përgjegjësi penale të pandehurin për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, në kushtet kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; (iii) Subjekti ka marrë në përgjegjësi penale shtetasin J. Xh., duke mos zbatuar parimin e ligjshmërisë parashikuar nga neni 2 i Kodit Penal.

42.5.5 Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁶³, subjekti shpjegon se nuk ka urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit autoteknik, pasi shkronja “dh” e pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor përcakton se: *“Lejet e drejtimit të dhëna për kategoritë A, B, C ose D janë të vlefshme përkatësisht për kategoritë A1 e A2, B1, C1 ose D1”*. Nga ky formulim, vijon subjekti, rezulton qartë se leja e drejtimit e kategorisë B është e vlefshme vetëm për kategorinë B1 dhe motomjeti që drejtonte i pandehuri J. Xh. kërkonte pajisjen e tij me leje drejtimi të kategorisë A1, e cila, siç evidentohet edhe më sipër, nuk përfshihet si e vlefshme për lejet e drejtimit të kategorisë B.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

42.5.6 Trupi gjykues, në analizë të akteve të administruara në dosjen penale që i përket procedimit nr. ***/2015 dhe shpjegimeve të subjektit, konstaton se janë kryer veprime hetimore lidhur me faktin nëse i dyshuari dispononte leje drejtimi për mjete motorike. Kjo provohet me shkresën e DPPShtetit nr. *** prot., datë 16.11.2015, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, së cilës i kërkohet nëse shtetasi J. Xh. është i pajisur me leje drejtimi për të drejtuar motomjet (motor). Në vijim të kësaj kërkesë, ky institucion nuk ka konfirmuar sipas

¹⁶³ Email datë 4.6.2024.

kërkesës, por ka konfirmuar mbi leje drejtimi të kategorisë B, të disponuar nga ky shtetas për drejtim automjeti. Po ashtu, në dosje është depozituar edhe një policë sigurimi sipas lejes së qarkullimit në emër të pronarit të motorit, I. G..

42.5.7 Në datën 24.11.2015, kur subjekti i rivlerësimit ka vendosur për njoftimin e akuzës, i pandehuri Xh., pasi është pyetur në lidhje me ushtrimin e të drejtave që gëzon, por edhe në lidhje me akuzën në ngarkim të tij, ka pranuar duke deklaruar se nuk është i pajisur me leje drejtimi për motomjete dhe, po ashtu, nuk ka kërkuar mbrojtës. Këtë deklaram ai e ka bërë edhe në procesverbalin datë 15.11.2015, “Për deklarin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet”.

42.5.8 Trupi gjykues konstaton se duket se subjekti ka proceduar me dërgimin e shpejtë të kërkesës drejtuar gjykatës për gjykimin e çështjes, çështje e cila është përfaqësuar në gjykim nga organi i akuzës nga një subjekt tjetër rivlerësimi, duke u mjaftuar me ekzistencën e fakteve të dala, si: (i) fakti që i dyshuari nuk ka disponuar dokumentin e drejtimit të motorit në momentin e kapjes në flagrancë; (ii) fakti që institucioni përgjegjës nuk ka konfirmuar leje drejtimi për mjetin me të cilin është kapur i dyshuari në flagrancë; (iii) fakti që mjeti nuk ka qenë në emër të këtij shtetasi, por edhe vetëdeklarimi i të pandehurit se nuk dispononte leje drejtimi për motomjet.

42.5.9 Por, në aplikim të kërkesave të nenit 123, pika 2, shkronjat “dh”, “e” dhe “ë” të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, të Kodit Rrugor, i ndryshuar, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka munguar në ndërmarrjen e veprimit hetimor, sikurse ishte mos kryerja e aktit të ekspertimit për të konkluduar mbi vlefshmërinë e lejes së drejtimit që dispononte shtetasi J. Xh. edhe për motomjet, akt i cili u krye nga gjykata. Mbi këto fakte e rrethana trupi gjykues çmon se subjekti shfaq mangësi sipas nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

42.6 Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe nga të dhënat statistikore ka trajtuar gjithsej 574 çështje (procedime dhe kallëzime), ku përfshihen edhe çështjet e pezulluara. Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i tij ka qenë në përgjithësi brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Subjekti i rivlerësimit, në respektim të afateve procedurale, ka paraqitur qëndrimin e tij para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve, për mospërgatitjen e tij për çështjen në gjykim.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Petrit Vukaj, tregon profesionalizëm në gjykim dhe në qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht dhe materialet të vendosura në rend kronologjik.

42.7 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Petrit Vukaj, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk ka të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

42.8 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në tri dokumentet e dorëzuara prej tij, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e Prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Në periudhën e rivlerësimit, subjekti nuk ka deklaruar se është angazhuar në aktivitete profesionale (seminare) të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Subjekti i rivlerësimit, prokurori Petrit Vukaj, ka deklaruar në formular pjesëmarrjen në 11 trajnime të kryera jashtë periudhës së rivlerësimit, duke i bashkëlidhur kopje të certifikatave, që vërtetojnë kryerjen e këtyre trajnimeve.

42.9 Të dhëna nga burimet arkivore të KLP-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme

42.9.1 Nga të dhënat që ndodhen në sektorin e burimeve njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se me urdhrin nr. ***, datë 3.12.2015, të Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit Petrit Vukaj është pezulluar nga detyra, pasi Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, e parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal në ngarkim të z. Petrit Vukaj etj. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka vendosur deklarinim fajtor të subjektit dhe dënimin e tij me 3 vite burgim, pezullimin e ekzekutimit të dënimit për një periudhë 18 muaj, me kusht që të mos kryejë veprë tjetër penale dhe heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për një

periudhë 5-vjeçare. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, me vendimin nr. ***, datë 28.12.2016, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 27.10.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe pushimin e çështjes me të pandehur Petrit Vukaj. Pas vendimit të pushimit të çështjes nga gjykata, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhrin nr. ***, datë 16.1.2017, “Për revokimin e urdhrit nr. ***, datë 3.12.2015 dhe rikthimin në detyrën e prokurorit”. Ndaj subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj ka këto materiale hetimore:

42.9.2 Me shkresën nr. *** prot., datë 20.1.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka konfirmuar se shtetasi Petrit Vukaj ka bërë kallëzim penal ndaj shtetasit L. B. për veprat penale “Kanosja e gjyqtarit” e “Fyerja e gjyqtarit”, parashikuar nga nenet 317 e 318 të Kodit Penal, si dhe është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 7.3.2019. Për këtë procedim penal, në datën 24.12.2020 është kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë pushimi i hetimeve. Kjo kërkesë është duke u shqyrtuar në gjykatë.

42.9.3 Drejtoria e koordinimit institucional, si dhe sektori i protokoll-arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme bën me dije se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme rezulton se nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj. Gjithashtu, nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në mënyrë manuale për periudhën 2006 – 2020, rezulton se ndaj subjektit ka këto ankesa:

42.9.4 Ankesa nr. *** prot., viti 2018, e shtetas F. M., e cila ka kërkuar informacion nëse është zbuluar autori i vrasjes së të birit në vitin 2014, duke përmendur se çështja hetohet nga prokurori Petrit Vukaj. Prokuroria e Përgjithshme e ka dërguar për vlerësim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

42.9.5 Ankesa nr. *** prot., viti 2015, e shtetas E. M., e cila ankohet kundër prokurorit Petrit Vukaj, sepse padrejtësisht ka pushuar çështjen penale të aksidentit, ku ka humbur jetën bashkëshorti i saj. Këtë ankesë e ka përsëritur disa herë, duke pretenduar se prokurori ka kryer veprime korruptive. Kjo ankesë nuk është pranuar nga Prokuroria e Përgjithshme, duke i bërë të ditur ankueses se vendimi i pushimit është ankimuar në gjykatë dhe është gjykata që e shqyrton dhe se për veprimet korruptive duhet të paraqesë kallëzim penal.

42.9.6 Ankesa nr. *** prot., viti 2015, e shtetasit A. A., i cili ankohet kundër prokurorit Petrit Vukaj se padrejtësisht ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzimin e tij për prishjen e banesës. Kjo ankesë nuk është pranuar nga Prokuroria e Përgjithshme, duke i bërë të ditur ankuesit se është njoftuar disa herë për t’u paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme dhe nuk është paraqitur. Gjithashtu i kanë ridërguar një kopje të vendimit të mosfillimit, duke i bërë të ditur të drejtën e ankimit në gjykatë.

42.9.7 Ankesa nr. ***, viti 2012, e shtetasit S. Gj., i cili ankohet kundër prokurorit Petrit Vukaj se padrejtësisht ka vendosur pushimin e procedimit penal për veprën penale të mashtrimit dhe padrejtësisht gjykata e ka lënë në fuqi këtë vendim pushimi. Kjo ankesë nuk është pranuar nga Prokuroria e Përgjithshme, duke i bërë të ditur ankuesit se çështja po gjykohet në Gjykatën e Apelit dhe se është gjykata ajo që vendos për zgjidhjen e saj.

42.9.8 Hetimi i Komisionit

42.9.9 Komisioni, bazuar në informacionin e administruar nga KLP-ja¹⁶⁴, Gjykata e Posaçme e Apelit¹⁶⁵ dhe Gjykata e Lartë¹⁶⁶, pasqyroi në vijim rrethanat e procedimit penal nr. ***, viti 2015, në ngarkim të subjektit për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319/ç e 25 të Kodit Penal, si dhe rrethanat e procedimit penal nr. ***/2015¹⁶⁷, për shkak të së cilës subjekti është marrë në përgjegjësi penale nga ish-Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda.

i. Lidhur me procedimin penal nr. ***, viti 2015, në ngarkim të subjektit për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319/ç e 25 të Kodit Penal.

ii. Rrethanat e faktit – Në datën 31.3.2015 është arrestuar në flagrancë shtetasi E. Xh., pasi në aksin rrugor Levan-Tepelenë, teksa ka qenë duke drejtuar automjetin e tij, ka dalë nga rruga e, për pasojë, ka gjetur vdekjen shtetasi P. B., i moshës 45 vjeç, i cili ka qenë në vendin e pasagjerit. Në lidhje me aksidentin e ndodhur, subjekti Petrit Vukaj ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. ***, datë 1.4.2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve, shtetasi E. Xh. është marrë i pandehur dhe është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

iii. Në datën 7.10.2005 zhvillohet seanca gjyqësore në ngarkim të shtetasit E. Xh., në praninë e prokurorit të çështjes Petrit Vukaj. Në seancën gjyqësore, në diskutimin përfundimtar subjekti ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal, dënimin e tij me 3 vjet burgim, uljen e 1/3-ës së dënimit, si dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit. Në përfundim, gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit, duke e dënuar me 2 vjet e 6 muaj burgim dhe duke i zbritur 1/3-at e dënimit e ka dënuar përfundimisht me 1 vit e 8 muaj burgim dhe nuk e ka pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të dënimit.

iv. Komisioni, duke çmuar se të njëjtat fakte mund t’u shërbejnë në mënyrë të pavarur procedimeve të ndryshme, të cilat ndjekin qëllime të ndryshme¹⁶⁸, ka analizuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit si prokuror që ka ndjekur procedimin penal nr. ***, viti 2015, pavarësisht faktit që veprimet e subjektit janë analizuar në kuadër të një procedimi penal.

Analiza e Komisionit

42.9.10 Referuar akteve të procedimit penal, rezulton se në datën 31.3.2015 është arrestuar në flagrancë shtetasi E. Xh., pasi në aksin rrugor Levan-Tepelenë, teksa ka qenë duke drejtuar automjetin e tij, ka dalë nga rruga e, për pasojë, ka gjetur vdekjen shtetasi P. B., i moshës 45 vjeç, i cili ka qenë në vendin e pasagjerit. Në lidhje me aksidentin e ndodhur, subjekti Petrit Vukaj ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. ***, datë 1.4.2015, për veprën

¹⁶⁴ Dosja e analizimit të aftësive profesionale - shkresë nr. *** prot., datë 28.1.2021, e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

¹⁶⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 13.10.2023.

¹⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 17.10.2023.

¹⁶⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 19.10.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

¹⁶⁸ Vendimi nr. 30, datë 18.11.2019 (JR), paragrafi 52 i Kolegjit.

penale të parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve, shtetasi E. Xh. është marrë i pandehur dhe është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

42.9.10 Sipas dokumentit “Diskutim përfundimtar”, tetor 2015, subjekti ka kërkuar nga gjykata dënimin e të pandehurit me 3 vite burgim, në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale t’i zbritet 1/3 e dënimit dhe, në aplikim të nenit 59, pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale, si dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***¹⁶⁹, datë 7.10.2015, ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit, duke e dënuar me 2 vjet e 6 muaj burgim dhe duke i zbritur 1/3-at e dënimit e ka dënuar përfundimisht me 1 vit e 8 muaj burgim. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***¹⁷⁰, datë 10.2.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

42.9.11 Lidhur me këtë procedim të regjistruar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290, paragrafi 3 i Kodit Penal, Komisioni i kërkoj shpjegime subjektit të rivlerësimit, për konstatimin se: (i) Subjekti në dokumentin “Diskutim përfundimtar” drejtuar gjykatës ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim të të pandehurit, duke u bazuar vetëm në rrethanat që lidhen kryesisht me të pandehurin, pa marrë në konsideratë rrethanat e kryerjes së veprës penale, si: (1) shkallën e pakujdesisë së autorit të saj, nga ku rezulton se aksidenti ka ardhur për shkak se drejtuesi i mjetit ka lëvizur me shpejtësi 161.6 km/orë, nga 80 km/orë që ka qenë shpejtësia e lejuar në atë segment rrugor; (2) pasojën shoqërisht të rrezikshme, vdekjen e shtetasis P. B.; (ii) Subjekti nëpërmjet kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim duket të ketë favorizuar të pandehurin, dhe kjo kërkesë e subjektit, së bashku me rrethanat e konstatuara në çështjen penale në ngarkim të tij, mund të çojnë në cenimin e besimit të publikut tek organet e drejtësisë.

42.9.12 Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁷¹, subjekti shpjegon se në diskutimin përfundimtar ka pasur parasysh rrethanat e kryerjes së veprës penale, rrethana që i ka vlerësuar në kuadrin e formës së fajit që ka qenë nga pakujdesia, duke pasur parasysh rrezikshmërinë e pakët të të pandehurit, ku ai nuk ka qenë i dënuar më parë dhe as nuk është bërë ndonjëherë problem për veprime të kundërligjshme, normalizimin e marrëdhënieve me trashëgimtarët e viktimës, si dhe nevojat veçanërisht të atyre që lidhen me familjen, ku i pandehuri ka qenë i martuar dhe me dy fëmijë të mitur.

42.9.13 Trupi gjykues, në analizë të akteve në dosje e shpjegimeve të subjektit në raport me ligjin e aplikueshëm, vlerëson se në këtë çështje duhet konsideruar fakti që në këtë rast organi i akuzës/subjekti dispononte atributin e aplikimit të nenit 59 të Kodit Penal, për sa kohë vepra penale për të cilën akuzohej i pandehuri lejonte një masë dënimi deri 5 vjet, në raport me rrethanat lehtësuese të cilat gjenden të arsyetuara nga subjekti në kërkesën e tij, më konkretisht: *“...të mos qenit i dënuar me parë, qëndrimi pohues ndaj akuzës, pendimi i thellë..., normalizimi i marrëdhënieve me familjarët e viktimës, fakti që është i martuar dhe me fëmijë të mitur”*. Po ashtu, duket se subjekti ka vlerësuar rrethanat e kësaj çështjeje në raport me kriteret e parashikuara në nenin 59 të Kodit Penal, duke arsyetuar në dokumentim “Diskutime përfundimtare” nën kuadrin e formës së fajit nga pakujdesia, ku, megjithëse i pandehuri nuk e ka dëshiruar pasojën, ajo ka ardhur. Subjekti në kërkesën e tij para gjykatës i është referuar

¹⁶⁹ Të administruar nga sistemi *gjykata.gov.al*

¹⁷⁰ Të administruar nga sistemi *gjykata.gov.al*

¹⁷¹ Email datë 4.6.2024.

dispozitës që parashikon dënimin maksimal deri në 5 vjet dhe, për rrjedhojë, lejon aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, dhe në zbatim të kësaj të fundit ka konsideruar faktet e provuara se i pandehuri ka qenë i padënuar më parë dhe se ka rregulluar marrëdhëniet me familjarët e viktimës. Trupi gjykues në këtë arsyetim mban në vëmendje jurisprudencën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë¹⁷² për çështje të kësaj natyre. Trupi gjykues, referuar nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, çmon se jemi përpara rastit kur logjika e subjektit nuk mund të zëvendësohet, për sa kohë në dosje provohet se subjekti ka kryer veprime hetimore të plota, të vlerësuara edhe nga organi gjyqësor, porse ky i fundit nga vlerësimi i rrethanave në përmbushje të kriterëve ligjore që kërkon neni 59 i Kodit Penal, në ndryshim nga subjekti ka disponuar me një masë me të lehtë se ajo e kërkuar prej tij.

Procedimet penale që kanë lidhje me ankesat e paraqitura në Prokurorinë e Përgjithshme

43. Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier procedimet penale që kanë lidhje me ankesat e paraqitura në Prokurorinë e Përgjithshme dhe i kërkoi shpjegime subjektit për procedimin penal nr. ***, viti 2014 dhe kallëzimin penal nr. ***, viti 2015.

Analiza e Komisionit

43.1 Lidhur me procedimin penal nr. * të vitit 2014,** të regjistruar për veprat penale “Vrasja me paramendim” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga nenet 78/1 e 278/4 të Kodit Penal, nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal rezulton se në datën 26.4.2014, rreth orës 20:30, në qytetin e Patosit është vrarë me armë zjarri shtetasi B. R. (N. M.). Gjatë hetimeve janë marrë në pyetje familjarët e viktimës dhe shtetasit e tjerë që mund të kenë pasur dijeni për ngjarjen, janë kryer veprimet e përgjimit ndaj disa shtetaseve të dyshuar, ekspertimet daktiloskopike ndaj disa shtetasve, ekspertimet biologjike, kimike, si dhe ekspertimi kimik dhe balistik i gëzhgojave të gjetura në

¹⁷² Vendimi nr. ***, datë 26.1.2012, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që në lidhje me zbatimin e alternativave të dënimit me burgim shprehet: “...Sipas standardeve ndërkombëtare, përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptësisht dhe të jetë një extrema ratio në raste të veçanta, atëherë kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Siç shprehet Këshilli i Evropës, burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm “kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës”, dhe duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë të cilat nuk e bëjnë këtë. Në vlerësim të rrethanave të parashikuara nga neni 59 i Kodit Penal, si dhe duke vlerësuar qëllimin për të cilin legjislatori ka parashikuar alternativat e dënimit me burgim”.

Vendimi nr. ***, datë 6.11.2013, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili në lidhje me aplikimin e alternativave të dënimit ka theksuar se: “Për të aplikuar në mënyrë sa më të drejtë nenin 59 të Kodit Penal, gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor ka për detyrë të identifikojë rrethanën e posaçme që ekziston në jetën e përditshme të të pandehurit. Alternativat e vuajtjes së dënimit me burgim u drejtohen autorëve të veprave penale që shkelin për herë të parë ligjin, të cilët nuk paraqesin rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe kur vepra penale në ngarkim të tyre nuk është shumë e rëndë”.

Vendimi nr. ***, datë 21.7.2021, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili arsyeton se: “...Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit i referohet nenit 47 të Kodit Penal, i titulluar “Mënyra e caktimit të dënimit”, i cili parashikon se: “Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”... Ligjvënësi në parashikimin e marzhit të dënimit për një vepër penale mban në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore të saj, kurse gjykata mban parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer realisht, të autorit të saj dhe të fajësisë së tij, si dhe rrethanat e tjera të çështjes, zbatimit i të cilave ndikon në individualizimin e dënimit; ...Gjykata në përcaktimin e shkallës së fajësisë mban parasysh se vepra penale është kryer me dashje të drekte: ...Gjykata vlerëson të theksojë se qëllimi i zbatimit të dënimeve alternative është të reduktojë dëmin e ardhur nga vepra penale dhe të reduktojë përfshirjen e individit në sistemin e drejtësisë penale, duke i shërbyer sa më mirë asaj që quhet drejtësia restauruese, e cila në thelb nënkupton vendosjen e një ekuilibri ndërmjet interesave të shoqërisë për t’u mbrojtur nga kriminaliteti, si dhe interesave të autorit të veprës penale, që është në konflikt me ligjin. Zbatimi i alternativave të dënimit me burgim lidhet në mënyrë të pazgjdhshme me ekzistencën e vetë dënimit, si dhe me parashikimin në ligj të tyre”.

vendin e ngjarjes, por nuk është bërë i mundur identifikimi i autorit të veprës penale. Në këto kushte, subjekti me vendimin e datës 21.7.2015 ka vendosur pezullimin e procedimit penal.

43.2 Për sa më sipër, lidhur me këtë procedim, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: Subjekti ka marrë vendimin e datës 21.7.2015 për pezullimin e procedimit penal nr. ***/2015 jo sipas parashikimeve të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, pasi : (i) nuk ka administruar kopjen e përgjimeve të shtetasit A. B. nga sektori i përgjimeve në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe nuk ka kryer veprime të mëtejshme hetimore në drejtim të këtij shtetasi, në kushtet kur ka pasur indicie se ky person është paguar për kryerjen e vrasjes së shtetasit I. B.(G.), për të cilin janë ngritur dyshime se së bashku me viktimën kanë lidhje në vrasjen e një shtetasi shqiptar në Itali; (ii) nuk ka kryer veprime hetimore ndaj shtetasit I. B., për të cilin ka pasur indicie se kishte marrëdhënie me viktimën, se marrëdhëniet ndërmjet tyre janë prishur dhe mund ta ketë vrarë; (iii) nuk ka marrë në pyetje, si dhe nuk ka kryer veprime të mëtejshme hetimore në drejtim të shtetasit L. S. në kushtet kur familjarët e viktimës kanë ngritur dyshime se ka lidhje në vrasjen e viktimës; (iv) nuk ka kryer hetime ndaj shtetasve L. M. dhe A. M. në kushtet kur nga hetimet ka rezultuar se këta shtetas i kanë pasur para borxh viktimës.

43.3 Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁷³, subjekti shpjegon se lidhur me kryerjen e veprimeve hetimore ndaj shtetasve të sipërpërmendur, të dyshuar si autorë apo bashkautorë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së shtetasit B. Rr. (N. M.), në bashkëpunim me oficerët e policisë gjyqësore, veprimet hetimore ndaj tyre nuk janë kryer, pasi nuk janë gjetur dyshime se janë larguar jashtë territorit të Shqipërisë në mënyrë të jashtëligjshme, por thekson se ata janë hetuar duke qenë subjekte të përgjimeve të ndryshme. Pikërisht për arsyet e mësipërme, edhe oficeri i policisë gjyqësore në relacionin e datës 13.7.2015 ka sugjeruar pezullimin e hetimeve të procedimit penal, relacion të cilin e ka pranuar. Më tej shpjegon se Komisioni nuk ka kompetencë për të marrë në shqyrtim këtë çështje, pasi këtë e ndalon paragrafi i parë i nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pika 4 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

43.4 Trupi gjykues, në analizë të rrethanave të kësaj çështjeje dhe shpjegimeve të subjektit, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh hetimore, si marrja në pyetje e familjarëve të viktimës dhe shtetasve të tjerë që mund të kenë pasur dijeni për ngjarjen, janë kryer veprimet e përgjimit ndaj disa shtetaseve të dyshuar, ekspertimet daktiloskopike ndaj disa shtetasve, ekspertimet biologjike, kimike, ekspertimi kimik dhe balistik i gëzhjojave të gjetura në vendin e ngjarjes, verifikime të sistemit TIMS, por nuk është bërë i mundur identifikimi i autorit të veprës penale. Në këto kushte është vlerësuar në tërësi duke disponuar me pezullimin e çështjes për shkak të moszbulimit të autorit, ku vërehet gjithashtu se drejtuesi i organit të akuzës nuk ka rezultuar në një vendimmarrje ndryshe për të rinisur hetimet dhe, në këto kushte, vlerëson se nuk ka kompetencë shqyrtimi të thelluar në këtë çështje.

43.5 Trupi gjykues, përveçse konstatoi se subjekti ka ndërmarrë një sërë veprimesh hetimore për zbardhjen e rrethanave të çështjes, por në statusin që ajo është, ku të dhënat ndaj hetimit janë të limituara apo të kufizuara, zbulimi i të cilave mund të dëmtojë hetimin, nuk krijon një panoramë të plotë për të vlerësuar rolin dhe pozitën e subjektit të rivlerësimit në të dhe, për pasojë, çmon se në këtë rast nuk mund të evidentohen shkaqe të tilla që të kualifikohen si mangësi të subjektit sipas neneve 40 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁷³ Email datë 4.6.2024.

44. Lidhur me kallëzimin penal nr. *** të vitit 2015, të shtetasit A. A., i cili ka kallëzuar faktin e shkatërrimit të pronës së tij në fshatin ***, Fier.

Analiza e Komisionit

44.1 Nga shqyrtimi i akteve të kallëzimit penal rezulton se shtetasi A. A. ka paraqitur kallëzim penal pranë Komisarariatit të Policisë Fier, duke pretenduar shkatërrimin e pronës së tij në fshatin ***, Fier. Kallëzuesi ka pretenduar se ka jetuar në një banesë së bashku me prindërit dhe vëllain e tij B. A. dhe, pas martesës së tyre, prindërit e kanë ndarë në mënyrë të barabartë banesën, nga 70 m² secilit. Në vijim ka pretenduar se banesa ishte e ndërtuar që në vitin 1961 dhe se në vitin 1997 ai është larguar nga kjo banesë për të jetuar në qytetin e Tiranës. Pas largimit nga banesa, pas një viti, ia ka lënë në ruajtje pa dokumente nipit të tij R. A., së bashku me një sipërfaqe toke bujqësore prej 2 dynymësh, me një qira simbolike prej 20.000 lekësh. Në vitin 2014, kallëzuesi është vënë në dijeni se banesa ku ai ka banuar, në fshatin ***, është shkatërruar, duke rënë çatia e prishur dritaret e dyert, duke fajësuar për këtë fakt nipin e tij R. A.. Gjithashtu, kallëzuesi ka deklaruar se me shtetasin R. A. është në proces gjyqësor civil pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në lidhje me pretendimet e ndërsjella për sipërfaqe toke bujqësore e truall të ndodhura në fshatin ***, në interes të të cilit është kryer edhe akti i ekspertimit, kopjen e të cilit kallëzuesi e ka paraqitur në cilësinë e provës. Ndërsa shtetasi R. A. ka deklaruar se kallëzuesi ka banuar në fshatin *** në banesën në pronësi të babait të tij B. A. deri në vitin 1993 dhe banesa e vjetër është prishur pjesërisht jo vetëm nga kalimi i viteve, por edhe nga mosbanimi i personave në një pjesë të saj, duke mohuar faktin e prishjes prej tij. Subjekti me vendimin e datës 18.6.2015 ka vendosur mosfillimin e kallëzimit penal për veprat penale “Shkatërrimi i pronës” dhe “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga nenet 150 e 277, pasi fakti nuk përbën veprë penale, me arsyetimin se asnjëra nga palët e përfshira në konflikt nuk ka provuar me dokumente pronësinë e banesës, e cila është një element i domosdoshëm i figurës së veprave.

44.2 Lidhur me këtë procedim, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: i) Subjekti duket se ka marrë vendimin e datës 18.6.2015 për mosfillimin e kallëzimit penal pa u plotësuar kushtet e parashikuara nga neni 290 i Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit, si vijon: -këqyrjen në vend të banesës së pretenduar nga kallëzuesi si e shkatërruar;- kryerjen e ekspertimit për përcaktimin nëse banesa e pretenduar nga kallëzuesi është në pronësi të tij dhe nëse kjo banesë ishte shkatërruar si pasojë e amortizimit apo ka pasur ndërhyrje për prishjen e saj; ii) Duket se konkluzioni i subjektit në vendimin e datës 18.6.2015 për mosfillimin e kallëzimit penal nuk mbështetet në faktet dhe provat e administruara, nga ku rezulton se kallëzuesi ka paraqitur AMTP-në dhe listën emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive të fshatit *** dhe se nuk është provuar në dokumentet e paraqitura pronësia mbi banesën e vjetër objekt kallëzimi; iii) Duket se përfundimi i subjektit në vendimin e datës 18.6.2015 për mosfillimin e kallëzimit se “banesa e kallëzuesit ka qenë e vjetër dhe e amortizuar dhe, për rrjedhojë, nuk kemi shkatërrim të pronës me dashje”, nuk është i bazuar në ndonjë akt të përgatitur nga ekspertë të fushës, me njohuri të posaçme në fushën e ndërtimit;iv) Duket se në vendimin e datës 18.6.2015 për mosfillimin e procedimit penal subjekti nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, në raport me faktet dhe rrethanat e çështjes, në kushtet kur:- ndërmjet kallëzuesit dhe të kallëzuarit po zhvillohej një proces gjyqësor civil lidhur me pretendimet e tyre të pronësisë për banesën dhe truallin objekt kallëzimi penal;- kallëzuesi ka paraqitur dokumentacionin që

vërtetohet të drejtën e pronësisë së banesës (sipas arsyetimit të mësipërm); v) Sipas aktit të ekspertimit të procesit civil të paraqitur nga kallëzuesi, banesa e vjetër e pretenduar nga ana e tij ndodhet në kushtet e themeleve (e shkatërruar) dhe pronën e pretenduar nga kallëzuesi e shfrytëzon të gjithën i kallëzuari.

44.3 Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁷⁴, subjekti shpjegon se raportin e Komisionit e vlerëson të pabazuar pasi, përveç veprimeve të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore, ka urdhëruar kryerjen e këtyre veprimeve: (i) janë marrë dhe këqyrur dokumentet që kanë lidhje me kallëzimin; (ii) është pyetur shtetasi A. A.; (iii) është pyetur shtetasi R. A.. Më tej shpjegon se konstatimet në raportin e Komisionit i përkasin procesit civil dhe jo atij penal. Në rastin konkret, shpjegon subjekti, kontradiktat që kanë pasur palët midis tyre po ndiqeshin civilisht dhe kallëzimi i bërë nga shtetasi A. A. është bërë me qëllimin e vetëm për të rënduar palët e tjera që ai ishte në konflikt pronësie. Sa më sipër, ka parashtruar se në rastin konkret ka zbatuar drejt nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale, duke vendosur mosfillimin e procedimit penal dhe vendimi i mosfillimit nuk është ankimuar edhe nga pala kallëzuese, fakt që mbështetet në vendimin e tij.

Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

44.4 Trupi gjykues, në analizë të akteve të administruara në dosje, shpjegimeve të subjektit, arsyetimit të vendimit për mosfillimin e kallëzimit penal datë 18.6.2015, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime verifikuese, sikurse kërkon edhe çështja objekt hetimi, duke marrë deklaratimet e kallëzuesit, si dhe pyetur të kallëzuarin R. A., administruar gjithashtu edhe akte lidhur me objektin e hetimit, dhe më tej ka konkluduar në këtë vendimmarrje se fakti nuk përbën vepër penale. Gjithashtu, vendimi arsyeton edhe mbi konfliktin civil pronësor, i cili duket se ka lidhje edhe me çështjen objekt hetimi, por edhe mbi ekspertizën e kryer që në procesin civil. Trupi gjykues vlerëson se çmuarja e rrethanave dhe fakteve të konkluduara nga subjekti në këtë vendimmarrje gjendet e bazuar në logjikën dhe interpretimin e tij, në raport me kërkesat e nenit 290/ç të Kodit të Procedurës Penale, ku rezulton gjithashtu se kallëzuesi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe, për rrjedhojë, nuk evidentohen mangësi të tilla, të cilat mund të përbëjnë shkak cenimi të kriterit profesional të subjektit.

Denoncimet e depozituara në Komision sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016

Në Komision, për subjektin e rivlerësimit Petrit Vukaj janë administruar 12 denoncime nga publiku. Referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kërkoi shpjegime për 2 denoncime, si vijon:

45. Lidhur me denoncimin nr. *** prot., datë 28.10.2019, të shtetasës M. B., e cila ka ngritur pretendime se subjekti ka pushuar me pa të drejtë çështjen penale të regjistruar pas kallëzimit penal të saj ndaj ish-bashkëshortes së bashkëshortit për dhunë.

Analiza e Komisionit

45.1 Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier kopje të kallëzimit penal nr. ***, viti 2019 dhe rezulton se në datën 23.5.2019, në Spitalin Rajonal Fier është paraqitur shtetasja M. B., e cila ka deklaruar se është martuar me shtetasin Rr. L. dhe ka pasur një konflikt me shtetasen D. L., e cila ka qenë më parë

¹⁷⁴ Email datë 4.6.2024.

e martuar me këtë shtetas, me të cilin ka katër fëmijë¹⁷⁵. Kallëzuesja ka deklaruar se banesa e saj ndodhet brenda të njëjtit oborr me banesën e shtetases D. L. dhe rreth orës 18:00 të datës 23.5.2019, në oborrin e banesës, shtetasja D. L. e ka goditur me grushte e më pas aty ka ardhur edhe vajza e saj, shtetasja B. S.. Sipas aktit të ekspertimit mjekoligjor të datës 24.5.2019, është arritur në përfundimin se tek e dëmtuara vërehen ekimoza, gërvishtje e hematoma. Dëmtimi i mësipërm është shkaktuar me mjet të fortë prerës, të cilat hyjnë në kategorinë e dëmtimeve që sjellin humbjen e aftësisë për punë në masën deri në 9 ditë. Subjekti me vendimin e datës 30.5.2019 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se në rastin konkret ndodhemi përpara elementeve të veprës penale “Dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal, për ndjekjen e së cilës ankuesja duhet t’i drejtohet drejtpërdrejt gjykatës.

45.2 Kundër këtij vendimi të subjektit ka paraqitur ankim në gjykatë kallëzuesja, me argumentin se kjo çështje është mbyllur pa kryer asnjë hetim, si dhe ka kërkuar ushtrimin e ndjekjes penale ndaj shtetaseve D. E. dhe B. S., pasi ndihet e kërcënuar nga veprimet e tyre të paligjshme. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. ***, datë 3.12.2019, ka vendosur rrëzimin e ankimit të ankuses M. B., me arsyetimin se pretendimet e parashtruara nga ana e kësaj shtetaseje lidhur me dhunën e ushtruar ndaj saj nga shtetasja D. E., në bashkëpunim me shtetasen B. S., përbëjnë elementet e veprës penale “Dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90/2 i Kodit Penal dhe sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale ndiqet në gjykatë mbi kërkesën e viktimës akuzuese.

45.3 Komisioni lidhur me këtë çështje i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: Subjekti ka marrë vendimin e datës 30.5.2019 për mosfillimin e procedimit penal ndaj shtetases B. S., pa vlerësuar faktin se ndërmjet kallëzueses dhe të kallëzuarës B. S. ekzistonte lidhja familjare në formën e krushqisë së afërt.

45.4 Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁷⁶, subjekti shpjegon se në rastin konkret është zbatuar ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, i ndryshuar¹⁷⁷. Duke pasur parasysh formulimin e ligjit të mësipërm, në rastin konkret raportet midis shtetaseve M. B., D. E. dhe vajzës së kësaj të fundit B. S., nuk është krushqi e afërt, pasi as B. S. nuk konsiderohet thjesht e shtetases M. B. dhe as kjo e fundit nuk konsiderohet njerka e B. S.. Shtetasi Rr. L. nuk ka lidhje martesore me shtetasen M. B., por kanë qenë thjesht në raporte bashkëjetuese. Në vijim, shpjegon se palët në konflikt D. E. dhe vajza e saj B. S. nga njëra anë, dhe M. B. nga ana tjetër, nuk jetonin në të njëjtën banesë.

45.5 Subjekti ka shpjeguar se në këtë rast është marrë vendimi i mosfillimit të procedimit penal dhe duke e orientuar njëkohësisht palën kallëzuese për rrugën që duhet të ndiqte, i cili është miratuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. ***, datë 3.12.2019, vendim i cili është pranuar nga palët duke mos bërë ankim dhe duke marrë formë të prerë në datën 24.12.2019. Subjekti ka pretenduar se i ka pasur dhe i ka të gjitha njohuritë ligjore dhe aftësinë si prokuror për të kuptuar, interpretuar dhe zbatuar drejt ligjin.

45.6 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, arsyeton bazuar në faktet e rrethanat e rezultuara në raport me ligjin

¹⁷⁵ Ka rezultuar se shtetasi Rr. L. dhe D. L. kanë zgjidhur martesën me vendimin nr. ***, datë 5.10.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

¹⁷⁶ Email datë 4.6.2024.

¹⁷⁷ Me ligjet nr. 9914, datë 12.5.2008, nr.10329, datë 30.9.2010 dhe nr. 47/2018, datë 23.7.2018.

nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, i ndryshuar, dhe parashikimet e Kodit Penal. Në raport me ligjin për masat ndaj dhunës në familje, çështja e hetuar dhe e mosfilluar nxjerr në pah konflikt mes personave, të cilët nuk kanë lidhje familjare sikurse kërkon ky ligj dhe, për pasojë, hetimi nuk mund të shtrihej në kuadër të zbatimit të këtij ligji. Ky ligj ka qartësuar rrethin e pjesëtarëve të familjes në nenin 3/7 të tij dhe, referuar pikërisht këtij parashikimi, duket se personat e përfshirë në konflikt nuk konsiderohen mes tyre anëtarë familjeje. Trupi gjykues vlerëson gjithashtu se shpjegimet e subjektit janë bindëse, ku konstatohet se edhe në vendimin e marrë nga subjekti është arsyetuar lidhur me vlerësimin e fakteve edhe rrethanave të kallëzuar, të cilat i nënshtrohen zbatimit të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, duke vënë në lëvizje drejtpërdrejt gjykatën, me kërkesë për akuzën e veprës penale sipas nenit 90/2 të Kodit Penal “Dëmtime të tjera me dashje”.

Për rrjedhojë, trupi gjykues nuk konstaton fakte apo rrethana që mund të cenojnë kriterin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

46. Lidhur me denoncimin nr. *** prot., datë 15.1.2020, të shtetasit E. H., i cili akuzon subjektin se ndikon tek familjarët e të arrestuarve për zgjedhjen e avokatit, si dhe ka kërkuar të verifikohet rasti i të arrestuarit S. S., akuzuar për kultivim lëndësh narkotike, posedim lëndësh narkotike dhe mbajtje pa leje të municionit luftarak, pasi subjekti nuk e ka ankimuar vendimin e gjykatës nga “Arrest në burg” në “Detyrim paraqitjeje”.

46.1 Komisioni për këtë çështje administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier¹⁷⁸ kopje të procedimit penal nr. ***, viti 2019. Nga aktet në dosje rezulton se në datën 26.8.2019 shërbimet e policisë së Komisarariatit të Policisë Fier kanë ushtruar kontroll territori në fshatin ***, Bashkia Fier, ku në afërsi me vreshtat e shtetasit S. S. kanë konstatuar 28 bimë me lartësi 1.5-2 m, të dyshuara narkotike si *cannabis sativa*, të mbjella në tri parcela. Është ushtruar kontroll në banesën e shtetasit S. S. dhe gjatë kontrollit është gjetur lëndë e thatë bimore e dyshuar si narkotike, fara të dyshuara si ato të bimëve narkotike, një palë dylbi, si dhe 8 copë fishekë pistolete “model 54”. Gjatë kontrollit është konstatuar edhe një armë gjahu, e cila ka rezultuar se është me leje dhe në lidhje me këtë është bërë bllokimi i kësaj arme.

46.2 Subjekti me vendimin e datës 27.8.2019 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Kultivimi i bimëve narkotike” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 283/1, 284/1 dhe 278/2 të Kodit Penal, duke regjistruar emrin e personit nën hetim S. S.. Gjithashtu, ka paraqitur kërkesë në gjykatë për vleftësimin të ligjshëm të arrestit të shtetasit S. S. dhe caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. ***¹⁷⁹, datë 28.8.2019.

46.3 Në përfundim të hetimeve, subjekti me vendimin e datës 3.2.2020 ka marrë si të pandehur shtetasin S. S. vetëm për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, duke argumentuar se për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Kultivimi i narkotikëve”, parashikuar nga nenet 283/1 e 284/1 të Kodit Penal çështja duhet të pushohet, si dhe ka paraqitur kërkesën për gjykim në gjykatë.

¹⁷⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 19.10.2023.

¹⁷⁹ Të administruar nga sistemi gjykata.gov.al

46.4 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. ***, datë 23.4.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës për dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, duke pranuar edhe kërkesën për pushimin e procedimit penal për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 283, paragrafi 1 dhe neni 284, paragrafi 1 i Kodit Penal. Gjithashtu rezulton se me vendimin nr. ***¹⁸⁰, datë 17.7.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe, pasi ka zbritur 1/3 e dënimit për shkak të gjykimin të shkurtuar, e ka dënuar përfundimisht me 2 vjet e 9 muaj burgim.

46.5 Komisioni i kërkoi subjektin të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: (i) Duket se konkluzioni i subjektin në vendimin e datës 3.2.2020 për njoftimin e akuzës të pandehurit dhe në kërkesën e datës 13.2.2020 për pushimin e ndjekjes penale, nuk gjen zbatim në parashikimet e neneve 283, 22 të Kodit Penal; (ii) Duket se konkluzioni i subjektin se masa e sigurimit nuk i përgjigjet rëndësisë së faktit pa marrë në konsideratë konsumimin e elementeve të figurës së veprës penale, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, e mbetur në tentativë, nuk është i bazuar në provat e administruara.

46.6 Mbi barrën e provës, në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁸¹, subjekti shpjegon se objekti i aktit të ekspertimit kimik nr. ***, datë 1.10.2019, kanë qenë 28 bimët që janë gjetur në afërsi të vreshtave të të pandehurit S. S. dhe jo lënda bimore e thatë apo farërat që janë gjetur në banesë. Në lidhje me farat e dyshuara të llojit *cannabis sativa* të sekuestruara gjatë kontrollit të banesës me peshë 48.20 gramë, shpjegon subjekti, OPGJ-ja ka marrë vendimin e datës 26.8.2019 për të kryer ekspertimin kimik, por ka qenë një lapsus, pasi me shkresën përcjellëse Drejtoria e Policisë Vendore Fier i ka dërguar Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë vendimin e datës 10.9.2019 për kryerjen e ekspertimit teknologjik-bujqësor të farave. Më tej, thekson se për farërat nuk është kryer akti i ekspertimit kimik, por vetëm është urdhëruar mbjellja e tyre.

46.7 Në vijim, shpjegon se për pjesët e bimëve të thara të gjetura në banesë është kryer akti i ekspertimit kimik nr. ***, datë 6.11.2019, si dhe akti i ekspertimit mjekoligjor nr. ***, datë 13.12.2019, ku është tërhequr konkluzioni se: “*Sasia prej 4.246 gramësh cannabis sativa konsiderohet si dozë e vogël për përdorim ditor pa shkaktuar dëmtime për shëndetin*”.

46.8 Më tej shpjegon se ka paraqitur kërkesën drejtuar gjykatës për pushimin e çështjes penale për veprën penale parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, bazuar në pikën 1, shkronja “dh” e nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale. Sa më sipër, e vlerëson të pasaktë dhe të pabazuar pretendimin në raportin e Komisionit se nuk ka marrë në konsideratë konsumimin prej të pandehurit të elementeve të figurës së veprës penale, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, të mbetur në tentativë.

46.9 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, shpjegimeve të dhëna nga subjekti, në raport me ligjin e aplikueshëm dhe statusin e kërkesës së subjektin të rivlerësimit të miratuar nga gjykata, lidhur me pushimin e çështjes për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e

¹⁸⁰ Të administruar nga sistemi *gjykata.gov.al*

¹⁸¹ Email datë 4.6.2024.

narkotikëve” dhe “Kultivimi i narkotikëve”, parashikuar nga nenet 283/1 e 284/1 të Kodit Penal dhe dënimin për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, konstaton se në këtë çështje penale janë kryer hetime lidhur me provueshmërinë e kryerjes së veprave penale nga i pandehuri si aktet e ekspertimit kimik, mjekoligjor etj. Po ashtu, trupi gjykues konstaton se masa e sigurimit personal “Arrest në burg” është kërkuar në kushtet e flagrancës, për sa kohë nga kontrolli i banesës është gjetur lëndë e thatë bimore e dyshuar si narkotike, fara të dyshuara si ato të bimëve narkotike, një palë dylbi, 8 copë fishekë pistolete “model 54” dhe një armë gjahu, e cila ka rezultuar se është me leje dhe, më tej, nga hetimi është arritur në vlerësimin e kryerjes së veprës penale dhe fajësinë për njëren prej tyre. Në tërësi të fakteve dhe rrethanave të kësaj çështjeje, trupi gjykues referuar nenit 72/4 të ligjit nr. 96/2016 çmon se nuk evidentohen problematika që cenojnë kriterin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Konstatime të tjera

47. Referuar fakteve të analizuara në kreun e rivlerësimit të pasurive të subjektit, rezulton se në DIPP/2009 subjekti ka deklaruar: “...Investim në banesë e cila ka të bëjë me shtesë të ambienteve të banimit me sip. 57.6 m². Kati i dytë (proces legalizimi). Vlera 300.000 lekë”. Më pas, në DIPP/2010 ka deklaruar në total katin e dytë me sip. 102 m².

47.1 Në vijim, në përgjigje të pyetësorit standard¹⁸² dhe në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 7.6.2016, subjekti ka deklaruar se ka kryer shpenzime për ndërtimin e një ambienti banimi kati 1, mbi katin 0, banesa ekzistuese dhe ndërtimi është kryer pjesë-pjesë, përgjatë viteve 2008, 2009 dhe 2010, me vlerë totale 659.000 lekë. Sa më sipër, arrihet në përfundimin se në vitin 2009 subjekti ka ndërtuar sipërfaqen prej 57,6 m² dhe në vitin 2010 ka ndërtuar një shtesë me sipërfaqe 44,4 m² (102 m² - 57,6 m²).

47.2 Më tej rezulton se Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar¹⁸³, ku parashikohet se në Kodin Penal shtohet neni 199/a me këtë përmbajtje: “Ndërtimi i paligjshëm i një objekti në tokën e vet dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit... ”.

47.3 Sa më lart, duket se veprimet e subjektit të rivlerësimit në periudhën 2009 – 2010, duke ndërtuar shtesa kati pa leje ndërtimi në banesën e tij, jo vetëm janë në kundërshtim me legjislacionin për urbanistikën¹⁸⁴ e kohës, por edhe në kufijtë e veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, duke vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës së magjistratit.

47.4 Nga faktet e analizuara më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: (i) Veprimet e subjektit të rivlerësimit në periudhën 2008 – 2010, duke ndërtuar shtesa kati pa leje ndërtimi në banesën e tij, në kundërshtim me legjislacionin për urbanistikën dhe në kufijtë e veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal; (ii) Subjekti duke vepruar në kundërshtim me parashikimet ligjore ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

¹⁸² Email datë 27.1.2021.

¹⁸³ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 190, datë 31.12.2008.

¹⁸⁴ Ligji nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, i ndryshuar.

47.5 Në qëndrimin e tij, subjekti ka parashtruar se në lidhje me mospërputhjen e përmbajtjes së lejes së legalizimit me regjistrimin në kartelën e pasurisë së paluajtshme, shpjegon se ASHK e ka sqaruar se nga verifikimi i bërë fotografimeve ajrore ndër vite ka konstatuar se procesverbali i verifikimit në terren nuk i përgjigjet gjendjes faktike, pasi kati i parë teknik i objektit, në vitin 2010 ka qenë i gjithi i përfunduar.

47.6 Lidhur me konstatimin se referuar ligjit nr. 7693/1993, “Për urbanistikën”, leja e ndërtimit jepej për një periudhë 6-mujore e, për pasojë, shtesa e katit të dytë e deklaruar nga subjekti gjatë deklarimeve periodike vjetore 2008 – 2009 është ndërtuar jashtë afatit të vlefshmërisë së lejes së ndërtimit, subjekti sqaron se në lejen e ndërtimit të datës 28.6.1994 nuk kishte afat të përcaktuar, sikundër e detyronte ligji i kohës, çfarë nënkupton sipas tij se ky është një mosveprim i organit publik kompetent në atë kohë, për të cilin nuk mund të penalizohet. Gjithashtu, shpjegon se organi publik nuk e ka kualifikuar në asnjë rast si kundërvajtje administrative sipas ligjit nr. 7693/1993 e më pas sipas ligjit nr. 8405/1998.

47.7 Lidhur me konstatimin se referuar nenit 2 të ligjit nr. 9482/2006 ligji i legalizimit zbatohet për të gjitha ndërtimet e kryera përpara hyrjes në fuqi të tij, subjekti ka parashtruar se ndryshimet ligjore në ligjin bazë për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, të miratuara me ligjin nr. 141/2013, lejonin legalizimin e ndërtimeve pa leje të kryera në truallin në pronësi edhe në rastin kur këto ndërtime ishin kryer pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9482/2006 dhe sipas nenit 45.1 të ligjit të mësipërm ALUIZNI, duhet të merrte masat për evidentimin faktik të situatës ndërtimore në terren, sikundër ka ndodhur në rastin konkret. Në këto kushte, vlerëson se qëndrimi i Komisionit se “Regjistrimi i katit të dytë të banesës me sip. 102 m² në vitin 2010 dhe në vitin 2017 është bërë jo sipas parashikimeve të ligjit nr. 9482/2006, ligjit nr. 7843/1994 dhe ligjit nr. 33/2012”, duhet të ndryshohet, bazuar në situatën faktike të ndërtimit dhe në interpretim të legjislacionit në fuqi të analizuar më lart.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

47.8 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, shpjegimeve të subjektit dhe legjislacionit të aplikueshëm lidhur me këtë çështje, vlerëson se:

47.8.i Në kushtet kur provohet se subjekti i rivlerësimit ka qenë i pajisur me truall për ndërtimin e një shtëpie banimi, dhënë me vendimin nr. 2, datë 19.9.1991, të Komitetit Ekzekutiv Pluralist të lagjes “****” dhe në datën 28.6.1994 është pajisur nga organi kompetent edhe me leje ndërtimi me përshkrimin “Për shtëpi banimi”, pa përcaktuar konkretisht numër katesh apo sipërfaqeje ndërtimore, pavarësisht faktit se në lejen e ndërtimit nuk është caktuar afat sipas ligjit nr. 7693/1993¹⁸⁵, “Për urbanistikën”, i ndryshuar, trupi gjykues vlerëson të trajtojë këtë çështje në analizë të gjithë procesit të ndjekur nga subjekti nga institucionet përkatëse të përfshira në këtë proces, në raport me legjislacionin e aplikueshëm.

47.8.ii Në këtë drejtim, në analizë të dokumentacionit tekniko-ligjor, përcjellë zyrtarisht me shkresën nr. *** prot., datë 23.2.2009, Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier nga Drejtoria e Urbanistikës pranë Këshillit të Qarkut Fier, ku konfirmohen të depozituara aktet: (a) vendimi nr. ***, datë 19.9.1991, i Komitetit Ekzekutiv Pluralist të lagjes “****”; (b) leja e ndërtimit, datë 28.6.1994; (c) sheshet e ndërtimit dhe plani i vendosjes së trojeve në lagjen “****”, Fier, të qytetarëve (Petrit Vukaj), ku është përcaktuar edhe njolla e ndërtesës; (ç) projekti

¹⁸⁵ Neni 33 parashikon: “Leja e ndërtimit është e vlefshme për 6 muaj. Kur objekti që i jepet leje kërkon një kohë zbatimi më të gjatë se 6 muaj, leja e ndërtimit jepet për aq kohë sa kërkon ndërtimi i objektit”.

i ndërtesës ku përfshihet: planimetria e katit përdhe; planimetria e katit të parë; prerja 1-1; plani i strukturave; pamja kryesore e objektit; akti i kontrollit nga seksioni i urbanistikës pranë Këshillit të Qarkut Fier; akti i kolaudimit, datë 3.2.2009, nga kolaudatori ing. H. A.; leja e shfrytëzimit, trupi gjykues konstaton se:

47.8.1 Rezulton se prej muajit shkurt të vitit 2009, ende pa dalë leja e legalizimit në prill të vitit 2010, institucionet kompetente administronin planimetri të katit përdhe, të katit të parë, aktin e kontrollit të objektit nga seksioni i urbanistikës pranë Këshillit të Qarkut Fier, aktin e kolaudimit, si dhe aktin e shfrytëzimit të objektit. Në nivelin që janë provat e cituara, trupi gjykues vëren se objekti ka vijuar legalizimin nën vetëdeklarimin e bërë nga subjekti në vitin 2006 sipas formularit përkatës për objektin truall me katin përdhe me sip. 104 m² dhe ambientin ndihmës (garazh) me sip. 23 m², i kategorizuar në ligjin nr. 9482/2006, por edhe duke vlerësuar gjendjen e terrenit të konstatuar po nga organi kompetent pas verifikimit përkatës, duke kryer regjistrimin hipotekor me përfshirje edhe të papafingos me sip. 102 m².

47.8.2 Në rrethanat e lartpërmendura, trupi gjykues, duke konstatuar se: (i) subjekti dispononte përfitimin e truallit në mënyrë të ligjshme; (ii) dispononte një leje ndërtimi që në vitin 1994; (iii) rregullimet ligjore ndër vite rregulluan këtë proces, pra legalizimin e ndërtimeve informale dhe, më konkretisht, ligji nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, parashikonte edhe legalizimin e ndërtimeve pa leje nga pronarët në pronat e tyre, ku sipas nenit 77 KRRT-ja duhej të vendoste legalizimin e ndërtimit, me kushtin e shlyerjes së detyrimit nga ndërtuesi, ligji nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, ku në nenin 2, pika 1 e tij parashikonte se dispozitat e këtij ligji zbatoheshin për të gjitha objektet e ndërtuara pa leje, të ngritura para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, pavarësisht nëse ato kanë funksion strehimi... etj., ligji nr. 141/2013 lejoi legalizimin e ndërtimeve pa leje të kryera në truallin në pronësi, edhe në rastin kur këto ndërtime ishin kryer pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit bazë për legalizimin, nr. 9482, datë 3.4.2006; si dhe (iv) për faktin se subjekti rezultoi i pajisur me certifikatën e pasurisë nr. ***, datë 31.1.2017, atëherë veprimet e ndërmarra prej tij/subjektit në këtë proces dhe të konfirmuara nga organet kompetente sipas akt konstatimeve në terren çmohen të tilla se ato nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’i vlerësuar si një sjellje e subjektit në shkelje të parashikimeve ligjore apo të rregullave të etikës.

47.8.3 Në vijim, Komisioni, pasi u njoh nëpërmjet mediave televizive¹⁸⁶ me ankesën e shtetasit F. A. lidhur me procedimin penal në ngarkim të tij, i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: (i) Subjekti në vendimin për marrje si të pandehur të shtetasit F. A. dhe në kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, viti 2019, nuk ka analizuar faktin nëse paraqitja e rreme e atësisë dhe amësisë nga i pandehuri në dokumentet noteriale ka cenuar pjesën përshkruese-dëftuese të dokumenteve, ku pasqyrohen të drejtat dhe detyrimet e palëve; (ii) Interpretimi i subjektit në dokumentin “Konkluzione përfundimtare” se “I pandehuri ka fshehur me qëllim dhe me dashje faktin se nuk ishte më djali ligjor i shtetasve Z. dhe B. A., pasi nuk mund të pretendonte dhe të merrte dëmshpërblimin nga vdekja e vëllait të tij biologjik, për shkak se ishte i birësuar në një familje tjetër”, nuk mbështetet në jurisprudencën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë konkluduar se kërkesa për dëmshpërblim nga fakti i paligjshëm nuk kushtëzohet me gëzimin

¹⁸⁶ <https://stop.tvklan.al/15-vjecari-u-vra-gabimisht-nga-italiani-prokurori-spyet-per-tragjedi-kerkon-20-e-demshperblimit/>

e cilësisë së trashëgimitarit të një personi të dëmtuar, por vetëm me cilësinë e vetë paditësit si i dëmtuar nga fakti i paligjshëm.

47.8.4 Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁸⁷, subjekti shpjegon se me ligjin shqiptar i birësuar nuk trashëgon nga familja e origjinës, por në rastin konkret rëndësi merrte fakti se çfarë parashikonte legjislacioni italian për këtë rast, pasi gjykimi civil për shpërblimin e dëmit është kryer në Itali. Fakti që i pandehuri në hetim në shtetin italian ka përdorur si amësi dhe atësi atë të prindërve biologjikë, vijon subjekti, tregon se edhe sipas ligjit italian ai nuk mund të përfitonte dëmshpërblimin përkatës.

47.8.5 Më tej shprehet se përdorimi nga i pandehuri i të dhënave jo të vërteta për sa i përket amësisë dhe atësisë, të ndryshme nga ato që ka pasur në zyrën e gjendjes civile të Republikës së Shqipërisë, kanë pasur si qëllim ardhjen e pasojës së kundërligjshme të përfitimit të padrejtë të dëmshpërblimit. Gjithashtu, shpjegon se ka mendimin se përderisa çështja nuk është zgjidhur përfundimisht me një vendim të formës së prerë, pasi ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Komisioni nuk ka kompetencë për të marrë në shqyrtim këtë çështje, pasi këtë e ndalon paragrafi i parë i nenit 43 i ligjit nr. 84/2016, si dhe pika 4 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.

Analiza e Komisionit

47.8.6 Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. *** të vitit 2019, të administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier¹⁸⁸, rezulton mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit E. B. se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 10.7.2019, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, me të pandehur shtetasin F. A.. Ka rezultuar se i pandehuri ka lindur në datën 25.8.1986 dhe është fëmijë i shtetasve L. e N. A.. Pas lindjes së tij, në datën 10.2.1988 ka ardhur në jetë vëllai i tij, shtetasi B. A.. Me vendimin nr. ***, datë 21.3.1992, të Gjykatës Popullore Lushnjë, i pandehuri është birësuar nga shtetasit Z. e B. A., të cilët janë ungji dhe emta e tij. Gjithashtu, ka rezultuar se të dy familjet jetonin afër njëra-tjetrës¹⁸⁹. Pas shkëputjes së të pandehurit nga trangu familjar, në datën 22.4.1992, shtetasit L. dhe N. A. kanë sjellë në jetë vajzën e tyre, shtetasen A. A.. Më tej, rezulton se shtetasi B. A. është ndarë nga jeta në datën 17.10.2003, pasi është vrarë aksidentalisht nga pakujdesia nga shtetasi italian E. C., i cili është dënuar me vendim përfundimtar nga gjykatat shqiptare¹⁹⁰.

47.8.7 Familja A. ka nisur procedurat për dëmshpërblimin pasuror e jopasuror ndaj shkakhtarit të vdekjes së familjarit të tyre dhe me prokurën e posaçme nr. ***, datë 29.11.2010, shtetasit L., N., F.¹⁹¹, A. A. dhe Z. S. u kanë dhënë të drejta të plota avokatëve I. B. dhe M. di C. që, së bashku ose veç e veç, t’i përfaqësojnë, ndihmojnë dhe mbrojnë në procedurat jashtëgjyqësore dhe në çdo proces gjyqësor që ka lidhje me marrjen e dëmshpërblimit për humbjen e jetës së familjarit të tyre, B. A.. Gjithashtu, shtetasit e mësipërm me prokurën e

¹⁸⁷ Email datë 4.6.2024.

¹⁸⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 26.6.2023.

¹⁸⁹ Sipas dëshmisë së shtetasës B. A.: “F. i e ka ditur që ka qenë i birësuar prej saj dhe nga shtetasi Z. A. dhe ata jetonin bashkë në një oborr bashkë me shtetasit L. dhe N. A.”.

¹⁹⁰ Vendim nr. ***, datë 17.6.2009, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹⁹¹ Ku gjeneralitetet për të pandehurin janë përcaktuar: “F. A., i biri i L. dhe i N. i lindur në datën 25.8.1986, në ***, Lushnjë”.

posaçme nr. ***, datë 11.2.2011¹⁹², i kanë dhënë shtetasit E. B. të drejta të plota t'i përfaqësojë, ndihmojë dhe mbrojë në procedurat jashtëgjyqësore dhe në çdo proces gjyqësor në Shqipëri dhe Itali, që ka lidhje me marrjen e dëmshpërblimit për humbjen e jetës së familjarit të tyre, si dhe kanë lidhur aktmarrëveshjen e datës 12.2.2011¹⁹³.

47.8.8 Me deklaratën noteriale për revokim prokure dhe aktmarrëveshjeje nr. ***, datë 4.6.2018, shtetasit L., N., F. dhe A. A. kanë revokuar aktmarrëveshjen e datës 12.2.2011 dhe prokurën e posaçme të datës 11.2.2011, me arsyetimin se shtetasi E. B. nuk ka vepruar dhe nuk ka kryer asnjë veprim konkret që të përfitojë dëmshpërblim. Shtetasi E. B. ka paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasve L., N., F. dhe A. A., duke pretenduar se në bashkëpunim kanë konsumuar veprat penale “Falsifikimi i akteve të gjendjes civile” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga nenet 191/2 e 186/2 të Kodit Penal, si dhe veprat penale “Mashtrimi” dhe “Mashtrimi në sigurime”, sipas parashikimeve të neneve 143/2, 145/2 të Kodit Penal, pasi në dokumentet noteriale shtetasi F. A. ka deklaruar gjeneralitete të rreme, pasi në gjendjen civile nuk rezultojnë të jetë i biri i L. dhe N. A., por i shtetasve Z. dhe B. A.. Gjithashtu, ka pretenduar se certifikata familjare e datës 8.2.2010, e lëshuar nga ZGJC Komuna ***, Qarku Fier, e përdorur nga këta shtetas përpara organeve shtetërore shqiptare dhe atyre italiane, është e falsifikuar.

47.8.9 Në përfundim të hetimeve, subjekti me vendimin e datës 27.4.2021 ka marrë si të pandehur shtetasin F. A., të cilit i ka njoftuar akuzën, sikurse pasqyrohet më lart dhe, më pas, ka paraqitur para gjyqtarit të seancës paraprake kërkesën për dërgimin e çështjes penale në gjykim. Me vendimin nr. ***, datë 26.11.2021, gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur pranimin e kërkesës dhe dërgimin e çështjes për gjykim pranë gjykatës kompetente. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. ***, datë 5.10.2022, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit F. A. për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 muaj burgim. Nga informacioni i administruar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm¹⁹⁴ rezultojnë se çështja është regjistruar pranë kësaj Gjykate dhe nuk është planifikuar për gjykim.

47.8.10 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, shpjegimeve të dhëna nga subjekti, vlerëson se në rastin konkret çështja penale është gjykuar në kuadrin e kryerjes së veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, për të cilën subjekti ka marrë këtë shtetas si të pandehur, ku rezultojnë se në kërkesën e tij ai ka arsyetuar mbi faktet dhe rrethanat, duke bërë edhe interpretimin e ligjit të aplikueshëm, të miratuara plotësisht nga gjykata.

47.8.11 Trupi gjykues konstaton se për sa i përket çështjes së gjykuar në shtetin italian, me palë ndërgjyqëse trashëgimtarët e të ndjerit të aksidentuar, me objekt përfitimin e dëmit të shkaktuar, kjo është një çështje civile e cila nuk konsiderohet në vlerësimin e rolit të subjektit nën zbatimin e vendimit të Kolegjeve të Bashkuara. Legjitimiteti i palëve në këtë proces civil, marrja ose jo pjesë e të pandehurit si paditës (qoftë si i dëmtuar, qoftë si i birësuar, por kurrsesi si trashëgimtar për sa kohë ai ishte i birësuar në një tjetër familje nga ajo e origjinës), është gjykuar e vlerësuar nga gjykata si trashëgimtar apo si një person tjetër që ka provuar se është dëmtuar nga ndarja nga jeta e viktimës e, për rrjedhojë, vlerëson se nuk duhet ngatërruar roli i

¹⁹² Ku përsëri gjeneralitetet e të pandehurit janë “F. A., i biri i L. dhe i N., i lindur në datën 25.8.1986, në Vlorë”.

¹⁹³ Dhe në këtë aktmarrëveshjeje i pandehuri figuron me gjeneralitetet “F. A., i biri i L. dhe N., i lindur në datën 25.8.1986, në Vlorë”.

¹⁹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 20.11.2023.

gjykatës në verifikimin e legjitimitetit të palës në një çështje civile ku duket se gjen zbatim referimi i vendimit të Kolegjeve të Bashkuara të cituar më sipër, në raport me rolin dhe pozitën e subjektit të rivlerësimit në çështjen penale.

47.8.12 Në këto kushte, trupi gjykues çmon se nuk ka rrethana që mund të cenojnë vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit.

Konkluzion i Komisionit në lidhje me rivlerësimin e aftësive profesionale

48. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka theksuar se gjyqtari nuk mund të shkarkohet nga detyra për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive dhe subjektive nuk rezulton se veprimet e tij të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapët e flagrant me ligjin apo me praktikatat unifikuese të gjykatave më të larta. Gjithashtu, ka çmuar që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale.

48.1 Trupi gjykues, bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, si duke marrë në konsideratë: (i) numrin e çështjeve të analizuara, ku janë konstatuar mangësi në aspektin e aftësive profesionale në raport me çështjet e ndjekura nga subjekti i rivlerësimit për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 dhe ato të analizuara nga denoncimet; (ii) mangësia e konstatuar si më lart nuk gjendet e përsëritur në mënyrë të vazhdueshme, që të përfaqësojnë defekte të rëndësishme dhe mjaftueshme për njohuritë profesionale; (iii) kërkesat e shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59, i cili përcakton se konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet: “[...] kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale [...]” – vlerëson se problematika e rezultuar në rivlerësimin e aftësive profesionale, të përshkruara më lart në arsyetimin e këtij vendimi, nuk plotëson kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konsiderohet “i papërshtatshëm”.

48.2 Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet “i aftë”.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, çmon se:

a. Lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, subjekti ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë.

b. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës nuk i rezultuan elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës apo elemente të tjera që mund të cenojnë figurën e subjektit.

c. Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, duke marrë parasysh qëllimin e vlerësimit të aftësive profesionale, siç parashikohet nga Kushtetuta, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

d. Mangësitë e konstatuara në procesin e rivlerësimit për këtë subjekt vlerësohen të pamjaftueshme për të arritur në konkludimin me masë penalizuese për efekt të këtij procesi.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Petrit Vukaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 14.6.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ

Kryesues

Etleda ÇIFTJA

Relatore

(kundër)

Brunilda BEKTESHI

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Resilda Bilaj